

ANALIZA E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR DONACIONE DHE SPONZORIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE 2007-2011



Në bashkëpunim me
Qendrën Evropiane për
të Drejtë Jofitimprurëse
(QEDJ)

Projekt: Krijim i mekanizmave pjesëmarrës për zhvillimin
e kornizës ligjore e cila mundëson qëndrueshmëri
financiare të organizatave qytetare.

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

Shkup, mars 2012

Botues: Shoqata Konekt dhe Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (QEDJ)

Redaktor: Nikica Kusinikova

Autorë: Nikica Kusinikova, Konekt
Katerina Haxhi-Miceva Evans, QEDJ
Aleksandar Nikollov,
President i Trupit Nacional Kombëtar për OOP

Përkthimi: Jordana Shemko-Georgievska
VIPET 5

Dizajni: Koma, Lab.

Projekt: Krijim i mekanizmave pjesëmarrës për zhvillimin e kornizës ligjore e cila mundëson qëndrueshmëri financiare të organizatave qytetare.

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

„Ky publikim është përgatitur me ndihmen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Shoqatës Konekt dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton pikepamjet e Bashkimit Evropian“



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Analiza është mundësuar me mbështetjen shpirtgjerë të popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e autorit dhe nuk i shpreh qëndrimet e USAID-it dhe Qeverisë së ShBA-së.

PËR PUBLIKIMIN

Kypublikim ka për qëllim të japë një vështrim të përvojës së deritanishme nga zbatimi i Ligjit për Donacionet dhe Sponzorimet në Veprimtaritë Publike në MK. Ky publikim do të shërbejë si studim fillues dhe pritet të shfrytëzohet nga ana e institucioneve dhe palët e tjera të prekura në procesin e ardhshëm të revizionit të ligjit. Analiza, gjithashtu, do të përdoret nga Konekt dhe QEDJ në procesin e konsultimeve me palët e prekura në proceset e përmirësimit të kornizës ligjore për donacione dhe sponzorime.

Përveç pasqyrimit konkret të ligjit ekzistues, analiza përfshin një spektër më të gjerë dhe rekomandime në lidhje me çështjen e trajtimit të donacioneve dhe sponzorimeve të cilat mund të përdoren edhe në analizat e ardhshme dhe revizionet e normativës ligjore lidhur me këtë çështje.

Tematikusht, analiza synon që në mënyrë të qartë t'i pasqyrojë zbatimin e Ligjit dhe ndikimin e tij prandaj është e përshtatshme të përdoret nga publiku më i gjerë. Konekt dhe Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (QEDJ) janë në dispozicion të të gjithë lexuesve në njohjen e mëtejshme me këtë problematikë.

Kjo analizë nuk do të realizohet pa përfshirjen dhe mbështetjen e përdoruesve të ligjit dhe të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij. Para së gjithash, i falënderojmë përfaqësuesit e shoqatave, fondacioneve,

subjekteve afariste dhe institucioneve të shumta të cilat u përfshinë në këtë hulumtim dhe në debatet publike dhe e ndanë përvojën e vet në lidhje me përdorimin e Ligjit. Sidomos i falënderojmë për bashkëpunimin personat kompetentë në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Drejtorinë e të Hyrave Publike dhe Trupi Nacional Koordinues për OOP të cilët na ndihmuan shumë me ekspertizën e vet që t'i kuptojmë më mirë të gjitha aspektet e normativës dhe zbatimin e saj në praktikë. Në fund, një falënderim për donatorët tanë, Bashkimin Evropian dhe UDSID-in me ndihmën e të cilëve u përgatit dhe publikua kjo analizë.

Nikica Kusinikova
Konekt

Katerina Haxhi-Miceva Evans
Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse

КОHEKT

КОНСТРУКТИВНА

И СИТУАЦИОННА

ДИСКУСИЈА



Konekt është shoqatë qytetarësh misioni i të cilës është nxitja dhe promovimi i filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore në drejtim të zhvillimit afatgjatë. Në këtë drejtim krijimi i kornizës ligjore nxitëse në këtë fushë është në fokusin e veprimtarisë së organizatës.

Në domenin e filantropisë misionin organizata e realizon nëpërmjet:

- » Mbështetjes së objekteve afariste, pa marrë parasysh madhësinë, të japin donacione dhe të investojnë në shoqëri në mënyrë strategjike dhe me ndikim afatgjatë;
- » Nxitjes së individëve dhe familjeve që të japin donacione në mënyrë të mençur dhe të menduar;
- » Nxitjes së njerëzve kudo në Maqedoni që t'i planifikojnë donacionet e veta - edhe donacionet e vogla, kur janë të bashkuara mund të ndryshojnë shumë;
- » Ngritjes së vetëdijes për potencialin e filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore që të arrihet ndikimi i vërtetë në shoqëri.

Në domenin e përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve, misioni realizohet nëpërmjet:

- » Mbështetjes së objekteve afariste, pa marrë parasysh madhësinë, që të integrojnë parimet e përgjegjësisë shoqërore në strategjinë afariste dhe në praktikën e vet. Besojmë se kur PShP-ja integrohet në strategjinë e biznesit, ajo i mundësoj ndërmarrjes produktivitet të zmadhuar, inovacione dhe zhvillim afatgjatë të qëndrueshëm;

- » Ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve për zhvillim të qëndrueshëm si te subjektet afariste ashtu edhe në shoqëri.

Aktivitetet e Konektit përfshijnë:

- » konsultime dhe shërbime të drejtpërdrejta për ndërmarrjet, individët dhe familjet e tyre;
- » përfaqësim për kornizën ligjore dhe rrethin që nxit filantropinë dhe përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjeve;
- » analiza, hulumtime dhe përgatitje raportesh;
- » shkëmbim të praktikave të mira dhe përvojave krahasuese;
- » lehtësim të partneriteteve midis sektorit qytetar dhe atij afarist;
- » ndërtim të kapaciteteve të ndërmarrjeve, organizatave qytetare dhe institucioneve.

Në punën e vet, Konekt, vëmendje të veçantë i kushton mbështetjes në ndërtimin e partneriteteve thelbësore dhe produktive ndërsektoriale midis ndërmarrjeve dhe organizatave jofitimprurëse, institucioneve publike dhe bashkësive.

Konekt është zëvendës Neni në Trupin Nacional Koordinues për PShN-në Republikën e Maqedonisë dhe kryesues i Odës Ekonomike Amerikane në MK. Konekt ka funksionin e Sekretariat të Rrjetës Maqedonase në Marrëveshjen Globale dhe është qendër kontaktuese e Rrjetit Rajonal për PShN të Bizneseve të Vogla në Evropën Qendrore, Jugore dhe Lindore.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	10
REZYMEJA PËRFUNDUESE.....	11
HYRJA.....	16
SPEKTRI I ANALIZËS DHE QASJA METODOLOGJIKE.....	17
PËRMBAJTJA E ANALIZËS.....	18
I. KONTEKST.....	21
RELEVANCA DHE ZBATIMI I DERITANISHËM I LIGJIT.....	23
QASJA POZITIVE E LIGJIT.....	27
II. PËRKUFIZIMI DHE INTERPRETIMI	
I TERMINOLOGJISË KRYESORE.....	31
2.1. PËRKUFIZIMI I DONACIONEVE DHE SPONZORIMEVE.....	31
2.2. PËRKUFIZIMI I INTERESIT PUBLIK	
DHE VEPRIMTARISË PUBLIKE.....	32
2.3. PËRKUFIZIMI I MARRËSVE DHE SHFRYTËZUESVE TË	
DONACIONEVE/SPONZORIMEVE.....	52
2.4. PËRKUFIZIMI I PROMOCIONIT DHE REKLAMËS.....	60
III. VLERËSIM I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR VËRTETIM TË	
INTERESIT PUBLIK DHE REALIZIMI I NXITJEVE TATIMORE.....	65
3.1. GJENDJA EKZISTUESE.....	65
3.2. SFIDA NË REALIZIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE.....	68
3.3. REKOMANDIME NË LIDHJE ME	
PROCEDURËN ADMINISTRATIVE.....	72
IV. MADHËSIA E NXITJEVE TATIMORE EKZISTUESE	
DHE SFIDA NË ZBATIMIN E TYRE.....	79

4.1. GJENDJA AKTUALE.....	80
4.2. SFIDAT DHE NDIKIMET E NXITJEVE TATIMORE TË PARASHIKUARA.....	83
4.3. REKOMANDIME	89
V. EVIDENTIMI, LAJMËRIMI, KONTROLLI DHE DISPOZITAT E PENALE TË DONACIONEVE DHE SPONZORIMEVE TË CILAT JANË OBJEKT I NXITJEVE TATIMORE	95
5.1. GJENDJA AKTUALE	95
5.2. SFIDA	97
5.3. REKOMANDIME	102
VI. REKOMANDIME PËR NDRYSHIME NË DISPOZITAT E LIGJIT	107
6.1. PËRKUFIZIME DHE KOMENTIME TE TERMINOLOGJISE KRYESORE	108
6.2. PROCEDURA ADMINISTRATIVE PËR VËRTETIMIN E INTERESIT PUBLIK DHE REALIZIMI I NXITJEVE TATIMORE.....	111
6.3. NIVELI I NXITJEVE TATIMORE DHE ZBATIMI I TYRE NË PRAKTIKË.....	114
6.4. EVIDENTIMI, RAPORTIMI DHE KONTROLLI	116
ANEKS 1 - LIGJI PËR DONACIONE DHE SPONZORIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE	121
ANEKS 2 - PËRFUNDIME NGA DEBATI MBIKËQYRËS I KOMISIONIT TË KULTURËS NË PARLAMENTIN E MK-SË.....	135
ANEKS 3 - PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME NGA FORUMET NDËRSEKTORIALE.....	139

LISTA E SHKURTESAVE

OQ	Organizata qytetare
TVSh	Tatimi i vlerës së shtuar
BE	Bashkimi Evropian
QEDJ	Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse
LDSVP	Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike
LShF	Ligji i Shoqatave dhe Fondacioneve
OIP	Organizata me Interes Publik
TPH	Tatimi Personal i të Hyrave
TPH-GDP	Ekzemplar i paraqitjes tatimore vjetore për TPH
DHP	Drejtoria e të Hyrave Publike
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar

REZYMEJA PËRFUNDUESE

Donacionet dhe sponsorimet prekin jetën e pothuajse të gjithë qytetarëve në shtetin tonë. Sipas hulumtimeve, mbi 70% e qytetarëve në RM japin donacione gjatë gjithë vitit, gjithashtu edhe më shumë se gjysma e ndërmarrjeve. Një pjesë e madhe e qytetarëve, personalisht apo nëpërmjet organizatave ku janë anëtarësuar kanë qenë marrës apo dhënës të sponsorimeve apo donacioneve. Donacionet dhe sponsorimet përbëjnë një burim të rëndësishëm të mbështetjes në zgjidhjen e problemeve në shumë fusha me interes publik: arsim, sport, kulturë, shëndetësi, në fushën sociale etj. edhe janë shumë të rëndësishme për qëndrueshmërinë financiare të organizatave qytetare. Për shkak të këtij spektri dhe ndikimi të donacioneve në shoqëri, shumë shtete mundësojnë lehtësime tatimore me të cilat nxitet aktiviteti filantropik i qytetarëve dhe ndërmarrjeve.

Në shtetin tonë, në vitin 2006 është sjellë Ligji i Donacioneve dhe Sponsorimeve në Veprimtaritë Publike (dhe ka ndryshuar në vitin 2008 dhe 2011). Ai për herë të parë në mënyrë sistematike ka mundësuar që personat vendas fizikë dhe juridikë të marrin lehtësime tatimore për donacione dhe sponsorime për qëllime të interesit publik. Duke pasur parasysh se analizat vendase dhe krahasuese tregojnë se qytetarët dhe ndërmarrjet konsiderojnë se lehtësimet tatimore janë një stimul i rëndësishëm për donacionet, ligji është relevant dhe e arsyeton qëllimin për të cilin është sjellë. Për ata të cilët japin donacione, ligji mundëson

nxitje tatimore në domenin e tatimit personal të të hyrave, tatimit të fitimit, tatimit të vlerës së shtuar dhe tatimit të pronës.

Qasja e miratuar nga Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike ka aspekte pozitive në kuptimin e qasjes liberale në përfshirjen e marrësve dhe dhënësve, objektin e donacioneve, nxitjeve tatimore në domenin e shumë llojeve të tatimeve etj. Megjithatë, edhe pse ekziston ligji i cili formalisht funksionon, praktika tregon se ekzistojnë sfida të rëndësishme në zbatimin e tij. Shumë ndërmarrje (sidomos ato të mesmet dhe të vogla) vendosin të mos e shfrytëzojnë ligjin, edhe pse do të dëshironin, qytetarët, gjithashtu, pothuajse nuk e shfrytëzojnë atë. Në këtë mënyrë, ligji nuk u shërben atyre për të cilët është sjellë.

Shoqata Konekt ka një mision të vetëm ta promovojë dhe nxitë filantropinë dhe përgjegjësinë shoqërore të drejtuar kah një zhvillimi afatgjatë. Në këtë drejtim, krijimi i kornizës ligjore nxitëse në këtë domen është në fokusin e veprimit të organizatës. Në vitet e kaluara, në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (QEDJ) e ndjekim zbatimin e ligjit dhe nga aspekti i shfrytëzuesve, por edhe nga institucionet. Si rezultat i këtyre njohurive, si edhe në debatet publike duke përfshirë këtu edhe Debatin Mbikëqyrës të organizuar nga Komisioni i Kulturës në suazat e Parlamentit, është marrë vendimi për ndryshime në Ligj, dhe i njëjti është përfshirë në programin vjetor të qeverisë.

Kjo analizë është proceduar për nevojat e Ministrisë së Drejtësisë, të grupit të punës i cili do t'i përgatisë ndryshimet e ligjit si edhe për konsultimet më të gjera me palët e prekura, shfrytëzuesit e ligjit. Ajo jep pasqyrim të detajuar të dispozitave të ekzistuese të ligjit dhe jep rekomandime për rishikimin e tyre.

Problemet e vërtetuara në zbatimin e ligjit në pjesën më të madhe nuk janë rezultat i zbatimit jopërkates së obligimeve nga institucionet, por para së gjithash kanë të bëjnë me vetë dispozitat e përcaktuara me Ligjin dhe interpretimin e tyre.

Sfidat dhe rekomandimet kryesore për tejkalimin e tyre të cilat dalin nga analiza janë:

- » ***Nevoja e rishikimit të përkufizimeve dhe interpretimin e terminologjisë kryesore:*** disa prej përkufizimeve kryesore, sidomos ato për *veprimtarinë publike* dhe *interesin publik* nuk janë konzistente me kriteret përkatëse që çojnë drejt sfidave në interpretimin e tyre nga ana e institucioneve. Prandaj është e nevojshme revidimi i tërësishëm i tyre duke pasur parasysh gjatë kësaj për harmonizimin e tyre me ligjet e tjera të cilat i trajtojnë ato. Gjithashtu, përkufizimet duhet të jenë të qarta që të mundësohet interpretim përkatës nga ana e institucioneve, por edhe e përdoruesve të ligjit.
- » ***Procedura administrative për vërtetimin e interesit publik dhe realizimi i lehtësimeve tatimore:*** Procedura sipas së cilës mund të realizohet lehtësimi tatimor është e komplikuar nga shumë aspekte. Së pari mënyra sipas së cilës vërtetohet interesi publik e lë barrën e procedurës mbi dhënësin në vend që të jetë mbi marrësin (i cili ka për detyrë të zbatojë donacionin apo sponsorimin në fusha me interes publik). Së dyti, vë obligime të rëndësishme për dokumente dhe miratime të mëparshme duke përfshirë edhe marrëveshje dhe kërkesë të obligueshme me shkrim për vendim secilin donacion apo sponsorim më vete që e komplikon administrimin edhe tek administrata shtetërore edhe tek dhënësit/marrësit. Së treti, kohëzgjatja e madhe e procedurës nuk përkon me shpirtin e donacioneve, të cilat në praktikë më shpesh janë urgjente dhe kërkojnë realizim momental prej dhënësit. Së katërti, krijon vështirësi dhe barrë të madhe administrative për institucionet në realizimin e obligimeve të cilat dalin nga ligji. Në fund, vendimi ligjor çon deri tek pasiguria juridike e përdoruesve të ligjit si për shkak të përfshirjes së një numri të madh organesh ashtu edhe për shkak të mosekzistimit të përkufizimit të detajuar dhe konzistent të termeve kryesore dhe interpretimit subjektiv të interesit publik nga ana e personave përgjegjës.

Në këtë drejtim, është i domosdoshëm revidimi i tërësishëm i procedurës dhe thjeshtëzimit të saj. Kjo mund të realizohet nëpërmjet lidhjes së statusit të interesit publik me marrësin, që tek shoqatat dhe fondacionet është në përputhje me statusin e vendosur me Ligjin

për Shoqatat dhe Fondacionet¹. Gjithashtu, do të lihet mundësia për procedurë të dyfishtë për ata marrës të cilët nuk kanë status të tillë, kurse përsëri realizojnë projekte me interes publik. Në rastin e dytë procedura duhet ta realizojë marrësi dhe jo dhënësi. Duke u zvogëluar në këtë rast barra e administratës shtetërore, sepse do të anashkalohej në këtë rast përfshirja e të gjithë organeve shtetërore kompetente për çdo donacion dhe sponsorim të mëvetësishëm. Me vendosjen e evidencës përkatëse nga ana e institucioneve do të anashkalohej nevoja e dokumentacionet të madh në çdo hap të realizimit të nxitjes tatimore. Gjithashtu, është e nevojshme lirimi nga obligimi për bërjen e marrëveshjeve me shkrim për shuma më të vogla sidomos për donatorët individualë.

- » **Nivelet e beneficioneve tatimore:** Praktika dëshmon se dispozitat për nxitjen tatimore të tatimit të të hyrave personale pothuajse nuk zbatohen për shkak të : 1) interpretimit të terminologjisë në dispozitë; 2) mënyrës se si është vendosur në fletëparaqitjen tatimore vjetore; 3) mungesës së mundësisë reale për shfrytëzimin e saj nga personat të cilët realizojnë të hyra vetëm në bazë të rrogës; 4) nivelet kufizuese të nxitjes tatimore të cilat nuk nxitin nivele më të larta të donacionit tek personat me të ardhura më të mëdha. Gjithashtu, ekzistojnë vështirësi në realizimin çlirimit prej TVSh-së tek daljet e telekomunikimeve. Ekziston edhe nevoja e hapjes së diskutimit në lidhje me faktin se a janë me të vërteta nxitëse për dhënësit beneficionet ekzistuese tatimore, si dhe sa është ndikimi i tyre mbi buxhetin shtetëror në drejtim të revidimit të tij.
- » **Evidentimi, lajmërimi dhe kontrolli:** Procesi i lajmërimit për donacionet dhe sponsorimet e dhëna dhe të marra është shumë i vështirë për përdoruesit dhe nuk korrespondon me qëllimin për të cilin përdoret. Sistemi i paraparë i kontrollit është i paqartë dhe nuk e identifikon me saktësi kompetencën e institucioneve të ndryshme në aspekte të ndryshme të kontrollit. Prandaj nevojitet revidim i sistemit në drejtim të: 1) thjeshtëzimit të lajmërimit të dhënësve dhe marrësve në masën e cila është mjaft e saktë që DHP-ja t'i përcaktojë nivelet e donacioneve dhe sponsorimeve të cilat mund t'i gëzojnë nxitjet tatimore dhe 2) saktësimin të rolit të institucioneve në raport me aspektet e ndryshme të kontrollit

1 Gazeta Zyrtare nr. 52/2010

(kufizim midis kontrollit të realizimit të lehtësimit tatimor nga kontrolli mbi keqpërdorimet e donacionit/sponzorimit nga ana e marrësit).

Analiza tregon se nevojiten ndryshime themelore në ligj të cilat jo vetëm që do të mundësojnë zbatim më të thjeshtë të tij por edhe do ta nxitin kulturën e dhënies së donacioneve në vendin tonë. Gjithashtu, do ta afrojnë me praktikat normative evropiane më të mira në rregullimin e këtij lloji beneficionesh. Gjatë kësaj, duke e pasur parasysh se ligji prek një numër të theksuar përdoruesish (qofshin dhënës, marrës apo institucione të cilat e zbatojnë ligjin), është e domosdoshme ndryshimet e ligjit të përgatiten me kujdes, me një proces të gjerë konsultimesh me palët e prekura

HYRJA

Ky dokument ka për qëllim të japë një pasqyrë të nxitjeve të cilat dalin nga zbatimi i deritanishëm i Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike në MK. Analiza e përfshin aspektin e efektit të dispozitave ligjore ekzistuese mbi nxitjen e donacionit/sponzorimit në aktivitetet me interes publik. Dokumenti, gjithashtu, ofron edhe një kornizë për analizimin e zgjidhjeve të mundshme në procesin e revidimit të ligjit dhe jep rekomandime për hapat e mëtejshëm.

Analiza do të shërbejë si studim fillestar dhe pritët të përdoret nga institucionet dhe palët e tjera të prekura në procesin e ardhshëm në revizionin e ligjit. Ajo do të përdoret si bazë për përgatitjen e rekomandimeve për ndryshimet në ligj.

Në procesin e përgatitjes së analizës dhe rekomandimeve për ndryshime në ligj, janë marrë parasysh edhe përvojat krahasuese e shteteve të tjera evropiane.² Si rrjedhim, rekomandimet janë përgatitur duke pasur parasysh praktikën pozitive në këtë domen në shtetet e tjera të Evropës, por edhe nevojat dhe specifikat e shoqërisë maqedonase dhe normativës ligjore.

2 Analiza krahasuese është përgatitur nga ekspertë të Qendrës Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse paralelisht me përgatitjen e analizës së Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike në MK.

Spektri i analizës dhe qasja metodologjike

Analiza fokusohet në disa aspekte kryesore:

- » Përkufizimet në ligjin ekzistues me theks të veçantë në përkufizimin e interesit publik dhe veprimtarive publike për qëllimet e nxitjeve tatimore;
- » Përkufizimet në ligjet e tjera të cilat kanë të bëjnë me interesin publik dhe veprimtaritë publike duke përfshirë edhe Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet;
- » Përkufizimet dhe kriteret për marrësit dhe dhënësit të cilët mund të gëzojnë nxitjet tatimore;
- » Procedurën administrative për realizimin e nxitjeve tatimore;
- » Procedurën për përcaktimin e interesit publik;
- » Beneficionet ekzistuese tatimore dhe sfidat në implementimin e tyre;
- » Kontrollin, lajmërimin dhe evidentimin e donacioneve/ sponzorimeve të cilat kanë nxitje tatimore;
- » Spektrin e mbingarkesës së administratës dhe implikimeve fiskale.

Aty ku është relevante, analiza jep edhe një përvojë krahasuese me shtetet e tjera evropiane.

Metodologjia e zbatuar në këtë analizë bazohet në qasjen kualitative dhe përbëhet nga kontrolli i ligjeve ekzistuese dhe analiza në këtë domen si edhe konsultimet dhe intervistat ekstensive me palët e prekura. Më konkretisht metodologjia ka përfshirë:

- » Analizë dhe kontroll të dokumenteve ekzistuese lidhur me këtë problematike (ligje, raporte, analiza etj.);
- » Analizë të përvojave në vendet e tjera në Evropë (kornizë ligjore, praktika);
- » Intervista të thella, qëllimore, gjysmë të strukturuar me përfaqësuesit e palëve relevante të prekura: (1) përfaqësuesit e ministrive kryesore dhe institucionet shtetërore (Drejtoria e të Hyrave Publike); (2) ndërmarrjet me aktivitete të theksuara

në donacion/sponzorim; (3) marrës të donacioneve dhe sponzorimeve të cilët kanë pasur përvojë me përdorimin e ligjit;

- » Konsultime në lidhje me rezultatet paraeliminuese dhe rekomandimet me palët kryesore të prekura (grupet e fokusit, forum ndërmjet sektorëve³).

Të dhënat dhe konsultimet e siguruara më parë nga palët e prekura si pjesë e punës vijuese të Konket janë shfrytëzuar, gjithashtu në zhvillimin e përfundimeve dhe rekomandimeve.

Përmbajtja e analizës

Dokumenti është organizuar në disa kapituj të cilët i ndjekin aspektet kryesore në analizë. Pas hyrjes, kapitulli 1 flet për kontekstin i cili e ka iniciuar përgatitjen e kësaj analize. Kapitulli 2 jep pasqyrim të përkufizimeve ekzistuese në Ligj dhe në ligjet e tjera vendase me theks të veçantë në përkufizimin e interesit publik dhe veprimtarive publike. Ai, gjithashtu, përfshin edhe përcaktimin e marrësve dhe dhënësve të mundshëm të donacioneve dhe sponzorimeve të cilët gëzojnë nxitje tatimore. Në kapitullin 3 analizohet procedura administrative për realizimin e beneficioneve tatimore duke përfshirë edhe mënyrën se si përcaktohet interesi publik dhe mbingarkesa e administratës shtetërore. Kapitulli 4 diskuton nxitjet tatimore ekzistuese, zbatimin e tyre dhe shkallën deri tek e cila ato i nxisin dhënësit dhe marrësit që ta përdorin ligjin. Kapitulli 5 e përfshin aspektin e evidencës dhe kontrollit të nxitjeve tatimore. Në çdo kapitull më vete janë dhënë drejtime dhe opsione për ndryshime në dispozitat e veçanta të ligjit të cilat do të mundësojnë efikasitet dhe efektivitet të tij të zmadhuar. Në fund, kapitulli 6 ofron opsione për ndryshime të ligjit të cilat do të mundësojnë efektivitet dhe efikasitet të tij të zmadhuar.

3 Përfundimet e forumit ndërmjet sektorëve janë prezantuar në Aneksin 3



I. KONTEKSTI

Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë publike është miratuar në prill të vitit 2006⁴, kurse ka nisur të zbatohet në vitin 2007. Ligji, për herë të parë, mundësoi që qytetarët dhe ndërmarrjet të fitojnë lehtësime tatimore për donacione dhe sponzorime në fusha të interesit publik dhe kjo për shoqata, fondacione dhe një rreth më të gjerë të atyre që marrin donacione (deri në atë vit zvogëlime tatimore ishin paraparë vetëm për donacionet për Kryqin e Kuq dhe institucionet shtetërore). Qëllimi primar i ligjit është ta nxisë kontributin (nëpërmjet donacioneve dhe sponzorimeve) të ndërmarrjeve dhe qytetarëve në fusha me interes publik (arsim, kulturë, ndihma sociale, mjedisi jetësor, shëndetësi, sport etj.). Nëpërmjet kësaj synon të kontribuojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve, shoqatave dhe fondacioneve, personave fizike dhe juridikë, në mirëqenien e tyre ekonomike dhe drejtësinë sociale. Ligji ishte propozuar nga 5 deputetë he ishte mbështetur nga 73 deputetë nga të gjitha grupet parlamentare.

Pas miratimit të Ligjit, janë miratuar edhe aktet nënligjore: 1) Rregullorja për Formën dhe Mënyrën e Dhënies së Vërtetimit me Shkrim për Donacione në Veprimtaritë Publike⁵ dhe 2) Rregullorja për Zbatimin e Nxitjeve Tatimore tek Tatimi i Vlerës së Shtuar për Donacione

4 Gazeta Zyrtare nr. 47/06

5 Miratuar nga Ministri i drejtësisë më 29 nëntor 2006 (Gazeta Zyrtare nr. 130/06)

në Veprimtaritë publike⁶. Me këto u përfundua edhe korniza ligjore e domosdoshme për zbatimin e ligjit. Në qershor të viti 2008 janë miratuar Ndryshimet e Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike të cilat kanë të bëjnë me dispozitat shkelëse (kapitulli V i Ligjit)⁷.

Në mënyrë plotësuese, në prill të viti 2011 janë miratuar Ndryshime dhe Plotësime të Ligjit të donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike⁸ nëpërmjet të cilave ndryshoi dhe u komplikua theksueshëm procedura për të dëshmuar interesin publik.

Si rezultat i debateve publike dhe pjesëmarrjes në media të cilat Konekt i ka organizuar në gjysmën e parë të vitit 2010 në bashkëpunim me Institutin Nacional për Demokraci dhe Institutin për Demokraci Parlamentare, në qershor të vitit 2010 Komisioni i Kulturës në Parlament organizoi Debat Mbikëqyrës për zbatimin e Ligjit. Në Debatin Mbikëqyrës ishin ftuar përfaqësues të ministrive relevante, ekspertë, organizata qytetare, përfaqësues të sektorit të biznesit dhe palët e tjera të prekura që të japin mendimin e vet për implementimin e ligjit. Përfundimet e debatit mbikëqyrës dëshmojnë se nevojitet përgatitja e një ligji të ri i cili do të zhvillohet në proces participues me pjesëmarrje të gjerë të palëve të prekura (Aneksi 2). Gjithashtu, ata e theksuan nevojën për zbatimin e një analize më të thellë mbi ndikimin e ligjit, e cila do të ndihmojë për nxjerrjen e rekomandimeve për përmirësimin e tij.

Si rezultat, Ministria e Drejtësisë si ministri kompetente për zbatimin dhe revizion të ligjit, formoi grup pune multisektoral i cili e ka përgatitur drift-propozimin e ndryshimeve të Ligjit. Përveç institucioneve shtetërore, në grupin e punës ka dy përfaqësues të organizatave qytetare.

Si rezultat, Ministria e Drejtësisë si ministri kompetente për zbatimin dhe revizionin e ligjit, formoi grup pune multisektorial i cili do të përpunojë drift-propozim të ndryshimeve të Ligjit. Përveç institucioneve shtetërore, në grupin e punës ka edhe dy përfaqësues të organizatave qytetare. Në përgatitjen e analizës Konekt realizoi bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Ministrinë e Drejtësisë, ministri kompetente, e cila e mbështeti përgatitjen e një analize të tillë për nevojat e grupit të punës.

6 Miratuar nga Ministri i financave më 6 qershor 2007 (Gazeta Zyrtare nr. 90/07) dhe ndryshuar më 10 qershor të vitit 2008

7 Gazeta Zyrtare nr. 86/08

8 Gazeta Zyrtare nr. 51/11

Relevanca dhe zbatimi i deritanishëm i Ligjit

Donacionet dhe sponzorimet janë burim i rëndësishëm mbështetës në zgjidhjen e probleme në shumë fusha të interesit publik: arsim, sport, kulturë, mjedis social, shëndetësi etj. dhe sidomos janë të rëndësishme për qëndrueshmërinë financiare të organizatave joqeveritare. Për shkak të spektrit dhe ndikimit të tillë të donacioneve në shoqëri, shumë shtete mundësojnë lehtësime tatimore me të cilat nxitet aktiviteti filantropik i qytetarëve dhe ndërmarrjeve.

Edhe pse përvojat botërore dëshmojnë se beneficionet tatimore nuk janë motivi primar për dhënien e donacione, ato luajnë rolin kryesor në madhësinë dhe formën e donacionit duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në nivelin e resurseve lokale të cilat do të mobilizohen në fushat e interesit publik. Gjithashtu, nxitjet tatimore ndikojnë edhe mbi zhvillimin e kulturës së dhënies së donacioneve⁹.

Hulumtimi i kryer nga Konekt në domenin e praktikave të donacioneve tregoi se dy të tretat e qytetarëve në vendin tonë konsiderojnë se beneficionet tatimore janë një stimul i rëndësishëm për donacione, që është një qëndrim veçanërisht i theksueshëm tek qytetarët me të ardhura të larta. Ndërmarrjet, gjithashtu, u kushtojnë rëndësi beneficioneve tatimore - 71% konsiderojnë se ato janë shumë të rëndësishme, dhe 18% se janë të rëndësishme.

Qëndrimet e tilla të qytetarëve dhe ndërmarrjeve e vërtetojnë relevancën e zgjidhjes ligjore e cila do të mundësojë beneficione tatimore për ata të cilët japin donacione/sponzorime. Qëndrimet e tilla mund të mbështeten, gjithashtu edhe nga të dhënat e DHP-së të cila dëshmojnë se me vendosjen e nxitjeve tatimore në këtë sferë në fillim të vitit 2007, donacionet dhe sponzorimet në veprimtaritë publike shënojnë një ngritje të vazhdueshme.

9 Për më tepër shihni: "The Legal Environment of Private Philanthropy: International Comparative Survey" by Nilda Bullain, European Center for Not-for-profit Law (www.ecnl.org)

Numri i organizatave donatore dhe madhësia e donacioneve¹⁰

	Persona juridikë-donatorë	Ndryshimi në raport me 2007 (%)	Shuma e donacionit (denarë)	Ndryshimi në raport me 2007 (%)
2007	115	0	20 000 651	0
2009	209	+ 82	144 823 958	+ 624
2010, kuartali i parë ¹¹	94	+ 227	59 000 329	+ 1080

Megjithatë, shuma e përgjithshme e donacioneve dhe sponsorimeve si dhe numri i dhënësve të mbuluar nga Ligji janë mjaft më të vegjël se niveli i përgjithshëm i donacioneve dhe sponsorimeve të paraqitura në llogaritë vjetore të subjekteve afariste (shih Tabelën 2). Edhe pse shuma e përgjithshme e donacioneve dhe sponsorimeve nuk është e madhe sa duhet që t'i kënaqë të gjitha nevojat në veprimtaritë publike, ato kanë potencial të madh t'i mbështesin zhvillimin dhe projektet e një numri të konsiderueshëm shoqatash dhe fondacionesh të cilat veprojnë në interes publik. Zakonisht, në praktikën evropiane kjo gjë është qëllimi primar i nxitjeve tatimore - t'i nxitin donacionet dhe sponsorimet për shoqatat dhe fondacionet duke pasur parasysh se institucionet dhe institutet e tjera publike janë të financuara nga buxheti i shtetit i cili ka një shumë më të madhe që t'i kënaqë nevojat e veprimtarive publike. Megjithatë, duke pasur parasysh se në shtetin tonë nevojat në veprimtaritë publike shpesh janë mjaft më të mëdha se mundësitë e buxhetit, ligji synon të nxitë donacionin dhe sponsorimin e një rrethi më të gjerë marrësish.

¹⁰ Dëshmimi i drejtorit të Drejtorisë së të Hyrave Publike, z. Goran Trajkovski, në debatin në Parlament me temë "Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Zponsorimeve në Veprimtaritë publike".

¹¹ Të dhënat për ndryshimet procentuale kanë të bëjnë me një të katërtën e numrit të donatorëve, dhe shumën e donacioneve në vitin 2007.

Tabela 2. Nivele të donacioneve dhe sponzorimeve të paraqitura në llogaritë vjetore prej subjekteve afariste¹²

	viti 2007 (denarë)	viti 2008 (denarë)	viti 2009 (denarë)	viti 2010 (denarë)
Numri i subjekteve afariste të cilat kanë paraqitur donacione dhe sponzorime	847	399	656	2484
Sponzorime dhe donacione - gjithsej	438,568,792	473,036,824	425,067,100	500,491,963 (fletëparaqitjet e reja japin informacion vetëm për nivelin e sponzorimeve)
Donacione për organizata humanitare	36,214,224	2,512,341	18,673,977	
Donacione të qytetarëve	5,230,948	3,571,488	10,669,018	
Donacione dhe sponzorime për qëllime shkencore	35,085,961	35,819,371	17,916,032	
Sponzorime të manifestimeve kulturore	127,472,287	33,124,220	62,989,851	
Sponzorime të klubeve sportive	33,125,279	16,854,392	14,526,050	
Sponzorime dhe donacione të tjera	201,440,093	381,155,012	300,383,172	

12 Të dhëna të marra nga Regjistri Qendror për nevojat e Konekt.

Tabela 3. Të ardhurat vjetore të shoqatave dhe fondacioneve të paraqitura në llogaritë e tyre vjetore për vitin 2010¹³

Shënim: këto të dhëna janë vetëm të atyre shoqatave dhe fondacioneve të cilat kanë dorëzuar llogari vjetore në Regjistrin Qendror.

Të ardhura të përgjithshme	Numri i shoqatave	Numri i fondacioneve
0-100.000	174	7
100.001-500.000	655	15
500.001-1.000.000	333	5
1.000.001-5.000.000	483	28
5.000.001-10.000.000	104	3
10.000.001-50.000.000	93	16
50.000.001-100.000.000	8	2
mbi 100.000.000	4	2
Gjithsej shoqata dhe fondacione	1854	78

Tabela 4. Të dhëna të Drejtorisë së Pengimit të Larjes së Parave dhe të Financimit të Terrorizmit

Shuma në MKD	Shuma në Euro	Numri i përgjithshëm i organizatave
0-100.000	0-1.600	9.636
100.001-500.000	1.601 - 8.100	672
500.001-1.000.000	8.101 - 16.300	325
1.000.001-5.000.000	16.301 - 81.300	488
5.000.001-10.000.000	81.301 - 163.000	106
10.000.001-50.000.000	163.001 - 813.000	107
50.000.001-100.000.000	813.000 - 1.630.000	11
mbi 100.000.001	mbi 1.630.000	5
Gjithsej:		11.350

¹³ Të dhëna të marra nga Regjistri Qendror për nevojat e hulumtimit të kryer nga Konekt.

Nga zbatimi i deritanishëm i ligjit, sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë si edhe nga hulumtimi i Konekt mund të vihet re se sponsorimet janë pak më të shpeshta se donacionet (deri nga mesi i vitit 2010, 53% prej të gjitha kërkesave të dorëzuara kanë të bëjnë me sponsorimet përkundrejt 46% që kanë të bëjnë me donacionet). Sektori afarist është dhënësi më i madh dhe këtu veçohen ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare dhe bankat. Me përjashtim të fushës së sportit, në pjesën më të madhe marrës janë institucione nga fusha e arsimit, shëndetësisë dhe kulturës. Më pak është përfaqësuar dhënia e donacioneve për shoqatat dhe fondacionet e tjera. Gjithashtu, ekziston ndarje e pabarabartë jo vetëm tek marrësit, por edhe në vetë suazat e fushave. Kështu, për shembull, në fushën e arsimit më tepër jepen donacione në infrastrukturë dhe në dhënien e bursave, kurse shumë më pak në shkencë. Gjithashtu, në fushën e kulturës më shpesh mbështeten manifestimet ndërsa shumë më pak projektet nga fusha e arkeologjisë, e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore etj.

Qasja pozitive e ligjit

Qasja e miratuar në Ligjin e Donacioneve dhe Sponsorimeve në veprimtaritë publike ka aspekte pozitive në kuptimin e qasjes liberale si për shembull:

- » **Përkufizim i gjerë i objekteve të donacionit dhe sponsorimit** – ligji mundëson shfrytëzim të beneficioneve tatimore gjatë dhënies së donacioneve/sponsorimeve në të holla, të mira, shërbime, testamente dhe të drejta të tjera të trashëgueshme;
- » **Nxitje tatimore në domenin e shumë llojeve të tatimeve** – ligji parashikon beneficione tatimore në domenin e: 1) tatimit personal të të ardhurave, 2) tatimin e fitimit, 3) tatimin e vlerës së shtuar dhe 4) tatimin e pronës;
- » **Akses liberal ndaj dhënësve dhe marrësve** - në raport me dhënësit ligji i përfshin edhe personat juridikë edhe fizikë, vendas dhe të huaj. Marrësit mund të jenë persona juridikë vendas dhe të huaj me karakter jofitimprurës (është e ndaluar dhënia vetëm nga një ndërmarrje për një tjetër);
- » **Barazi midis donatorëve të huaj** dhe vendas në aspektin e çlirimeve tatim ore në raport me tatimin e vlerës së shtuar.

Qasja e këtillë jep bazë të mirë për shfrytëzimin e potencialit të resurseve lokale në fushat e interesit publik si dhe për nxitjen e kulturës filantropike në MK.



II. PËRCAKTIMI DHE INTERPRETIMI TERMINOLOGJISË KRYESORE

II. PËRCAKTIMI DHE INTERPRETIMI TERMINOLOGJISË KRYESORE

Ligji i Donacioneve dhe sponsorimeve në veprimtaritë publike në nenin 3 ka një fjalorth të termeve kryesore të cilat përdoren në këtë ligj. Vendosja e përkufizimit të terminologjisë kryesore është segment i rëndësishëm i çdo ligji sepse mundëson interpretimin përkatës në dispozitat e mëtejshme. Si rrjedhim, përkufizimi jo i qartë sa duhet i termeve kryesore mandej mund të çojë në keqkuptime, interpretime subjektive dhe vështirës në zbatimin e ligjit si nga organet shtetërore ashtu edhe nga shfrytëzuesit e tij. Prandaj analiza jep një pasqyrim të detajuar të përkufizimeve ekzistuese jo vetëm në aspektin e Ligjit por edhe të mënyrës sipas të cilës ata janë në korrelacion me dispozitat e tjera ligjore në shtet.

2.1. PËRKUFIZIMI I DONACIONEVE DHE SPONZORIMEVE

Në Ligj jepet përkufizimi përkatës për atë se çfarë është donacioni dhe çfarë është sponsorimi dhe prej palëve të prekura nuk është identifikuar ndonjë problem në përdorimin e kësaj terminologjie.

Në drejtim të plotësimit të këtyre përkufizimeve, përkufizimi i sponzorimit mund të plotësohet duke theksuar se kushtet për promovim të emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse të dhënësit të sponzorimit duhet të jepen në mënyrë eksplicite në marrëveshjen që në realitet i kufizon marrëveshjet për sponzorime nga ato për donacione (të cilat duhet të jenë pa kushte në kuptimin e promovimit).

2.2. PËRKUFIZIMI I INTERESIT PUBLIK DHE VEPRIMTARISË PUBLIKE

2.2.1. Përkufizimet ekzistuese në legjislacionin në MK

Interesi publik në këtë Ligj nuk është përkufizuar me kriterë precizë, por është përcaktuar në mënyrë ilustruese nëpërmjet dhënies të një numri të caktuar veprimtarish mbështetja dhe promovimi i të cilave është në interes të shoqërisë¹⁴. Gjatë kësaj, është lënë hapësirë interesi publik të zgjerohet edhe me veprimtari të tjera të interesit publik të përcaktuara me ligje të tjera.

Veprimtaritë publike, gjithashtu, janë përcaktuar në mënyrë ilustruese në Ligj nëpërmjet dhënies të një numri të caktuar veprimtarish, duke lënë hapësirë në këtë listë të futen edhe veprimtari të tjera të interesit publik të përcaktuara me ligje të tjera, që konsiderohet si praktikë e mirë edhe në nivel evropian edhe tek ne.

Sipas neni 61 paragrafi 1 i **Kushtetutës**, Kuvendi i MK-së është organi përfaqësues i qytetarëve dhe mbartës i pushtetit ligjvënës. Nga kjo rrjedh që ai është i autorizuar t'i përcaktojë kushtet për kryerjen e veprimtarive të veçanta sidomos për ato të cilat kanë specifikën e vet, kurse janë me interes publik dhe në të cilat realizohen disa të drejta të caktuara kushtetuese të qytetarëve¹⁵. Megjithatë, në “Kushtetutë nuk është përcaktuar se çfarë nënkuptohet me termin “interes publik” dhe në bazë të cilave kriterë ai përcaktohet me ligj”¹⁶.

¹⁴ Neni 3, paragrafi 1, pika 4 i LDSVP-së.

¹⁵ Gjykata Kushtetuese e MK-së, U. Numër: 28/2007-0-0 nga 12.9.2007.

¹⁶ Gjykata Kushtetuese e MK-së, U. Numër 200/2007-0-0 nga 17.12.2008.

Në përputhje me **Ligjin për Ndërmarrje Publike**¹⁷, neni 2, paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, veprimtaritë e interesit publik janë veprimtari apo punë të veçanta të veprimtarive të cilat realizojnë interes publik. Veprimtaritë e interesit publik i kryejnë ndërmarrjet publike apo shoqatat të cilave u është besuar kryerje e veprimtarive me interes publik¹⁸. Në përputhje me nenin 43 të këtij ligji, veprimtari me interes publik në shtetin tonë, mund të kryejnë personat fizikë dhe juridikë në bazë të lejes. Paragrafi 2 i këtij neni të Ligjit parashikon se leje për kryerjen e veprimtarive të veçanta me interes publik nga personat juridikë dhe fizikë, mund ta japë Qeveria, përkatësisht njësia e pushtetit lokal. Nga ndërmarrja publike pritet që t'i mbulojë të dalat me të hyrat, por nuk pritet që të realizojë me patjetër edhe fitim¹⁹. Sipas Ligjit të vjetër për ndërmarrjet publike i cili ka qenë në fuqi deri në vitin 2006, në vend të kategorisë “veprimtari me interes publik” është përdorur kategoria “veprimtari ekonomike me interes publik” përkatësisht veprimtari të cilat do të ishin “kusht i pazëvendësueshëm për jetën dhe punën e qytetarëve, për punën e personave juridikë dhe të organeve shtetërore”.

Në përputhje me **Ligjin e Institucioneve**, institucionet kryejnë shërbim publik si veprimtari e cila nuk është vendosur në veprimtaritë tregtare të përcaktuara me ligj (*veprimtari joekonomike*) dhe i cili me ligj mund të përcaktohet si veprimtari me interes publik²⁰. “Shërbimi publik” në përputhje me këtë Ligj është veprimtari të cilën e kryejnë institucionet në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes së invalidëve, si edhe veprimtari të tjera të cilat me ligj janë përcaktuar si shërbim publik. Nga lista e dhënë duket se institucionet formohen për të kryer veprimtari me karakter publik në disa fusha.²¹

Ligji i Shoqatave dhe fiondacioneve (52/2010) në mënyrë taksative i përcakton veprimtaritë me interes publik, por është e rëndësishme se jep mundësi me ligje të tjera të përcaktohen edhe veprimtaritë plotësuese

17 Ligji për Ndërmarrjet Publike (38/1996, 6/2002, 40/2003, 49/2006, 22/2007 и 83/2009).

18 Në këtë Ligj si sinonim përdoret termi «shërbime me interes publik».

19 Gjykata Kushtetuese e MK-së, U. Numër 48/2010-0-0 nga 22.12.2010.

20 Neni 2, Paragrafi 1, pika 21 dhe neni 3 i Ligjit për institucionet (32/2005, 120/2005 dhe 51/2011).

21 Gjykata Kushtetuese e MK-së, U. Numër 88/2005-0-0 nga 7-12.2005.

me interes publik. Në nenin 74 të këtij Ligji në mënyrë eksplicite janë dhënë këto veprimtari me interes publik:

- » zhvillimi i demokracisë, shoqërisë qytetare dhe të drejtave të njeriut,
- » ndihma dhe mbrojtja e personave me zhvillim të penguar dhe personave me nevoja të veçanta,
- » mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve,
- » mbrojtje e personave të marginalizuar dhe përfshirja e tyre sociale,
- » mbrojtja nga përdorimi i drogës, nga sëmundjet seksuale ngjitëse, delikuenca e të miturve, alkoolizmi, prostitucioni dhe tregtia me njerëz,
- » shëndetësi, përparim të shëndetësisë dhe kujdesit mjekësor,
- » arti, kultura dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore,
- » sporti amator,
- » mbrojtja e mjedisit jetësor dhe zhvillimit të qëndrueshëm,
- » zhvillimi lokal dhe infrastrukturor,
- » shkenca, arsimi dhe trajnimi në procesin arsimor,
- » zhvillimi i etikës dhe moralit,
- » ndihma humanitare dhe sociale, zvogëlimi i varfërisë,
- » ballafaqimi me fatkeqësitë elementare,
- » mbrojtja dhe kujdesi për kafshët,
- » mbrojtja e konsumatorëve,
- » përparimi i vullnetarizmit dhe mirëbërjes.

Ligji për herë të parë e vendos termin “organizatë me interes publik” në legjislacionin maqedonas. Shoqata, fondacione, lidhje dhe forma organizative të organizatës së huaj mund të marrin statusin e interesit publik nëse kryejnë veprimtari me interes publik, zbatojnë programe dhe projekte në nivel lokal dhe/apo qendror (në mënyrë të pavarur apo në bashkëpunim me organet e administratës shtetërore dhe organet e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetin Shkup) si edhe përdorin mjete financiare për realizim të aktiviteteve.

Që të fitojë statutin e organizatës me interes publik shoqata apo fondacioni duhet të jetë regjistruar dhe shifra kryesore e të ardhurave në punën e saj të jetë veprimtari me interes publik. Qëllimet e organizatës, punimi dhe veprimtaria duhet të jenë të drejtuara kah opinionit të gjerë dhe interesave të bashkësisë. Organizata duhet të ketë organ mbikëqyrës, kapacitete të nevojshme kadrovike, rregulla për pengimin e përplasjes së interesave dhe sigurimin e opinionit dhe transparencës në punë, dhe të ketë pronësi apo të ardhura vjetore minimum prej 1500 eurosh. Organizata e cila i plotëson këto kushte mund të dorëzojë kërkesë për dhënien e statusit të organizatës me interes publik në Komisionin për Organizata me Status me Interes Publik.

Është e dukshme mospërputhja e Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve me Ligjin e Shoqatave dhe Fondacioneve, si në raport me procedurën për përcaktimin e interesit publik, ashtu edhe në aspekt të veprimtarive të përcaktuara me interes publik, sidomos që edhe të dy ligjet kanë të bëjnë me shoqatat dhe fondacionet.²²

Ligji i Pushtetit Lokal (5/2002) vendosi term “punë me interes publik me rëndësi lokale”. Të përcaktuara në nenin 2, paragrafin 1, alinenë 8, si punë në interes të të gjithë bashkësisë lokale apo pjesë të caktuara të saj të cilat janë përcaktuar me ligj, ato mund të kryen prej komunës apo nga “shërbimet publike”, d.m.th. organizata jofitimprurëse për kryerjen e shërbimeve publike (ndërmarrje publike dhe institucione publike)²³. Ligji jep mundësi komuna ta delegojë²⁴ kryerjen e punëve të caktuara me interes publik me rëndësi lokale edhe personave të tjerë juridikë dhe fizikë, në bazë të marrëveshjes për kryerjen e punëve me interes publik.

Vlen të veçohet sidomos **Ligji për Kulturën**, për shkak të mënyrës specifike të përkufizimit të interesit publik. Në përputhje me këtë Ligj, ky interes në sferën e kulturës përcaktohet nëpërmjet dy kategorive:

- » interes lokal në kulturë - kultura që është interes publik me rëndësi lokale për qytetarët në njësitë e pushtetit lokal;

22 Deklaratë e përfaqësuesit të organizatës qytetare për nevojat e Hulumtimit të zbatuar nga Shoqata «Konekt», 2011.

23 Neni 2, paragrafi 1, alinea 10 i Ligjit të Pushtetit Lokal (5/2002).

24 Neni 24, paragrafi 2 i Ligjit të Pushtetit Lokal (5/2002)

përmbajtja, madhësia dhe realizimi i tij përcaktohen me aktet e përgjithshme të njësive të pushtetit lokal;²⁵

- » interes nacional në kulturë - kultura është interes publik për të gjithë qytetarët në Republikë dhe është e domosdoshme kryerja e saj e vazhduar, si dhe qasja e të gjithë qytetarëve nën kushte të barabarta.²⁶

Në realizimin e interesit publik në kulturë mund të përfshihen artis, artist i pavarur, institucion i cili kryen veprimtari në fushën e kulturës, ndërmarrje dhe shoqëri tregtare e regjistruar për kryerjen e veprimtarive nga fusha e kulturës, punëtor shkencëtar i cili kryen veprimtari shkencore në fushën e kulturës, person i cili arsimohet apo përmirësohet për nevojat e kulturës, dhe person juridik që përveç regjistrimit për kryerjen e veprimtarisë në një fushë tjetër është regjistruar edhe për kryerjen e veprimtarisë në fushën e kulturës - si për shembull, shoqatë qytetarësh nga fusha e kulturës.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë ligjet dhe fushat e ndryshme në të cilat rregullohet interesi publik.

25 Neni 7, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit të Kulturës (31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/2010, 47/2011, 51/2011).

26 Neni 8 i Ligjit të Kulturës (31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/2010, 47/2011, 51/2011).

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
E përgjithshme	Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe qytetarit; arsimi, shkenca, zhvillimi i shoqërisë informatike dhe përcjellja e të dhënave elektronike, mbrojtja sociale, mbrojtja e personave me invaliditet, dhurimi i gjakut, mbrojtja e fëmijëve, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe veprimtari të tjera publike janë të përcaktuara me ligje të tjera.	Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë publike
E përgjithshme	» zhvillimi i demokracisë, shoqërisë qytetare dhe të drejtave të njeriut, » ndihma dhe mbrojtja e personave me zhvillim të penguar dhe personave me nevoja të veçanta, » mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve, » mbrojtje e personave të marginalizuar dhe përfshirja e tyre sociale, » mbrojtja nga përdorimi i drogës, nga sëmundjet seksuale ngjitëse, delikuenca e të miturve, alkoolizmi, prostitucioni dhe tregtia me njerëz, » shëndetësi, përparim të shëndetësisë dhe kujdesit mjekësor, » arti, kultura dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, » sporti amator, » mbrojtja e mjedisit jetësor dhe zhvillimi i qëndrueshëm, » zhvillimi lokal dhe infrastrukturor, » shkenca, arsimi dhe trajnimi në procesin arsimor, » zhvillimi i etikës dhe moralit, » ndihma humanitare dhe sociale, zvogëlimi i varfërisë, » ballafaqimi me fatkeqësitë elementare, » mbrojtja dhe kujdesi për kafshët, » mbrojtja e konsumatorëve, » përparimi i vullnetarizmit dhe mirëbërjes. » veprimtari tjetër e përcaktuar me ligj	Ligji i Shoqatave dhe Fondacioneve
E përgjithshme	Veprimtari apo punë të caktuara prej veprimtarive me të cilat realizohet interes publik	Ligji i ndërmarrjeve publike
Veprimtari joekonomike	Kryerja e shërbimit publik si veprimtari e cila nuk është vendosur në veprimtaritë tregtare të përcaktuara me ligj (veprimtari joekonomik) në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes së invalidëve, si dhe në veprimtari të tjera të cilat me ligj janë përcaktuar si shërbim publik.	Ligji i institucioneve

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
Interes publik me rëndësi lokale	Punë me interes për të gjithë bashkësinë lokale apo për pjesë të caktuara të saj të cilat janë përcaktuara me ligj ku futet: » Planifikimi urbanistik (urban dhe rural) dhënia e miratimit për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimi i hapësirës dhe rregullimi i truallit ndërtimor; » Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës - masa për mbrojtjen dhe pengimin ndotjes së ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurmat dhe rrezatimi i pajonizuar; » Zhvillimi ekonomik lokal - planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal; përcaktimi i prioriteteve zhvilluese dhe strukture; udhëheqja e politikës ekonomike lokale; mbështetja e zhvillimit të të rinjve dhe ndërmarrjeve të mesme dh të sipërmarrjes në nivel lokal dhe në atë kontekst, pjesëmarrje në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetës lokale të institucioneve dhe agjencive dhe promovimi i partneritetit; » Veprimtari komunale - furnizimi me ujë të pijshëm; dërgim i ujit teknologjik; dërgimi dhe pastrimi ujërave të ndotura; ndriçimi publik; dërgimi dhe trajtimi i ujërave atmosferike; mirëmbajtja e pastërtisë publike; mbledhja, transportimi dhe vendosja e bërllokut komunal të fortë dhe teknologjik; rregullim dhe organizim i transportit publik lokal të udhëtarëve; furnizimi me gaz natyror dhe energji ngrohëse; mirëmbajtja e vareve, varrezave, krematuriumeve dhe dhënia e shërbimeve për varim; ndërtimi, mirëmbajtja, rikonstruksioni dhe mbrojtja e rrugëve, udhëve lokale dhe objekteve të tjera infrastrukturore; rregullim i regjimit të transportit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit rrugor të qarkullimit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirës publike për parkim; largimi i automjeteve të parkuara në mënyrë të paligjshme; largimi i automjeteve të prishura prej sipërfaqeve publike; ndërtimi dhe mirëmbajtja e tregjeve; pastrimi i oxhakëve; mirëmbajtja dhe përdorimi i parqeve, pyjeve park dhe sipërfaqeve për rekreacion; rregullimi, mirëmbajtja dhe përdorimi i shtratit të lumenjve në pjesët e urbanizuara; përcaktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore;	Ligji i vetëqeverisjes lokale

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
	» Kultura - mbështetja institucionale dhe financiare e institucioneve dhe projekteve të kulturës; kujdesi për folklorin, doket, zanatet e vjetra dhe vlerat e ngjashme kulturore; organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të ndryshme të shumëllojshme specifike të krijimit; » Sporti dhe rekreacioni - zhvillimi i sportit masiv dhe aktiviteteve rekreative; organizimi i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive; mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve sportive; mbështetja e aleancave sportive; » Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve - kopshte fëmijësh dhe azile pleqsh 9pronësi, financim, investim dhe mirëmbajtje); realizim të kujdesit social për personat invalidë;fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror; fëmijët me probleme sociale-edukuese; fëmijët e rrugës; personat e ekspozuar në rrezik social; personat e prekur nga përdorimi i drogës dhe alkoolit; ngritja e vetëdijës së popullsisëM strehimi i personave me rrezik social; realizimi i të drejtës dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollë. Kryerja e këtyre kompetencave është në përputhje me Programin Nacional për Zhvillim të Mbrojtjes Sociale; » Arsimi - themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave tetëvjeçare dhe të mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror, në përputhje me ligjin, organizim i transportit dhe ushqimit të nxënësve dhe strehimi i tyre në konviktet e nxënësve; » Mbrojtja shëndetësore - menaxhim i rrjetës së organizatave dhe objekteve publike shëndetësore të mbrojtjes primare shëndetësore të cilat duhet të përfshijnë përfaqësim të pushtetit lokal në të gjitha këshillat e të gjithave organizatave shëndetësore në pronësi publikeE edukim shëndetësor; përparim i shëndetit; aktivitete parandaluese; mbrojtja e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtja gjatë punës; mbikëqyrje shëndetësore e mjedisit jetësor; mbikëqyrje e sëmundjeve ngjitëse; ndihë për pacientët me nevojë të veçanta (për shembull, shëndet mendor, keqpërdorim i fëmijëve etj.) dhe fusha të tjera të cilat do të përcaktohen me ligj. » Zbatimi i Përgatitjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale prej shkatërrimeve të luftës, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera dhe prej pasojave të shkaktuara prej tyre;	

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
	» Mbrojtja nga zjarri që e kryejnë njësitë territoriale të zjarrfikësve; » Kontroll mbi kryerjen e punëve nga kompetencat e veta dhe » punë të tjera të përcaktuara me ligj.	
Kultura	» Kultura që është interes publik me rëndësi lokale për qytetarët në njësitë e pushtetit lokal; » Krijim i kushteve kadrovike, materiale e të tjera për realizimin e vazhdueshëm të kulturës; » Mundësimi i kushteve për realizimin dhe mbrojtjen e vlerave të larta kulturore; » Nxitja e shumëllojshmërisë dhe diversitetin në kulturë; » Sigurimi i kushteve për akses të qytetarëve në vlerat kulturore dhe përdorimi i tyre masiv; » Sigurimi i kushteve për realizimin dhe mbrojtjen e identitetit kulturor të bashkësive në MK; » Kujdes për zhvillimin kulturor: dhe realizim i të drejtave kulturore të pakicës maqedonase jashtë MK-së, të punësuarit e përkohshëm jashtë shtetit dhe emigrantët e shtetit tonë pa dallim të përkatësisë së tyre etnike; » Krijim i kushteve për zhvillim të barabartë të kulturës në Republikë; » Afirmim i kulturave dhe ndryshimeve kulturore të Republikës jashtë shtetit; » Hulumtime kulturore dhe » Mbrojtja e trashëgimisë kulturore si veprimtari me interes publik²⁷ me rëndësi për historinë, kulturën, artin, shkencën dhe teknikën, që rregullohet me ligj të veçantë.	Ligji për Kulturën
Kultura - Mbrojtja e trashëgimisë kulturore (dhe zhvillimi i qëndrueshëm)	» “Mbrojtja e trashëgimisë kulturore”, d.m.th. hulumtim, identifikim, valorizim, rivalorizim, kategorizim, shpallje, rregjistrim dhe shënim i trashëgimisë kulturore, ruajtje, respektim, kujdesje e saj dhe mirëmbajtje, konzervim, restaurim, rikonstruim, dislokim dhe rivitalizim, si dhe parandalim, mbikëqyrje, restituim, prezantim, popullarizim dhe çdo formë tjetër e ruajtjes direkte apo indirekte të trashëgimisë kulturore që realizohet me interes publik. » Zhvillim ekonomik dhe social i qëndrueshëm²⁸	Ligji i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore

27 Neni 5, paragrafi 2 nga Ligji i Kulturës (31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007,116/2010, 47/2011 dhe 51/2011).

28 Neni 69, paragrafi 2, alinea 4 nga Ligji i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore.

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
Ujëra	Menaxhim me ujërat, d.m.th. masa dhe aktivitete për:²⁹ » akses në sasinë e mjaftueshme të ujit të pijshëm cilësor, për prodhim të ushqimit, për nevojat e bujqësisë, industrisë, nevojat hidroenergjetikem për nevojat e parqeve dhe sipërfaqeve të tjera publike, turizmit, lundrimit dhe për nevoja të tjera; » mbrojtje, ruajtje dhe përmirësim të vazhdueshëm të resurseve ujore në dispozicion, përmirësim i gjendjes së tokave bregdetare, ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji, mbrojtje dhe përparim i mjedisit ujor nëpërmjet përdorimit racional dhe të qëndrueshëm të ujërave, si edhe zvogëlim progresiv i lëshimeve të dëmshme dhe eliminimi shkallë-shkallë i emisioneve të materialeve dhe substancave të rrezikshme në ujëra; » lehtësim i pasojave nga veprimtaria dëmtuese e ujërave dhe mungesa e ujit dhe » mbrojtje dhe përparim i mjedisit jetësor dhe natyrës të ekosistemeve ujore dhe të shumëllojshmërisë biologjike dhe mbrojtje e shëndetit të njerëzve.	Ligji i Ujërave
Ekzemplar i obligueshëm	Dorëzim i ekzemplarit të obligueshëm	Ligji për Ekzemplarin e Obligueshëm
Veprimtari komunale	Veprimtari komunale, ku përfshihet edhe furnizimi me ujë të pijshëm (mbledhje, përpunim dhe shpërndarje e ujit deri tek instrumenti matës i konsumatorit)	Ligji i veprimtarive komunale
Tokë ndërtimore	Rregullimi dhe përdorimi i tokës ndërtimore	Ligji për Tokën ndërtimore
Planifikimi hapësinor dhe urbanistik	Përpunim, dorëzimi dhe zbatimi i planit hapësinor në MK dhe i planeve urbanistike	Ligji i Planifikimit Hapësinor dhe Urbanistik
Shpallja e ligjeve dhe dispozitave të tjera	Shpallja e ligjeve dhe dispozitave e akteve të tjera dhe botimi në gazetën zyrtare, Gazeta Zyrtare e RM-së	Ligji për Shpalljen e ligjit dhe dispozitat e aktet e tjera në Gazetën Zyrtare të RM-së

²⁹ Neni 4, paragrafi 1, alinea 51 dhe neni 2 i Ligjit të Ujërave (87/2008, 6/2009, 161/2009, 83/2010 dhe 51/2011).

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
Ndërtimi i objektit me interes publik	Rregullimi, përdorimi racional dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës me ndërtimin e objekteve dhe kryerjen e punimeve të parapara me aktet e planifikimit të hapësirës që përfshijnë: » ndërtim të hekurudhave, rrugëve, urave, aeroporteve dhe objekteve shoqëruese dhe instalime; » ndërtim të centraleve për prodhim të energjisë elektrike, objekte, instalime dhe linja që janë për transferim dhe distribuim të asaj energjie; » ndërtim i objekteve dhe instalimeve për qarkullim postal, telefonik dhe telegrafik, instalime për lidhje radio dhe televizione dhe sisteme informacioni; » ndërtim i objekteve për mbrojtje dhe siguri civile; » ndërtim i kalimeve kufitare; » ndërtim i objekteve dhe ndërtesave për kërkim dhe eksploitim të mineraleve dhe pasurive të tjera natyrore; » ndërtim i objekteve dhe ndërtesave për menaxhimin e ujërave; » ndërtim i rrugëve, shesheve, parkingjeve, parqeve dhe skuerëve; » ndërtim i deponive, stacioneve pastruese dhe objekteve të tjera për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit jetësor; » ndërtim i gazsjellësve, naftësjellësve dhe linja të tjera; » ndërtim i ujësjellësit, kanalizimit, ngrohejs, varreve dhe objekteve të tjera komunale; » ndërtim i objekteve për arsimin, edukimin, shkencën, kulturën shëndetësinë, mbrojtjen sociale dhe sportin kur veprimtaria kryhet si shërbim publik.	Ligji për Ekspropriacion
Arkivim	Mbrojtja, ruajtja dhe përdorimi i lëndës së arkivuar	Ligji për Lëndën e Arkivuar
Të mira audiovizuale	Mbrojtja e të mirave audiovizuale	Ligji për të Mirat Audiovizuale
Qarkullimi	Përparimi i sigurisë së përgjithshme së qarkullimit në udhë	Ligji i Sigurisë së Qarkullimit në Udhë

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
Pyje	Planifikimi, menaxhimi, ekonomizimi dhe ruajtja e pyjeve dhe tokës pyjore	Ligji i pyjeve
Kryqi i Kuq	Realizimi i qëllimeve dhe detyrave humanitare nga fusha e shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe edukimit, të bazuar në parimet e humanizmit dhe solidaritetit	Ligji për Kryqin e Kuq në MK
Mbrojtja e fëmijëve	Mbrojtja e fëmijëve, dhe kjo nëpërmjet: » kujdesit dhe edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore; » pushimit dhe rekreacionit të fëmijëve dhe » formave të tjera të mbrojtjes.	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve
Mbrojtja shëndetësore	Veprimtaria shëndetësore, të cilën e përbëjnë masat, aktivitetet dhe procedurat për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit dhe mjedisit jetësor dhe të punës, të drejtat dhe obligimet që realizohen në sigurimin shëndetësor, si dhe masat, aktivitetet dhe procedurat të cilat i ndërmarrin organizatat nga fusha e shëndetësisë për ruajtje dhe përparim të shëndetit të njerëzve, parandalim dhe pengim të sëmundjeve, goditjeve dhe çrregullimeve të tjera të shëndetit, zbulimin e shpejtë të sëmundjeve dhe gjendjet e shëndetit, mjekim efikas dhe në kohë dhe rehabilitim me zbatim të masave, aktiviteteve dhe procedurave mjekësore-eksperte.	Ligji i Mbrojtjes Shëndetësore
Shëndetësia veterinarike	Mbrojtja shëndetësore e kafshëve, shëndetësia veterinarike publike dhe mbrojtja dhe mirëqenia e kafshëve	Ligji i Shëndetësisë Veterinarike
Mbrojtja sociale	Mbrojtja sociale si sistem masash, aktiviteteve dhe politikash për pengimin dhe tejkalimin e rreziqeve themelore sociale ndaj të cilave është i pasqyruar qytetari gjatë jetës, për zvogëlim të varfërisë dhe përjashtimit social dhe për përfundimin e kapacitetit të tij për mbrojtje personale. Si rreziqe sociale nënkuptohen rreziqet e shëndetit (sëmundje, goditje dhe invaliditet), rreziqet e vjetërsisë dhe mplakjes, rreziqet e familjes me një prind, rreziqet e papunësisë dhe humbjes së të ardhurave për mbajtje në bazë të punës, rreziqet e varfërisë dhe rreziqet e llojeve të ndryshme të përjashtimit social. Shtesë, kujdesi për ndalim të ndodhjes së rrezikut social realizohet nëpërmjet ndërmarrjes së masave në politikën tatimore, punësim, politikë për dhënie bursave, strehim, mbrojtjen e familjes, shëndetësi, edukim dhe arsim dhe në fusha të tjera në pajtim me ligjin.	Ligji i Mbrojtjes sociale

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
Biblioteka	Veprimtaria bibliotekare	Ligji për Bibliotekat
Rrugë	Planifikimi, ndërtimi, rikonstruksioni, mirëmbajtja dhe mbrojtja e rrugëve publike	Ligji për Rrugët Publike
MARNET	Zhvillim, organizim dhe menaxhim i rrjetit të vetëm telekomunikativ arsimor dhe kërkimor	Ligji për Themelim të MARNET
Kërkime gjeologjik	Kërkime gjeologjike themelore	Ligji i Lëndës së Parë Minerale
Muzeve	Aktiviteti i muzeve	Ligji i Muzeve
Shkenca dhe kërkimi	Kërkimet të cilat janë: » » kontribut për zhvillimin e kuptimit shkencor dhe ngritjen e nivelit shkencor në të gjitha rrethet, lëmit dhe fushat e shkencës » kontribut për transferim të njohurive, teknologjive dhe aftësive botërore; » kusht i përgjithshëm për zhvillimin e tërësishëm në MK; » nga fusha e identitetit kulturor dhe historik të popullit maqedonas si edhe qytetarët të cilët jetojnë në kufijtë e saj dhe janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vllleh, serb, rom, boshnjak që jetojnë në MK; » prezantim i rezultateve shkencore të arritura në botë dhe tek ne; » nga fusha e mbrojtjes dhe sigurisë dhe » trajnimit dhe përmirësimi i kuadrove shkencore - punë kërkuesi si edhe përmirësim dhe modernizim i infrastrukturës kërkimore-shkencore	Ligji për Veprimtarinë Shkencore-Kërkimore
Mbrojtja dhe shpëtimi	Mbrojtja dhe shpëtimi	Ligji i Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
Mësimi i përgjithshëm	Veprimtari e universiteteve të hapura qytetare për mësim të përgjithshëm d.m.th. veprimtari në fushën e arsimit formal të rinjve dhe personave të rritur (arsim tetëvjeçar për të rriturit, arsim i mesëm për të rriturit, trajnim profesional, arsim teknik dhe arsim pas arsimit të mesëm për të rritur kualifikime dhe rikualifikime) në përputhje me Ligjin e Arsimit të Rriturve si dhe arsimi joformal i rinjve dhe personave të rritur të drejtuar për trajnim për punë, për aktivitete të ndryshme sociale apo për zhvillim personal në përputhje me Ligjin e Arsimit të Rriturve	Ligji i Universiteteve të Hapura Qytetare për Mësim të Përgjithshëm
Menaxhim me mbeturinat	Menaxhime me mbeturinat	Ligji për Menaxhimin me Mbeturinat
Furnizimi me ujë dhe ujërat dalëse	Furnizim me ujë të pijshëm, si dhe dërgimi i ujërave urbane dalëse te recipienti	Ligji për Furnizim me Ujë të Pijshëm dhe Dërgimin e Ujërave Dalëse Urbane
Kullota	Punët e menaxhimit, përparimit dhe shfrytëzimit të kullotave	Ligji për Kullotat
Peshkimi dhe akuakultura	Mbrojtja e peshqve në ujërat peshkuese, shtimi i peshqve në ujërat peshkuese dhe ndërtimi i pikave të peshkimit	Ligji për Peshkimin dhe Akuakulturën
Arsimi tetëvjeçar	Veprimtaria e shkollës tetëvjeçare	Ligji i Arsimit Tetëvjeçar
Arsimi i mesëm	Veprimtaria që realizohet në shkollën e mesme	Ligji i Arsimit të Mesëm
Arsimi i Lartë	Veprimtaria në institucionet e arsimit të lartë	Ligji i Arsimit të Lartë
Mbrojtja e natyrës	Mbrojtja e Natyrës	Ligji për Mbrojtjen e Natyrës
Mjedisit Jetësor	Masat dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor	Ligji për Mjedisin Jetësor
Sigurimi pensional invalidor	Veprimtaria e Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në	Ligji i Sigurimit Pensional dhe Invalidor

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
Radiodifuzioni	Krijim dhe emetim të emisioneve me interes publik me të cilat pasqyrohet pluralizmi shoqëror dhe kulturor në shtet, ndërsa të cilat kanë përmbajtje informative, kulturore, arsimore, shkencore, sportive dhe argëtuese.	Ligji për Veprimtarinë e Radiodifuzionit
Ekonomia e Ujërave	Veprimtari të Ekonomisë së ujërave	Ligji për Ekonominë e Ujërave
Punësimi dhe sigurimi në rast të papunësisë	Veprimtaria e Agjencisë së Punësimit në MK	Ligji i Punësimit dhe Sigurimit në Rast të Papunësisë
Sigurimi shëndetësor	Veprimtaria e Fondit të Sigurimit Shëndetësor	Ligji i Sigurimit Shëndetësor
Menaxhim me trashëgiminë botërore dhe natyrore	Menaxhimi me trashëgiminë kulturore dhe natyrore botërore	Ligji i Menaxhimit me Trashëgiminë Botërore dhe Natyrore në Rajonin e Ohrit

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
Sport	» nxitje e aktiviteteve sportive të fëmijëve dhe të rinjve në suazat e federatave sportive nacionale; » organizim dhe zbatim i stërvitjes dhe ndeshjeve sportive për trajnim të sportistëve për të arritur rezultate të larta sportive; » nxitje e realizimit të programeve të federatave sportive; » nxitje dhe ndihmë në organizimin e shfaqjeve dhe manifestimeve sportive; » mirëmbajtje dhe funksionim i ndërtesave ekzistuese dhe planifikim i ndërtimit të objekteve për sport me interes publik; » mbrojtje shëndetësore, sigurim pensional dhe invalidor, kompensim për sigurim prej pasojave nga rastet fatkeqe dhe rreziqet, për sportistët e kategorizuar në përputhje me ligjin; » nxitje dhe ndihmë e veprimtarisë botuese në sport; » ndërtim dhe mirëmbajtje e rrjetit sportiv informatik; » zhvillimi i sportit masiv dhe aktiviteteve rekreative të qytetarëve, i përfshirë në programet e klubeve sportive dhe sportive-rekreative, në realizimin e sistemit sportiv shkollor dhe universitar për të gjithë, ndërsa sidomos aktivitete sportive-rekreative të personave me nevoja të veçanta; » organizim i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive, mbështetje të sistemit të garave në nivelin e komunave dhe nivelin e Qytetit të Shkupit. në sporte dhe kategori të caktuara, mbështetje e garave dhe manifestimeve tradicionale sportive, me karakter nacional dhe ndërkombëtar, mbështetje e sistemit shkollor studentor të garave, sistemit të manifestimeve dhe formave të garave për personat me nevoja të veçanta, si edhe aktivitete rekreative të qytetarëve; » mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve sportive, opërkaktim i rrjetit të objekteve sportive, kualifikim i tyre, mirëmbajtje, përdorim dhe pajisje e tyre, planifikim dhe ndërtim i objekteve sportive bashkëkohore dhe përcaktimi i zonave rekreative për sportin masiv;	Ligji për Sportin

Fusha	Veprimtari/aktivitete me interes publik	Ligji referent
	» përkrahje e lidhjeve komunale dhe Aleanca e Sporteve e Qytetit Shuk, si forma më e lartë e organizimit, e shprehur në sublimim të aktiviteteve dhe nevojave të klubeve sportive në rajonin e komunës dhe Qytetit Shkup, duke siguruar kushte hapësinore, materiale dhe kadrovike për funksionim e tyre; dhe » mbështetje dhe përparim i sportit, klubeve sportive dhe klubeve sportive profesionale të rregjistruara në rajonin e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetin Shkup.	

2.2.2.2. Sfida në përdorimin e terminologjisë së Ligjit në praktikë

Disa prej përkufizimeve në këtë Ligj, sidomos ato për *veprimtari publike*, *veprimtari me interes publik* dhe *interes publik* nuk janë konzistente dhe të shpjeguara qartë sa duhet me kriteret përkatëse që shpie tek sfidat në interpretimin e tyre nga ana e institucioneve.³⁰ Në praktikë shpesh ministritë përkatëse në përcaktimin e interesit publik nuk përdorin përkufizimet më të gjera të cilat i jep Ligji, por i zbatojnë konceptet e përcaktuara në normativën ligjore apo në praktikë në fushën e dhënë.

Mandej, neni 3 jep përkufizim të “interesit publik” i cili ndryshon në aspektin material nga përkufizimi “veprimtari publike” në të njëjtin nen dhe lidhja e tyre në tekstin e mëtejshëm të ligjit është e paqartë.³¹ Për shembull, shëndetësia, mbrojtja sociale, mbrojtja e fëmijëve dhe mbrojtja e personave me invaliditet janë përfshirë në përkufizimin e “veprimtarisë publike”, por nuk janë përmendur në mënyrë eksplicite në përkufizimin e “interesit publik”, por shfaqen të grupuara në një kategori të zgjeruar “veprimtari sociohumanitare”. Nga ana tjetër, etika, zhvillimi i shoqërisë qytetare dhe promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar shfaqen në përkufizimin e “interesit publik”, por jo edhe në “veprimtari publike”. Termi “veprimtari me interes publik” nuk është përkufizuar fare. Mund të supozohet se përkufizimi i tillë i “veprimtarisë publike” ka të bëjë me

30 Hulumtim i zbatuar nga Shoqata Konekt, 2011.

31 «Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike - implementimi dhe sfidat kryesore», Nikica Kusinikova në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (QEDJ), maj/qershor 2010.

fushat e interesit publik me të cilat merren institucionet publike, por ligji në asnjë segment nuk bën ndarje midis lehtësimeve tatimore për institucione dhe për marrësit e tjerë të cilët veprojnë në fusha të tjera të interesit publik. Në ligj këto terme përdoren njëherë njëri pa tjetri, kurse njëkohësisht termi “veprimtari publike” nuk përmendet në asnjë dispozitë vijuese të Ligjit. Plus, termi “veprimtari publike” nuk ka përkufizim eksplicit në legjislacionin maqedonas dhe krijon konfuzion konceptual midis veprimtarisë publike dhe private.

Përkrah kësaj, më sipër përmendëm se përkufizimet në këtë Ligj nuk i reflektojnë përkufizimet përkatëse në ligjet e tjera. Mandej, normativa ligjore në mënyrë të përgjithshme lë hapësirë për interpretime të ndryshme të interesit publik dhe në fusha të veçanta, të caktuara.

Për shembull, Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike e përcakton sportin në tërësi si veprimtari me interes publik. Sipas Ligjit për Sportin, interesi publik i përcaktuar në sferën e sportit përfshin edhe elementë të cilët futen tek sporti i lartë. Për dallim nga ky Ligj, Ligji i shoqatave dhe Fondacioneve e veçon sportin amator si veprimtari me interes publik. Komisioni i Kulturës në Kuvend kërkoi të bëhet analizë se a është e nevojshme të bëhet dallimi midis sportit të lartë dhe atij masiv.³²

Në fushën e arsimit, janë identifikuar raste kur ministria përkatëse ka dhënë mendim negativ për interesin publik për aktivitete arsimore të realizuara nga subjekte jofitimprurëse (shoqata) të cilat nuk janë pjesë e institucioneve publike të përcaktuara me ligjet në këtë sferë edhe pse Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve theksin e vendos mbi këtë fushë dhe jep një përkufizim më të gjerë të marrësve. “Në arsyetim qëndron se për shkak të faktit se organizata qytetare MCGO e cila është marrës i donacionit nuk është pjesë e strukturës së MASH-së prandaj nuk bëhet fjalë për plotësim të interesit publik”³³. Në këtë rast, Ministria e Arsimit

32 Përfundime të debatit mbikëqyrës me temë «Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike», të miratuara në seancën e mbajtur më 21.7.2010.

33 “Analiza e zbatimit të Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në veprimtaritë publike dhe rekomandime për përmirësimin e tij”, CIRA, 2010. Analiza është shfrytëzuar nga drejtori ekzekutiv i CIRA-s, z. Zoran Stojkovski, për nevojat e debatit parlamentar mbikëqyrës me temë “Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike”.

nuk është udhëhequr nga përkufizimi i interesit publik, por ka vendosur kriterin e vet në lidhje me marrësit i cili nuk parashikohet me Ligjin e Donacioneve dhe Sponzorimeve në veprimtaritë publike.

E njëjta sfidë është vërejtur edhe në mendimet e Agjencisë për të Rinjtë dhe Sportin e cila gjatë marrjes së vendimit nuk udhëhiqet nga ndjekja e terminologjisë për “interesin publik”, por në bazë të asaj se a është evidentuar marrësi në Regjistrin e Organizatave Sportive në përputhje me Ligjin për Sportin.

2.2.3. Rekomandime

Duke pasur parasysh sfidat e deritanishme në përkufizimin dhe përdorimin e terminologjisë lidhur me interesin publik dhe veprimtaritë publike është e nevojshme të kryhen ndryshime dhe harmonizime përkatëse. Kjo pasqyrohet edhe në përfundimet e debatit mbikëqyrës të Komisionit të Kulturës ku thuhet se “në raport me përkufizimin e nocioneve dhe termeve kryesore, është e domosdoshme harmonizimi me Ligjin e Shoqatave dhe Fondacioneve, si edhe me dispozitat e tjera ligjore, të cilat e përkufizojnë interesin publik dhe organizatat/institucionet me interes publik”.³⁴ Gjithashtu, ky problem është adresuar edhe nga pjesëmarrësit në forumet ndërsektoriale të cilat Konekt i organizoi në Shkup dhe Prilep.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e legjislacionit maqedonas në raport me përkufizimin e veprimtarive publike dhe interesin publik, si dhe sfidat e përmendura më sipër, rekomandohet Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike të rishikohet në drejtimin që vijon:

- » Duke pasur parasysh se termi “veprimtari publike” krijon konfuzion dhe nuk gjen zbatim praktik në dispozitat e ligjit të cilat i përcaktojnë nxitjet tatimore dhe mënyrën se si fitohen ato, termi “veprimtari publike” duhet të fshihet nga terminologjia kryesore (neni 3). Në atë rast, në përdorim do të mbetet termi “interes publik” (i cili kryesisht përdoret edhe në tekstin e tanishëm të ligjit). Njëkohësisht emri i ligjit do të

34 Përfundimet e debatit mbikëqyrës me temë «Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë publike», miratuar në seancën e mbajtur më 21.7.2010.

pësonte zëvendësimin përkatës dhe do të riemërohej në **“Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Interes Publik”**.

- » Nëse ndryshimet e ligjit kanë si qëllim ta mbajnë spektrin e gjerë të fushave me interes publik të cilat do të mund t'i gëzonin nxitjet tatimore (që është praktikë tek shumica e vendeve evropiane), në numërimin e fushave me interes publik mund të ndërmerren fushat e dhëna në Ligjin e Shoqatave dhe Fondacioneve³⁵. Ato janë gjithëpërfshirëse, me një ndryshim të vogël tek sporti ku në vend të “sportit amator” duhet të vendoset “sport” që ta integrojë edhe sportin e lartë që është në drejtim edhe të përfundimeve të Debatit Mbikëqyrës në Parlament. Për ta shpjeguar më tepër, termi “interes publik” mund të përkufizohet edhe nëpërmjet karakteristikave të përgjithshme të cilat e reflektojnë shpirtin e interesit publik. Për nevojat e këtij ligji, termi “interes publik” mund të reflektohet nëpërmjet kriterëve që vijnë më poshtë:
- » aktivitetet/projektet të jenë në drejtim të opinionit të gjerë dhe të interesave të bashkësisë (në nivel lokal dhe nacional);
- » aktivitetet/projektet të jenë me karakter jofitimprurës (të mos nënkuptojnë shpërndarje të fitimit eventual të realizuar midis themeluesve, anëtarëve, anëtarëve të organeve, drejtorëve, të punësuarve apo cili do person tjetër që lidhet me ta).

Me përkufizim të tillë të termit Ligji do të harmonizohet me Ligjin e Shoqatave dhe Fondacioneve, por njëkohësisht lë hapësirë edhe për zbatim të përkufizimeve të cilat zbatohen në ligjet e tjera. Kjo njëkohësisht do të jetë në përputhje edhe me praktikën pozitive evropiane.

Përkufizimi i interesit publik nëpërmjet zbatimit të kriterëve më të gjera do t'i anashkalojë sfidat e identifikuar në domenin e sportit dhe kulturës sepse do të mundësojnë zbatim të përkufizimeve për interes publik si në Ligjin e Shoqatave dhe Fondacioneve, ashtu edhe në ligjet nga fusha e sportit, kulturës, dhe arsimit.

35 Neni 74, Veprimtari me interes publik, Kapitulli XI. Statusi i Organizatave me interes publik, G.Z. 52/2010

2.3. PËRKUFIZIMI I MARRËSVE DHE PËRDORUESVE TË DONACIONEVE/SPONZORIMEVE

2.3.1. Gjendja ekzistuese

Në nenin 3 të Ligjit përkufizohen termet “person fizik vendas”, “person fizik i huaj”, “person juridik vendas” dhe “person juridik i huaj” të cilët mandej në ligj përdoren për përkufizimin e asaj se çfarë mund të jetë dhënës dhe marrës i donacionit/sponzorimit që do të gëzojë beneficione tatimore.

Në këtë drejtim, mandej në nenin 6, 7 dhe 8 të Ligjit përkufizohen dhënësit dhe marrësit e mundshëm të donacioneve dhe sponsorimeve dhe kjo:

- » dhënës mund të jetë çdo person fizik dhe juridik vendas dhe i huaj;
- » marrës i donacionit apo sponsorimit mund të jetë person juridik vendas;
- » marrësi i donacionit mund të jetë edhe person juridik i huaj i cili ka karakter jofitimprurës për realizimin e interesit publik në shtet tjetër në rastet e fatkeqësive elementare, katastrofave natyrore deh humanitare.

Njëkohësisht, me nenin 18 prej nxitjeve tatimore janë hequr donacionet dhe sponsorimet: 1) e përdorura për aktivitete të marrësit të dhëna për mbështetjen e partive politike dhe fushatave partiake si edhe 2) me të cilat një ndërmarrje i jep një ndërmarrjeje tjetër.

Sipas krahasimeve me legjislacionet e shteteve të tjera evropiane, shpërndarja e tillë e gjerë për të gjithë personat juridikë si marrës është mjaft liberale.

Nga ana tjetër personat fizikë nuk mund të përdorin beneficione tatimore si marrës të donacioneve dhe sponsorimeve, që është praktikë

e mirë rregullimi në këtë fushë në Evropë (Serbi, BeH, Republika Serbe, Hungari, Finlandë, Slloveni etj.).³⁶

Në nenin 19 të ligjit futet termi “përdoruesi përfundimtar” në kontekst të lajmërimit për përdorimin e donacionit dhe sponsorimit, por ky term nuk përdoret apo përkufizohet në asnjë vend tjetër. Nga ana tjetër përdorimi i terminologjisë, si edhe të dhënat të cilat kërkohen në raportin e kërkuar nga DHP-ja për donacione dhe sponsorime (ekzemplarë “DHP-IDS/DV” dhe DHP-IDS/PR”) thotë se “përdorues përfundimtar” mund të jetë edhe person fizik.

2.3.2. Sfida në përdorimin e terminologjisë në këtë Ligj

Terminologjia ekzistuese për dhënësit dhe marrësit e donacioneve dhe sponsorimeve e cila është përkufizuar nëpërmjet shumë neneve të këtij ligji krijon dyshime gjatë zbatimit të tij.

Domethënë, edhe pse me nenin 6 dhënës mund të jetë çdo person juridik vendas dhe i huaj, nëse ndiqet përkufizimi për person juridik vendas ai i përfshin shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet me interes publik që do të mund të thotë se shoqatat dhe fondacionet e tjera nuk mund të shfaqen si dhënës. Në praktikë nuk ka ndodhur ndonjë dhënësi t'i refuzohet nxitja tatimore në këtë bazë ndoshta sepse deri në vitin 2010 nuk është vendosur statusi i organizatave me interes publik. Miratimi i Ligjit të Shoqatave dhe Fondacioneve dhe vendosja e këtij statusi e obligon nevojën që të harmonizohet terminologjia.

Ligji i Donacioneve dhe Sponsorimeve në veprimtaritë publike në mënyrë eksplicite vendos se “shoqatat dhe fondacionet me interes publik” kanë të drejtën e nxitjeve tatimore gjatë marrjes së donacionit apo sponsorimit. Ligji i ri i shoqatave dhe fondacioneve i përcakton organizatat me interes publik (OIP) dhe mënyrës se si mund ta marrin këtë status. Edhe pse Ligji thotë se edhe persona të tjerë juridikë mund të përdorin nxitje tatimore si marrës të donacioneve dhe sponsorimeve, megjithatë duhet pasur parasysh se formulimi i tillë i kësaj dispozite mund t'i kufizojë të gjitha shoqatat dhe fondacionet të gëzojnë nxitje tatimore. Komisioni i Kulturës në Parlament të kërkojë të bëhet analizë

36 Beneficione tatimore për donatorët, Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (QEDJ), 2010.

për atë se a duhet të kufizohen nxitjet tatimore për marrësit vetëm për OIP apo të përfshihen të gjitha shoqatat dhe fondacionet³⁷.

Nevoja që të mundësohen beneficione tatimore për të gjitha organizatat mbështetet edhe nga Ligji i Shoqatave dhe Fondacione i cili parashkruan se të gjitha shoqatat dhe fondacionet kanë lehtësime tatimore dhe doganore (neni 7, paragrafi 2), kurse OIP-të kanë lehtësime tatimore dhe doganore shtesë.

Edhe pse Ligji i parashikon personat juridikë dhe fizikë të huaj si dhënës të donacioneve dhe sponsorimeve, duhet të përmendet se në praktikë ata mund të përdorin nxitje tatimore vetëm nëse janë regjistruar në shtetin tonë dhe janë tatimpagues të tij. Në të kundërt, ata nuk i nënshtrohen tatimit në shtetin tonë dhe si rrjedhim nuk përfshihen me beneficionet tatimore të parapara.

Ligjet për anashkalimin e tatimit të dyfishtë nuk i përfshijnë donacione, prandaj si rrjedhim personat e huaj fizikë dhe juridikë nuk do të kishin mundësi t'i shfrytëzojnë beneficionet tatimore gjatë shlyerjes të tatimeve në shtetet e tyre amë në bazë të procedurës dhe dokumentacionit të siguruar në shtetin tonë në përputhje me Ligjin.

Edhe pse dispozita e nenit 18 e përjashton mundësinë për donacion/sponsorim nga një ndërmarrje te tjetra, me përkufizimin e gjerë të marrësve, nuk e përjashton mundësinë për donacion/sponsorim prej personit fizik për ndërmarrjen, d.m.th. shoqëri tregtare që është në kundërshtim me praktikën e mirë evropiane.

Dispozita në nenin 7, paragrafi 2 me të cilën mundësohet marrësi të jetë person juridik i huaj me karakter jofitimprurës për realizim të interesit publik në shtet tjetër në rastet e fatkeqësive elementare, katastrofave humane dhe natyrore është e nevojshme të rishikohet dhe harmonizohet me parimet e reja të BE-së të cilat kanë të bëjnë me donacionet përtej kufijve dhe kërkojnë trajtim të njëjtë me donacionet e dhëna personave

37 Përfundime nga debati mbikëqyrës me temë «Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponsorimeve në Veprimtaritë publike» miratuar në seancën e mbajtur më 21.7.2010.

të huaj në suazat e Bashkimit Evropian nën të njëjtat kushte dhe qëllimi si edhe për personat vendas.³⁸

Personat fizikë nuk janë vendosur në këtë Ligj si marrës të cilët fitojnë nxitje tatimore, dhe as donacionet për ta nuk janë objekt i nxitjeve tatimore për dhënësin. Sipas dëshmive të përfaqësuesve të ndërmarrjeve nga fusha e telekomunikacionit, kjo gjendje reflektohet negativisht në punën me numrat humanitarë për donacione të hapura te operatorët telefonikë për mbledhjen e mjeteve për mjekim urgjent jashtë shteti apo ndonjë lloj tjetër ndihme. Në përputhje me Ligjin, operatorët llogarisin dhe paguajnë 18% TVSh të mjeteve të donuara që është objekt kritike nga ana e konsumatorëve të shërbimeve të tyre, sepse janë të irrituar nga fakti se për donacionin për qëllime humanitare u llogaritet 18 TVSh. Plus gjatë transferimit të mjeteve të mbledhura për personin fizik i cili është përdorues i fundit i donacionit, i njëjti ka obligim pagimin e tatimit personal të të ardhurave. Gjatë kësaj, shpesh operatorët apo fondacionet e themeluar prej tyre në emër të personit fizik - përdoruesit të donacionit humanitar - e paguajnë edhe tatimin personal. Në të kundërt, personat fizikë të cilëve u nevojitet ndihma do të merrnin një shumë së cilës i zbritet procenti i tatimit personal.

3.3. Rekomandime

Përkufizimi i marrësve dhe dhënësve të donacioneve dhe sponzorimeve është një prej çështjeve kryesore e cila mandej do të ndikojë edhe mbi nxitjet tatimore si dhe mbi procedurën sipas së cilës do të realizohen nxitjet tatimore. Prandaj është e nevojshme të kryhet rishqyrtim i përkufizimeve ekzistuese duke pasur parasysh sfidat e lartpërmendura dhe përvojat evropiane dhe botërore në këtë domen.

38 Veçanërisht janë të rëndësishme dy vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në këtë fushë: *ECJ, 14 September 2006, Case C-386/04, Centro di Musicologia Walter Stauffer v. FA München für Körperschaften (Walter Stauffer)* u *ECJ, 27 January 2009, Case C-318/07, Hein Persche v. Finanzamt Lüdenscheid (Persche)*. Në përputhje me këtë shumë vende i kanë ndryshuar ligjet e veta që të mundësojnë dhënie donacioni të personave juridikë në shtete të tjera, sidomos vende të Bashkimit Evropian (Bullgaria, Finlanda, Gjermania, Sllovenia, Polonia, Danimarka etj.).

Në përkufizimet ekzistuese në nenin 3, përkufizimi për person juridik vendas duhet t'i përfshijë të gjitha shoqatat dhe fonadacionet, përkundrejt vetëm shoqatat dhe fondacionet me interes publik siç është momentalisht në ligj, që mandej në pjesën e marrësve, ata të degëzohen më konkretisht.

Dhënës të donacioneve dhe sponsorimeve

Në raport të dhënësve të donacioneve dhe sponsorimeve në përputhje me praktikën pozitive botërore duhet të ruhet spektri i gjerë i dhënësve të mundshëm dhe ata t'i përfshijnë të gjithë personat fizikë dhe juridikë.

Shtesë, duhet të theksohet se ky ligj nuk i përfshin donacionet të cilat vijnë nëpërmjet ndihmës të huaj zhvillimore dhënësit e të cilës nuk i nënshtrohen tatimit.

Marrës të donacioneve dhe sponsorimeve

Në raport me përkufizimin e marrësve, propozohet në ligj atë të vendosen në mënyrë taksative (siç është bërë për shembull edhe në Ligjin e Vullnetarizmit). Gjatë kësaj duhet të kihet parasysh nëpërmjet përkufizimit të marrësve të ruhet shpirti për karakterin jofitimprurës të vetë donacioneve apo sponsorimeve.

Prandaj, në shumicën e vendeve jo vetëm në Evropë por edhe në botë, nxitjet tatimore të donacioneve dhe sponsorimeve janë kufizuar vetëm në subjektet juridike jofitimprurëse. Subjektet ekonomike zakonisht janë përjashtuar nga kategoria e marrësve sepse për shkak të qëllimit të tyre primar për rritjen e fitimit të arritur është e vështirë të bëhet dallimi ku përfundon interesi publik, kurse ku gjenerohet fitimi.

Duke pasur parasysh se në disa fusha, si për shembull kultura, ekzistojnë subjekte ekonomike të cilat realizojnë projekte të cilat nuk kanë potencial për fitim të lartë, kurse njëkohësisht janë të rëndësishëm për nxitjen e interesit publik në domenin e kulturës, shteti si edhe Komisioni Evropian (nëpërmjet programeve për kulturë) parashikon subvencione buxhetore në projekte të tilla ku si mbartës mund të paraqiten edhe subjekte afariste d.m.th. shoqëri tregtare. Nga ana tjetër, nxitjet tatimore gjithmonë janë të kufizuara vetëm në organizatat me karakter jofitimprurës.

Në mënyrë plotësues, me Ligjin ekzistues për shoqatat dhe fondacionet lihet mundësi edhe subjektet juridike të jenë themelues jo vetëm të fondacioneve por edhe të shoqatave, kështu që në këtë mënyrë subjektet afariste të cilat dëshirojnë të realizojnë aktivitete jofitimprurëse me interes publik mund të kryenin dallimin në veprimtarinë e tyre dhe si rrjedhim të kenë mundësi të gëzojnë beneficione tatimore për projekte të tilla.

Në raport me personat fizikë si marrës, siç është përmendur edhe më sipër, shumica e normativave botërore dhe evropiane nuk parashikojnë beneficione tatimore. Shkaqet për praktikën e tillë dalin nga nevoja për mbrojtjen e interesit publik dhe sigurimi i nivelit të nevojshëm të transparencës dhe raportimit. Domethënë, në rast të donacioneve për person fizik, zakonisht bëhet fjalë për mjete dedikuar plotësisht të nevojës individuale të personit dhe jo plotësisht të interesit më të gjerë publik. Mandej, niveli i raportimit tek personat fizikë është shumë më i ulët, për dallim nga subjektet juridike të cilat janë të obliguara të dorëzojnë raporte fiskale të detajuara, i nënshtrohen revizionit dhe kontrollit financiar dhe zakonisht kanë rregulla dhe procedura për sigurimin e opinionit në punë.

Prandaj, rekomandohet në Ligj të ruhen dispozitat të cilat parashikojnë mundësi që vetëm personat juridikë të jenë marrës të donacioneve dhe sponzorimeve të cilat do të gëzojnë beneficione tatimore.

Është e rëndësishme të përmendet se këto dispozita nuk e kufizojnë mundësinë për gëzimin e beneficioneve tatimore të donacioneve të dhëna në fondacione (midis të cilave dhe korporative) apo fonde të udhëhequra nga shoqata të cilat mandej rishpërndahen si donacione për persona fizikë. Në këtë rast, personi fizik është përdoruesi i fundit, por marrësi i donacionit është personi juridik me karakter jofitimprurës. Në këtë mënyrë mund të realizohen edhe nxitjet tatimore të numrave për donacione të operatorëve telefonikë.

Në praktikën krahasuese zakonisht marrësit kufizohen në subjekte me karakter jofitimprurës, por në shtete të ndryshme ka ndryshim në përfshirje. Kështu, për shembull, në Hungari marrës mund të jenë organizata me status me interes publik, Fondi Hungarez për Shpëtim, Fondi Nacional për Kulturën. Në Poloni marrës mund të jenë të gjitha shoqatat dhe fondacionet të cilat veprojnë në veprimtaritë me interes

publik të cilat në mënyrë taksative janë dhënë në Ligjin për Veprimtari me Interes Publik dhe Vullnetarizëm. Në Kroaci dhe Bullgari ligji i përfshin si marrës shoqatat, por edhe më gjerë institucionet e tjera të cilat veprojnë në fusha me interes publik. Ngjashëm është edhe në Slloveni. Në Estoni, nxitje tatimore mundësohen tek organizata të regjistrit të miratuar nga Qeveria (sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht), subjektet e regjistruara në regjistrin e shoqatave fetare, institucioneve publike në domenin e shkencës, kulturës, sportit, arsimit dhe mbrojtjes sociale si edhe universitete.

Tabela e mëposhtme jep rezyme të marrësve të mundshëm të donacioneve dhe sponzorimeve në përputhje me dispozitat e legjislacionit të cilat i përcaktojnë organizatat që mund të kryejnë veprimtari me interes publik.

Marrës të mundshëm	Koment
Shoqata, fondacione, aleanca dhe forma organizative të shoqatave të huaja në përputhje me Ligjin e Shoqatave dhe Fondacioneve	Në momentin e përpunimit të kësaj analize u formua Komisioni për Organizatat me Status të Interesit Publik, por ende nuk ka nisur nga puna, kështu që asnjë organizatë nuk e ka fituar statusin e tillë. Madje edhe kur të fillojë të japë propozime për dhënien e statusit të interesit publik me kërkesë të shoqatave qytetare, mund të supozohet se procesi i marrjes së këtij statusi nga organizatat të cilat duan dhe kanë mundësi t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara do të vazhdojë një periudhë kohore pothuajse të madhe. Duke pasur parasysh kushtet dhe kriteret e nevojshme (për shembull, kriterin organizatave të kenë resurse financiare përkatëse, përkatësisht vlerë të përgjithshme pronësie apo të ardhura vjetore prej minimum 1.500 eurosh në vlerë në denarë) është e logjikshme të supozohet se organizatat lokale të cilat, para të gjithash, për shkak të qasjes së kufizuar të burimeve të mjeteve nuk do të kenë mundësi t'i plotësojnë ato (kurse, përsëri kryejnë aktivitete të rëndësishme me interes publik në bashkësitë lokale). Prandaj, propozohet të mendohet për mundësinë të mbetet vendimi me të cilin si marrës të cilët kanë nxitje tatimore paraqiten të gjitha shoqatat dhe fondacionet, kurse dallimi midis OIP-ve dhe shoqatave të tjera mund të bëhet nëpërmjet dallimit në procedurën për marrjen e nxitjeve tatimore nëpërmjet shkallëve të ndryshme të nxitjeve tatimore (siç parashikon edhe vetë Ligji i Shoqatave dhe Fondacioneve).

Marrës të mundshëm	Koment
Institucion, këtu përfshihen edhe institucione arsimore nga të gjitha shkallët e arsimit	Institucionet kryejnë shërbim publik si veprimtari e cila nuk është e vendosur në veprimtaritë tregtare të përcaktuara me ligj (veprimtari joekonomike) dhe e cila me ligj mund të përcaktohet si veprimtari me interes publik ³⁹ ; Institucionet arsimore gjithashtu kryejnë.
Organe të administratës shtetërore	
Njësia e pushtetit lokal	
Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve	
Kryqi i Kuq i MK-së	Organizata kryen detyra me interes publik të përkufizuara me ligj të veçantë; ⁴⁰
Kisha, bashkësi fetare, grup fetar dhe shoqata të tyre ⁴¹	Nëpërputhje me nenin 19 të Ligjit për Mbrojtje Sociale, bashkësitë fetare, grupet fetare dhe shoqatat e tyre të cilat janë regjistruar në shtetin tonë, mund t'i ndihmojnë personat të cilët kanë nevojë për lloje të caktuara të mbrojtjes sociale. Sipas të njëjtit Ligj veprimtaria e mbrojtjes sociale është veprimtari me interes publik.
Klub sportiv i regjistruar si shoqatë sportive	Në përputhje me Ligjin për Sportin (29/2002, 66/2004, 81/2008, 18/2011 dhe 51/2011), klub mund të jetë shoqatë sportive apo shoqëri tregtare e cila kryen veprimtari sport. Format e tjera të organizimit në sport janë regjistruar sipas Ligjit e Shoqatave dhe Fondacioneve.

Në ligj duhet të vendoset përkufizimi përkatës për *personat e huaj juridikë me status të organizatave me interes publik si marrës të donacioneve dhe sponzorimeve në drejtim të harmonizimit me parimet e reja të Bashkimit Evropian në lidhje me donacionet përtej kufijve*.⁴⁰

Në suazat e forumeve ndërsektorëve është dhënë edhe propozimi që të bëhet grupim i marrësve në dy grupe: 1) ata të cilët nuk janë financuar në mënyrë dominuese nga buxheti (si p.sh. shoqatat) dhe 2) ata të cilët në pjesën më të madhe janë financuar nëpërmjet Buxhetit publik. Në përputhje me këtë është propozuar secila prej grupeve t'u nënshtrohet lehtësimeve të ndryshme tatimore.⁴¹

Përdoruesit përfundimtarë

40 Në përputhje me Ligjin për Kryqin e Kuq (41/1994, 7/1997 dhe 21/1998).

41 Të regjistruar sipas Ligjit për Pozitën Juridike të Kishës, Bashkësisë Fetare dhe Grupit Fetar (113/2007).

Në kuptimin e këtij ligji “përdoruesit e fundit” do të përkufizoheshin si subjekte apo bashkësi lokale të cilat për një afat të gjatë do të kenë dobi nga aktivitetet e zbatuara me donacionin/sponzorimin e dhënë në nivel të shoqërisë apo fushës së dhënë. Ata do të përfshihen si pjesë e qëllimeve të donacioneve/sponzorimeve në drejtim të përcaktimit të interesit publik. Megjithatë, në kontekstin e beneficioneve tatimore ata nuk preken drejtpërdrejt. Domethënë, për realizimin e beneficioneve është e rëndësishme përkufizimi i dhënësve dhe marrësve, por jo edhe i përdoruesve të fundit të cilët shpesh përkufizohen në suaza më të gjera (në nivel të bashkësisë).

Në këtë drejtim, duhet të bëhen ndryshime përkatëse në ligj në pjesën e lajmërimit për përdorimin e donacionit dhe sponzorimit (shih Kapitullin V).

2.4. PËRKUFIZIMI I PROMOCIONIT DHE REKLAMËS

2.4.1. Gjendja ekzistuese

Në nenin 3, paragrafi (9), promocioni përkufizohet si theksim afirmues i emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse të dhënësit të donacionit dhe sponzorimit për kryerje të veprimtarisë publike.

Mandej, në nenin 9 thuhet se “Shpallja e emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse të dhënësit të donacionit dhe sponzorimit në mediat publike, elektronike dhe të botuara nuk konsiderohet si reklamë”.

2.4.2. Sfida në përdorimin e terminologjisë në këtë ligj

Dispozitat e tilla flasin për moskonsistencë në përkufizimin e vetë termeve të donacionit dhe sponzorimit dhe dallimet midis tyre. Terminologjia e tillë, gjithashtu, nuk është harmonizuar si duhet me terminologjinë e Ligjit për Veprimtari të Radiodifuzionit. Sipas këtij

ligji “Reklamim është çdo shpallje duke përfshirë edhe programin e radiodifuzuesit i cili ka për qëllim nxitjen e shitjes, blerjes apo dhënies me qira të prodhimeve dhe shërbimeve, promovim të ndonjë aksioni apo ideje apo arritje të ndonjë efekti tjetër të dëshiruar nga porositësi apo vetë radiodifuzuesi, që kryhet me pagesë apo me ndonjë kompensim tjetër përkatës apo për qëllime vetëpromovuese.”

Këto dispozita në praktikë krijojnë vështirësi si në përkufizimin e kushteve të sponsorimit ashtu edhe në trajtimin e fushatave të realizuara me mjete prej donacioneve dhe sponsorimeve. Në përputhje me dëshmitë e përdoruesve të ligjit në suazat e debatit mbikëqyrës të Komisionit të Kulturës “mediat të cilat do të duhej pa rezervë t’i mbështesin projektet me interes publik, kohë pas kohe kërkojnë prej zbatuesve të projekteve t’i heqin logot e donatorëve apo sponsoruesve dhe me vetë këtë kërkesë e shkelin Ligjin”⁴². “Problemi ynë i vetëm është refuzimi prej shtëpive televizive dhe mediave të botuara të shfaqin logon dhe emrin e kompanisë.”⁴³ Me sjelljen e tillë të mediave lëshohet mundësia të nxitet përgjegjësia dhe vetëdija shoqërore për domosdoshmërinë e dhënies së donacioneve në projekte me interes publik.

2.4.3. Rekomandime

Në këtë ligj është e nevojshme më saktësisht të përcaktohen dallimet në theksimin e emrit të donatorit me promovimin e emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse në rastin e sponsorimit. Sponsorimi si raport i dakorduar mbështetet pikërisht në sigurimin e dobisë direkte të të mirave dhe shërbimeve më shpesh nëpërmjet reklamimit përkatës, përkatësisht promovimit.

Në praktikën botërore ekzistojnë rregulla për përcaktimin deri në ç’masë theksimi i dhënësit në rastin e donacionit konsiderohet si reklamë dhe kur ky raport trajtohet si sponsorim në cilin rast de fakto bëhet fjalë për reklamë.

42 Deklaratë e përfaqësuesit të shoqatës «Borka» për nevojat e debatit mbikëqyrës parlamentar me temë «implementimi i Ligjit për Donacionet dhe Sponsorimet në Veprimtaritë Publike» .

43 Deklaratë me shkrim nga ShA Makedonski Telekom - Shkup, e dorëzuar për nevojat e debatit mbikëqyrës parlamentar me temë «implementimi i Ligjit për Donacionet dhe Sponsorimet në Veprimtaritë Publike».

Kështu, për shembull, reklamimi në kontekstin e sponsorimit do të konsiderohej në rastin kur përfshin:

- » shpallje e madhe dhe e theksuar e logos së dhënësit në cilindo material/publikim/resurs të botuar të marrësit;
- » shpallje e madhe dhe e theksuar në ngjyrat korporuese të dhënësit;
- » përshkrim i të mirave dhe shërbimeve të marrësit.

Tjetër dobi e drejtëpërdrejtë në rastin e sponsorimit do të përfshinte edhe:

- » përdorim të listës së e-maileve të marrësit nga ana e dhënësit;
- » përdorimi i logosë së marrësit nga ana e dhënësit;
- » mbështetje për përdorimin e prodhimeve dhe shërbimeve të dhënësit nga marrësi;
- » vendosje e linkeve që çojnë në ueb-faqet e dhënësit prej ueb-faqes së marrësit;
- » e drejta ekskluzive për shitje të të mirave dhe shërbimeve gjatë evenimenteve të organizuara nga marrësi etj.

Për ilustrim, nëse marrësi e shpall logon e dhënësit në këndin e poshtëm të broshurës së publikuar me mjetet e dhënësit, atëherë do të konsiderohet për donacion. Por, nëse logoja dhe emri i dhënësit haset nëpër të gjithë dokumentin në vend të dukshëm dhe të rëndësishëm, apo janë dominuese ngjyrat korporative atëherë kjo dë të trajtohet si sponsorim.

Trajtimi i promocionit të dhënësit të donacionit/sponsorimit nga ana e mediave si reklamë nuk është rast vetëm tek ne. Që të tejalohet ky problem do të nevojitet të bëhen ndryshime përkatëse edhe në Ligjin Për Veprimtarinë e Radiodifuzionit të cilat do t'i reflektojnë në mënyrë përkatëse dispozitat e Ligjit të Donacioneve dhe Sponsorimeve në Veprimtaritë Publike.

KOHEKT

Меѓусекторски форум Закон за донации и спонзорства во јавните дејности

Скопје, 05 декември 2011



Проектот е кофинансиран од Европската Унија во рамките на IPAC2011/2011-011

The Project is co-financed from the European Union within the IPAC2011/2011-011



III. VLERËSIMI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR VËRTETIM TË INTERESIT PUBLIK DHE REALIZIMI I NXITJEVE TATIMORE

III. VLERËSIMI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR VËRTETIM TË INTERESIT PUBLIK DHE REALIZIMI I NXITJEVE TATIMORE

3.1. GJENDJA EKZISTUESE

Në përpurthje me Ligjin e Donacioneve dhe Sponzorimeve, subjektet që duan t'i shfrytëzojnë nxitjet tatimore bëjnë marrëveshje për sponzorim apo dhënie donacioni. Marrëveshjen së bashku me dy ekzemplarë të kërkesës për vërtetim të interesit publik, për të cilin nuk ka formë ligjore të parashkruar, me taksë prej 250 denarësh pulla takse, dhënësi e dorëzon në Ministrinë e Drejtësisë. Si shtojcë dorëzohet edhe dëshmia për veprimtarinë e marrësit të donacionit/sponzorimit (më shpesh gjendja vijuese në Regjistrin Qendror), të cilën Ministria e Drejtësisë e përdor për të vërtetuar a është objekti i donacionit/sponzorimit në përpurthje me veprimtarinë e marrësit - ato duhet të korrespondojnë në përpurthje me nenin 10 të Ligjit.

Në përpurthje me kompetencën e vërtetuar ligjore për mbrojtjen e interesit publik të përcaktuar në neni 21 të Ligjit, Ministria e Drejtësisë kërkon mendim prej ministrisë konkrete në afat prej 5 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës prej dhënësit të donacionit/sponzorimit. Organet kompetente janë të obliguara të dorëzojnë mendimin e përmendur në Ministrinë e Drejtësisë në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimi të

kërkesë, kurse Ministria në afat prej 15 nga dita e marrjes së mendimit është e obliguar të japë vendim me të cilin vërtetohet ose jo interesi publik për donacioni apo sponsorimin e dhënë. Nëse ndonjë prej organeve kompetente nuk i respekton afatet e dhëna të procedurës për vërtetim të interesit publik, dorëzuesi i kërkesës (dhënësi i donacionit apo sponsorimit) mund t'i drejtohet Ministrit të drejtësisë, kurse pastaj në mënyrë suksesive edhe Inspektoratit Administrativ Shtetëror, drejtorit të Inspektoratit Administrativ shtetëror, prokurorit publik kompetent dhe gjykatës kompetente. Para ndryshimeve të fundit të Ligjit, në prill të vitit 2011, neni 21 parashikonte që nëse Ministria e drejtësisë nuk jepte vendim në afatin e parashikuar prej 15 ditësh, do të konsiderohej se kërkesa është zgjidhur pozitivisht.

Nëse subjekti dëshiron të shfrytëzojë nxitjet tatimore tek tatimi i vlerës së shtuar (TVSh) është e nevojshme në Ministrinë e Financave të dorëzojë kërkesë për sigurimin e mjeteve prej Buxhetit të Shtetit për pagim të TVSh-së në dy ekzemplarë (ekzemplar A-3), të plotësuar me faturën për qarkullimin e lëndës ku duhet të vendoset numri i vendimit për vërtetim të interesit publik të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, kopje të të njëjtit vendim si edhe kopje të marrëveshjes për donacion.⁴⁴ Në vetë formularin qëndron se nuk është e domosdoshme të dorëzohet vendim i Ministrisë së Drejtësisë, por vetëm kërkesa.

Megjithatë, nga Drejtoria e të Hyrave Publike (DHP) pohojnë se kërkohet dorëzim edhe i vendimit, sepse ndodh problem nëse Ministria e Drejtësisë më vonë merr vendim dhe jep përgjigje negative, kurse donatori tashmë e ka marrë lehtësimin. Në rastet kur nuk dorëzohet vërtetimi DHP-ja kërkon mendim nga Ministria e Drejtësisë ose e shtyn procedurën derisa donatori të sjellë vendimin.

Në vitin 2010, deri më 30.5.2010, në Ministrinë e Drejtësisë janë dorëzuar 425 kërkesa për vërtetim të interesit publik për donacionin/ sponsorimin e dhënë, kurse janë dhënë 350 vendime.⁴⁵

⁴⁴ Rregullore për zbatimin e nxitjeve tatimore tek tatimi i vlerës së shtuar (TVSh) për donacionet në veprimtaritë publike (Gazeta Zyrtare 90/2007 dhe 72/2008).

⁴⁵ Deklaratë me shkrim nga Ministria e Drejtësisë në debatin mbikëqyrës parlamentar me temë "Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponsorimeve në Veprimtaritë publike".

Sipas dëshmisë së ish-ministrit të drejtësisë, z. Mihajllo Manevski, në debatin mbikëqyrës parlamentar me temë “Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë publike”, vetëm për një pjesë të vogël e kërkesave të dorëzuara për vërtetim të veprimtarisë publike jepen zgjidhje negative. Në shumicën e rasteve bëhet fjalë për donacione në fushën e sportit, ku Agjencia e të Rinjve dhe Sportit nuk e ka vërtetuar interesin publik sepse klubi sportiv, d.m.th. shoqëria sportive e cila shfaqet si marrës nuk është regjistruar për kryerjen e veprimtarisë sport.

Në lidhje me dhënien e mendimeve për vërtetimit e interesit publik tek ministritë e veçanta, si indikacion i mirë mund të shërbejë informacioni se në vitin 2007, 2008 dhe 2009 Ministria e Kulturës ka dhënë gjithsej 366 mendime - aq sa i janë kërkuar. Nga këto mendime 349 kanë qenë pozitive, kurse 17 kanë qenë negative ose përsëri Ministria e Kulturës ka vërtetuar se nuk janë në kompetencat e veta.⁴⁶ Hulumtimi të cilin e ka kryer Konekt dëshmon se kohëzgjatja e dhënies së vendimeve lëviz nga një javë deri në mbi 70 ditë. Kjo në masë të madhe varet nga fakti se cila është Ministria e resursit. Disa prej ministrive nuk japin asnjë lloj mendimi, kurse disa të tjera shpallen edhe si jokompetente për kërkesën e dhënë.

Sipas hulumtimeve, shumë prej ndërmarrjeve vendosin të mos e shfrytëzojnë ligjin sepse procedura për realizimin e nxitjeve tatimore është komplekse dhe kërkon angazhim të madh të të punësuarve i cili nuk është në fokusin e tyre primar, pa qenë të sigurt se do ta realizojnë lehtësimin.⁴⁷ Të shpeshta janë deklaratat e marrësve të donacioneve të llojit “për atë shumë të nxitjeve tatimore ndërmarrjeve nuk u leverdis ta kalojnë procedurën e parashkruar”.⁴⁸ Deklarata të ngjashme hasen edhe në lidhje em donacionet të cilat vijnë nga personat fizikë.

46 Dëshmi e ministres së kulturës, zonja Elizabeta Kançeska-Milevska, në debatin mbikëqyrës parlamentar me temë “Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë publike”.

47 „Ligji i Donacioneve dhe Sponzorimeve në Veprimtaritë Publike - implementim dhe sfida kryesore», Nikica Kusinikova në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (QEDJ), maj/qershor 2010.

48 Hulumtim i kryer nga Shoqata Konekt, 2011.

3.2. SFIDA NË REALIZIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Procedura administrative sipas së cilës mund të realizohet lehtësimi tatimor është e komplikuar, e madhe dhe i mbingarkon përdoruesit e ligjit, sidomos dhënësit. Gjatë kësaj janë regjistruar sfida nga disa aspekte:

► *Mungesa e kriterëve subjektive për vërtetimin e interesit publik*

Kjo sfidë është e lidhur direkt me problemin e përkufizimit të interesit publik, i shpjeguar në mënyrë më të detajuar në kapitullin e mëparshëm. Pjesa më e madhe e organeve kompetente nuk kanë përcaktuar dhe shpallur kriterë objektive për vërtetim të interesit publik, që lë hapësirë për mos konsistencë dhe interpretim subjektiv të interesit publik nga personat përgjegjës, kurse lë hapësirë edhe për marrësit dhe dhënësit të shprehin dyshim në objektivitetin dhe transparencën e procedurës. Në praktikë janë evidentuar raste të dhënies së mendimeve të ndryshme për interesin publik për të njëjtin projekt në dy vite të ndryshme, pastaj shpallja e ministrive të caktuara si jokompetente që të japin mendim në fushën e cila është në ingjerenat e tyre, (dhe) dhënia e mendimit pozitiv për interes publik për projekte me karakter komercial. Sidomos është e vështirë të vihet kufiri midis interesit publik dhe aktiviteteve komerciale në fushën e kulturës dhe të sportit. Në Kapitullin II janë dhënë shembujt e Ministrisë së Arsimit dhe Agjencisë së të Rinjve dhe Sportit të cilat mendimin e bazojnë në raportin e marrësit dhe jo në veprimtarinë/aktivitetin për të cilin është dhënë donacioni sponsorimi.

Vetëm Ministria e Kulturës ka shpallur se dhënien e mendimeve e kryen sipas kriterëve të kodifikuara, të shpallura në rregullore⁴⁹ - edhe pse ky akt nënligjor është miratuar para miratimit të Ligjit të Donacioneve dhe Sponsorimeve në Veprimtaritë Publike. Gjatë përcaktimit të segmentit të interesit publik (interes nacional në kulturë) projektet dhe programet duhet të përmbushin të paktën një prej kriterëve të veçanta. Kriteret e përgjithshme janë marrë nga Ligji për Kulturën dhe përcaktojnë se çfarë përfshin interesi nacional në kulturë, kurse kriteret e veçanta e specifikojnë interesin publik në veprimtaritë dhe fushat e veçanta të kulturës. Megjithatë, madje edhe në këtë sferë, nuk mund të thuhet se

⁴⁹ Rregullore për kriteret e financimit të programeve përkatësisht projekteve sipas veprimtarive të ndryshme në kulturë (Gazeta Zyrtare 61/2004).

ekzistojnë kritere gjithëpërfshirëse (përkundrazi ndonjëherë janë edhe kufizuese) sepse nuk ekzistojnë kritere të kodifikuara për përcaktimin e formës tjetër të interesit publik në kulturë, d.m.th. të interesit lokal në kulturë.

► *Mungesa e ex-ante informacionit për interesin publik dhe kohëzgjatjen e procedurës*

Vërtetimi për interesin publik lidhur me një projekt apo aktivitet të caktuar që zbatohet me donacione apo sponsorime merret pas lidhjes së marrëveshjes për donacione, kurse shpesh edhe pas realizimit të aktivitetit respektiv. “Informacion se a është tatimi kthyes apo jo, merret një muaj pas realizimit të evenimentit [për të cilin jepet donacioni apo sponsorimi]”.⁵⁰ Zgjidhja e tillë ligjore krijon pasiguri tek dhënësi se a do t'i realizojnë nxitjet tatimore të parashikuara me Ligj. Kjo do të thotë se dhënësit duhet të jenë të përgatitur se mund të japin donacion apo sponsorim, kurse të mos marrin nxitje tatimore, që në një masë të madhe e kufizon realizimi e qëllimit kryesor të Ligjit - zmadhimi i donacioneve dhe sponsorimeve në veprimtaritë publike. Në praktikë, shpesh donacionet janë urgjente dhe kërkojnë realizim momental nga dhënësi. Për shkak të kohëzgjatjes së procedurës ndodh që donacioni ta humbasë relevancën apo të shkaktojë vonesë në zbatimin e projekteve të cilat janë të lidhura me një kornizë kohore.

Sipas hulumtimit që ka zbatuar Shoqata Konekt në vitin 2011 edhe marrësit edhe dhënësit e donacioneve sponsorimeve si një prej problemeve kryesore e theksojnë pritjen e gjatë të vendimit për vërtetim të interesit publik nga Ministria e Drejtësisë. Si koha më e gjatë e pritjes për këtë vendim nga ana e një marrësi janë dhënë gjashtë muaj, kurse nga ana e dhënësit të donacionit pothuajse tetë muaj pas dorëzimit të kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë. “E gjitha kjo i vështirëson shumë shlyerjet e obligimeve ndaj furnizuesve me mallra dhe shërbime për zbatimin e projekteve me interes publik”.⁵¹ Në përputhje me ndryshimet e fundit të Ligjit (G. Zyrtare 51/2011) në praktikë nuk ekziston më afat i

50 Dëshmi me shkrim e ShA Makedonski Telekom - Shkup e dhënë për nevojat e debatit mbikëqyrës parlamentar me temë “Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponsorimeve në Veprimtaritë Publike”.

51 Deklaratë e përfaqësuesit të shoqatës “Borka” për nevojat e debatit mbikëqyrës parlamentar me temë “Implementimi i Ligjit të Donacioneve dhe Sponsorimeve në Veprimtaritë Publike”.

përcaktuar gjatë të cilit duhet të përcaktohet interesi publik, por afati prej 15 ditësh për dhënien e vendimit tani është zëvendësuar me një procedurë jashtëzakonisht të gjatë dhe të komplikuar të pritjes dhe të drejtimit të instancat më të larta. Gjatë kësaj, problem shtesë është se kërkuksi në praktikë është e vështirë të merret informacion i saktë se a nuk e ka respektuar ndonjë organ i caktuar ndonjë prej afateve të dhëna, kurse me këtë dhe e drejta e tij që ta “eskalojë” rastin para instancës më të lartë është vendosur në pikëpyetje.

Shumica e dhënësve preferojnë ta marrin vendimin e Ministrisë së Drejtësisë para se ta realizojnë donacionin/sponzorimin për shkak të sigurisë së tyre juridike. Kjo është në përputhje me parimet vendase të pushtetit të të drejtës dhe me praktikën ndërkombëtare në lidhje me beneficionet tatimore për donacione. Qëndrimi i tillë është i arsyeshëm nëse merret parasysh se DHP-ja preferon dorëzim të vendimit, kurse vendimi është i obligueshëm edhe për përdorim të lirimit tatimor prej TVSh-së.

► *Procedura vë obligime të theksuara për dokumente dhe miratime paraprake për dhënësit*

Sipas nenit 21 *procedurën për vërtetimin e interesit publik e fillon dhe e kryen dhënësi i donacionit apo sponzorimit*. Gjatë dorëzimit të kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë, dhënësi duhet të dorëzojë Marrëveshje me shkrim për donacionin/sponzorimin e cila përmban informacion të detajuar për aktivitetin/projektin që dhënësi dëshiron ta mbështesë, informacion për veprimtarinë e marrësit etj. Kjo do të thotë se dhënësi paraprakisht duhet të ketë interaksion intensiv me marrësin dhe varet nga saktësia i marrësit që ta dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm gjë që e prolongon plus kohën e realizimit të donacionit/sponzorimit. Gjithashtu, disa donacione jepen për projekte të cilat nuk janë planifikuar në mënyrë të detajuar dhe nuk mund t'i përmbushin të gjitha elementet që i kërkon ligji (për shembull, donacion për mbështetje institucionale të ndonjë shoqate me karakter publik).

Barra e tillë mbi dhënësin e zvogëlon motivimin për përdorim të nxitjeve tatimore sepse merr kohë dhe i i heq të punësuarit nga detyrat e tyre primare të punës. Konstatimi i tillë është sidomos relevant për objektet më të vogla afariste të cilat kanë në dispozicion resurse të

kufizuara njerëzore. Nga ana tjetër, marrësi, dhe jo dhënësi, është subjekti i cili jo vetëm që ka interesin më të madh që ta vërtetojë interesin publik por edhe njëkohësisht posedon edhe më tepër të dhëna me të cilat mund ta vërtetojë interesin publik në lidhje me projektin apo aktivitetet të cilat janë objekt i donacionit/sponzorimit. Edhe dhënësit e intervistuar, por edhe marrësit e konsiderojnë si të palogjikshme vendimin me të cilin dhënësi fillon procedurën për vërtetimin e interesit publik.⁵²

Vendimi ligjor me të cilin dhënësi e udhëheq procedurën e interesit publik në mënyrë të panevojshme e zmadhon barrën administrative për dhënësit, por edhe për organet kompetente. Kjo është sidomos evidente në rastet kur ndonjë marrës i donacionit organizon aktivitete për mbledhjen e mjeteve për realizimin e një interesi të caktuar publik në bashkësi dhe paraqiten më tepër ndërmarrje dhe qytetarë të cilët dëshirojnë të japin donacion dhe gjatë kësaj të realizojnë edhe nxitje tatimore. Në përputhje me Ligjin, i gjithë procesi administrativ për vërtetimin e interesit publik duhet të kryhet për çdo donacion/sponzorim të veçantë madje edhe kur bëhet fjalë për një projekt të njëjtë.

- *Procedura kërkon një dokumentacion enorm pa marrë parasysh madhësinë dhe qëllimin e donacionit*

Procesi i tërësishëm dhe dokumentacioni për vërtetim të interesit publik dhe realizim të nxitjeve tatimore zbatohet për çdo donacion të veçantë pa marrë parasysh madhësinë e donacionit/sponzorimit, dhe as llojin e donatorit (qytetar apo subjekt juridik). Sipas nenit 19, dhënësi dhe marrësi duhet të përgatitin raport i cili dorëzohet në DHP jo më vonë se 30 ditë nga dita e plotësimit të marrëveshjes. Edhe pse formatet për lajmërim të cilat i ka parashkruar DPG-ja janë të thjeshta, kjo përbën një ngarkesë administrative shtesë, sidomos për dhënësit. Kjo nënkupton komunikim të vazhdueshëm midis dhënësit me marrësin gjatë realizimit të marrëveshjes që në praktikë nuk është rast. Përveç kësaj, krijon bezdi tek dhënësi sepse ata pasi ta kenë realizuar donacionin/sponzorimin kalojnë në pronësi të marrësit dhe ata nuk kanë asnjë obligim përkundrejt atij dhe as nuk kanë kontroll mbi atë se si përdoret ai.

- *Kompetencë tek shumë institucione dhe mbingarkesë e madhe administrative për organet kompetente*

⁵² Hulumtimi i kryer nga Shoqata Konekt, 2011.

Në këtë moment, në zbatimin e ligjit janë përfshirë: 1) Ministria e Drejtësisë, 2) Drejtoria e të Hyrave Publike ku një shërbim i veçantë është përgjegjës për evidentimin e raporteve të mbërritura nga dhënësit dhe marrësit, përveç shërbimeve për revizion të llogarive vjetore dhe shërbimet inspektuese dhe 3) ministrinë dhe agjencitë e tjera kompetente në të cilat disa nëpunës janë përgjegjës për dhënien e mendimit për interesin publik në përputhje me sektorin që ata mbulojnë. Përfshirja e tillë e një numri të madh organesh përveç asaj që jep pasiguri juridike për përdoruesit e ligjit por edhe jep barrë dhe shpenzime të mëdha të administratës për procesimin e çdo donacioni/sponsorimi të veçantë, dhe siç është theksuar edhe më sipër çon edhe në interpretimin subjektiv të dispozitave të caktuara.

3.3. REKOMANDIME NË LIDHJE ME PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

Nga ajo që është thënë më sipër mund të nxirret përfundimi se nevojiten ndryshime themelore në procedurën administrative për vërtetimin e interesit publik dhe realizimin e nxitjeve tatimore. Gjatë kësaj duhen pasur parasysh parimet e mëposhtme:

Të sigurohet *ex ante* informacion për interesin publik para bërjes së marrëveshjes për donacion/sponsorim (d.m.th. para se dhënësi të marrë vendimin për realizimin e donacionit/sponsorimit të dhënë);

- » Interesi publik të jetë i vërtetuar në mënyrë eksplicite nga organet shtetërore (Drejtoria e të Hyrave Publike) që të mund të realizojë lirim tatimor përkatës;
- » Shkurtim i kohëzgjatjes së procedurës duke pasur parasysh dinamikën e dhënies së donacioneve/sponsorimeve në praktikë;
- » Zvogëlimi i madhësisë së dokumentacionit dhe barrës administrative për dhënësit;
- » Zvogëlim i barrës administrative për institucionet shtetërore.

Praktikat pozitive evropiane dëshmojnë se procedurat administrative për marrjen e lehtësimeve tatimore janë jashtëzakonisht të thjeshta

dhe në pjesën më të madhe janë vetëm evidenca e kontabilitetit për donacionet dhe sponsorimet e dhëna. Domethënë, në të gjitha vendet e përfshira me analizën krahasuese trajtimi i interesit publik është i lidhur direkt me marrësit të cilët janë të përkufizuar saktësisht. Mandej, të gjitha donacionet për këta marrës kanë trajtim të interesit publik dhe mund të gëzojnë lehtësimet tatimore. Nuk parashikohet proces shtesë për vërtetimin e interesit publik për çdo donacion apo aktivitet/projekt të mëvetësishëm për të cilin jepet donacion, Për mbrojtjen e interesit publik parashikohet lajmërim përkatës siç është rekomanduar në Kapitullin V.

Në këtë drejtim rekomandohet që procedura administrative në suazat e Ligjit të Donacioneve dhe Sponsorimeve në Veprimtaritë Publike të rishqyrtohet nga tri aspekte: 1) procedura për vërtetim të interesit publik; 2) madhësia e dokumentacionit të obligueshëm dhe 3) numri i institucioneve të përfshira në procedurë.

Gjatë kësaj, duke ndjekur përvojat krahasuese si edhe nevojat e shtetit tonë janë të mundshme disa zgjidhje:

Opsion	Procedura e vërtetimit të interesit publik	Anë pozitive	Anë negative
Opsioni 1 Marrësit të kufizohen vetëm tek ato subjekte tek të cilat ekziston vërtetim ligjor i interesit publik (OIP, institucionet publike, njësitë e pushtetit lokal etj.).	» Interesi publik do të lidhet me statusin e marrësit dhe jo me aktivitetin për të cilin bëhet donacioni/ sponsorimi. Në atë rast të gjitha donacionet për këto subjekte do të kenë status të interesit publik.	» Thjeshtëzim i theksuar i procedurës. » Madhësia më e vogël e mbingarkimit të administratës.	» Në përputhje me analizën e gjendjes ekzistuese, në këtë rast ligji do të përjashtonte një numër të madh shoqatash, fondacionesh, shoqata fetare, dhe klube sportive të cilët kryejnë veprimtari me interes publik. » Do të nevojitet intervenim në LSHF që të ndryshohet kriteri për buxhet vjetor minimal prej 1500 eurosh. Në të kundërt, Ligji nuk do të ketë ndikim mbi krijimin afatgjatë të kulturës së donacioneve sidomos në nivel lokal.

Opsion	Procedura e vërtetimit të interesit publik	Anë pozitive	Anë negative
Opsioni 2 Marrësit t'i përfshijnë të gjitha subjektet me karakter jofitimprurës.	Procedurë e dyfishtë: 1) për ata që kanë status të përcaktuar të interesit publik e cila do të ishte e njëjtë si Opsioni 1 dhe 2) për ato që nuk kanë status të tillë, marrësi do të kërkonte mendim për interesin publik të projektit/aktivitetit. Vendimin do ta jepte Ministria e Drejtësisë (në bazë të kriterëve të përgatitura nga ministrinë e resorit.	» Thjeshtëzim i procedurës në raport me zgjidhjen ligjore ekzistuese sepse do të zvogëlohet madhësia e kërkesave dhe madhësia e përfshirjes së administratës.. » Mundësohet spektër më i gjerë marrësish që është i rëndësishëm për nxitjen e filantropisë dhe demokracisë në nivel lokal.	» Do të shfaqet nevoja e dorëzimit të dokumentacionit më të madh të projektit nga marrësi.
Opsioni 3 Marrësit t'i përfshijnë të gjitha subjektet me karakter jofitimprurës.	Procedura është e ngjashme si tek opsioni 2 me dallim se përveç Ministrisë së Drejtësisë në marrjen e vendimit do të përfshihen edhe institucionet e tjera. Janë të mundshme dy opsione: » Si deri më tani përfshirje e të gjitha ministrive resore. » Formim i grupit ndërsektorial ku do të ketë përfaqësues të shoqatave dhe fondacioneve	» Lehtësim i procedurës nga aspekti i numrit të kërkesave. » Mundësohet spektër më i gjerë marrësish që është i rëndësishëm për nxitjen e filantropisë dhe demokracisë në nivel lokal .	» Mbingarkesë e zmadhuar e administratës. » Trajtim i ndryshëm i kërkesave në varësi prej asaj se nën kë institucion resor futet aktiviteti i tyre dhe ekzistimi i pasigurisë juridike. » Nevojitet dokumentacion më i madh nga marrësi.

Më poshtë është dhënë përshkrim i detajuar i procedurës administrative gjatë rishqyrtimit të vendimit ligjor.

Procedura për vërtetimin e interesit publik mund të thjeshtëzohet theksueshëm nëse në pjesën më të madhe interesi publik lidhet me

marrësin e donacionit/sponzorimit. Në atë rast do të anashkalohej nevoja për dhënien e vendimit të veçantë për çdo donacion/sponzorim, do të ruhet parimi *ex ante* informacion (sepse dhënësit paraprakisht do të dinë statusin e marrësit), kurse kështu do të anashkalohej pasiguria juridike e dhënësve dhe tek DHP-ja. Gjatë kësaj duhet të kihet parasysh normativa ligjore për organizatat me interes publik. Domethënë, sipas Ligjit të Shoqatave dhe Fondacioneve një prej kritereve për marrjen e këtij statusi është që organizata të ketë vlerë të përgjithshme të pronës mbi 1500 euro. Por sipas vlerësimeve të vitit 2010 vetëm 20% e organizatave e plotësojnë këtë kriter. Duke pasur parasysh se është e mundur që një pjesë e madhe e shoqatave dhe fondacioneve të cilat realizojnë projekte me interes publik të mos e marrin statusin e OIP-së, është e nevojshme të mendohet a të parashikohet procedurë përkatëse e cila do të mundësojë lehtësime edhe për donacione dhe sponzorime për këta marrës.

Prandaj, vendimi ligjor mund të parashikojë dy lloje procedurash për përcaktim të interesit publik të dhëna më sipër në Opsionin 2:

1. *Procedura e parë* do të vlente për organizatat tek të cilat interesi publik është vërtetuar përgjithmonë me çka do të anashkalohej nevoja e dhënies së vendimeve të veçanta për çdo donacion apo sponzorim të dhënë për ta. Kështu, për shembull, Kryqi i Kuq në MK dhe shoqatat dhe fondacionet me status të interesit publik është e qartë se aktivitetet në shumicën e rasteve do të drejtohen në realizimin e interesit publik dhe se nuk do të kalojnë në fitim privat. mandej, edhe tek entitetet e tjera të cilat kryejnë veprimtari me interes publik, ndërsa janë në pronësi shtetërore apo publike (institucione publike, organe të administratës shtetërore, njësi të pushtetit lokal, ndërmarrje publike, fonde për sigurime sociale) është krejtësisht e qartë se donacionet dhe sponzorimet do të përdoren në interes publik dhe nuk do të përdoren për realizim të fitimit personal.

Prej këndej, më praktike është të zbatohet principi, i cili ekziston në shumicën e vendeve evropiane, se **të gjitha donacionet dhe sponzorimet për marrësit e tillë i dedikohen realizimit të interesit publik dhe mund t'i përdorin lirimet tatimore.** Në këtë rast, marrësi do ta posedojë paraprakisht dokumentin me të cilin vërtetohet interesi publik dhe nuk do të nevojitet procedurë plotësuese.

2. *Procedura e dytë* për vërtetimin e interesit publik do të vlente për organizatat të cilat kryejnë projekte dhe aktivitete me interes publik, por nuk kanë marrë statusin e veçantë (shoqata, fondacione, aleanca dhe forma organizative të organizatave të huaja të cilat nuk janë OIP; institucione private, kisha, bashkësi fetare dhe grupe fetare) të cilat i ndihmojnë personat të cilët kanë nevojë për lloje të ndryshme të mbrojtjes sociale. Tek ky lloj marrësish do të mbetet nevoja interesi publik të përcaktohet ad hok për aktivitetin apo projektin konkret që kryejnë nëpërmjet sigurimit të vendimit nga organi kompetent.

Në këtë rast rekomandohet procedurën për vërtetimin e interesit publik ta zbatojë marrësi para realizimit të donacionit/sponsorimit. Në këtë mënyrë organizatat të cilat kryejnë aktivitete me interes publik do të tërheqin më lehtë donatorë apo sponsorë, sepse do të mund të dëshmojnë paraprakisht se nxitjet tatimore do të realizohen. Kjo është procedura e preferuar nga dhënësit sepse në këtë mënyrë përsëri do të ruhet principi i zvogëlimit të pasigurisë juridike dhe marrja e informacionit *ex ante* për interesin publik nga dhënësi. Kjo do ta zvogëlojë theksueshëm edhe barrën administrative sepse marrësi do ta zbatojë procedurën për vetë aktivitetin (projektin) pa marrë parasysh se a do të mbështetet ai nga një apo më shumë donacione apo sponsorime.

Në këtë rast interesi publik do të caktohet në bazë të: a) kriterëve të përgjithshme të dhëna në përkufizimin e interesit publik në Ligj (siç është propozuar në Kapitullin II dhe b) nëse është e nevojshme në bazë të kriterëve të shkruara në fushat e veçanta (p.sh. kulturë, sport etj.) të përgatitura nga organet kompetente dhe në bazë të normativës ligjore në atë fushë⁵³. Organet kompetente do të mund të përfshinin në përgatitjen e kriterëve edhe organizata qytetare që të sigurohet vendosja përkatëse e kriterëve në atë fushë.

Kur në këtë mënyrë paraprakisht do të vendosen kriteret, Ministria e Drejtësisë (apo ndonjë organ tjetër në përputhje me opsionet e propozuara) si organ kompetent do të mund të marrë vendim direkt për vërtetim të interesit publik me çka do të shkurtohet theksueshëm kohëzgjatja e

⁵³ Rregullore për kriteret e financimit të programeve përkatësisht projekteve në veprimtari të veçanta nga kultura (Gazeta Zyrtare 61/2004).

procedurës. Vendimi do të jetë detyrues me parashikim të një afati të arsyetueshëm (p.sh. 30 ditë).

Njëkohësisht, në këtë mënyrë do të zvogëlohet **barrapër administratën** sepse ministritë dhe institucionet resore do të përfshihen vetëm në fillim të vendosjes së kriterëve nga fusha e vet, kurse jo edhe në dhënien e vendimit për çdo rast më vete. Sepse vendimi do të jetë i obligueshëm, procedura e tillë korrespondon edhe me nevojat e Drejtorisë së të Hyrave Publike.

Në lidhje me dokumentacionin e obligueshëm që kërkohet prej dhënësve dhe marrësve për realizim të nxitjes tatimore rekomandohet:

- » Për donacione të vogla në shumë prej 200 eurosh të përjashtohet lidhja e obligueshme e marrëveshjeve në rastin kur dhënësi është person fizik. Në rastet e tilla është e mjaftueshme që dhënësi t'i jepet Vërtetim për zbatim të donacionit. Sepse në shumicën e rasteve personat fizikë janë dhënës të donacioneve të vogla⁵⁴ kjo do ta lehtësojë mjaft procedurën për ta me çka do t'u mundësohet të shfrytëzojnë lehtësimet tatimore;
- » Nëse vendoset vendimi ad hok i interesit publik për një aktivitet të caktuar përkatësisht projekt, ndërsa jo për çdo donacion të veçantë marrësi do ta realizojë procedurën para se të bëhen marrëveshjet për donacion/sponzorim. Prandaj marrëveshjet nuk nevojitet të dorëzohen në procesin e përcaktimit të interesit publik, por marrëveshja/marrëveshjet për donacion/sponzorim do të ishin dokument shoqërues i cili do të përdorej në realizimin e lirimeve nga TVSh-ja dhe gjatë dorëzimit të raporteve përfundimtare në DHP;
- » Në drejtim të thjeshtëzimit të mëtejshëm të procedurës mund të mundësohet dorëzim i dokumenteve në institucionet kompetente në formë elektronike, nëse janë valide, me firmë elektronike;
- » Thjeshtëzim i lajmërimit (Shik Kapitullin V).

54 Në Hulumtimin e Konekt të vitit 2009 vetëm 0,7% e të anketuarve kanë deklaruar se japin donacion më tepër se 10.000 denarë në vit.

IV. MADHËSIA E NXITJEVE TATIMORE EKZISTUESE DHE SFIDA NË ZBATIMIN E TYRE

IV. MADHËSIA E NXITJEVE TATIMORE EKZISTUESE DHE SFIDA NË ZBATIMIN E TYRE

Në praktikën evropiane aplikohen zgjidhje të ndryshme për nxitjet tatimore. Gjatë kësaj, u tregua se “zgjidhjet më efektive janë ato të cilat caktohen në bazë të analizës së situatës lokale, nevojave lokale dhe prioriteteve të vendit, si dhe vlerësim që qëndron për situatën ekonomike dhe kulturën e dhurimit, që të caktohet niveli adekuat i beneficioneve të cilat do të ishin nxitëse për donatorin që të dhurojë, por gjithashtu do të zgjojnë edhe resurs për OQ”⁵⁵.

Gjatë përgatitjes së ndryshimeve të Ligjit është e rëndësishme që të merren parasysh edhe përvojat e deritanishme nga zbatimi i ligjit, sistemi ynë tatimor, si dhe mendimet e palëve të prekura për atë se cilat nivele të nxitjeve tatimore me të vërtetë do të vepronin në mënyrë stimuluese për donatorët. Gjatë kësaj duhet të mbahet llogari që ata të mos nxisin intervenime më të mëdha dhe disbalanc në Buxhetin shtetëror.

⁵⁵ Pjesë nga hulumtimi “Trajtimi tatimor i organizatave jofitimprurëse dhe beneficinet tatimore për donatorët”. I përgatitur nga Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (ECNL) (www.ecnl.org) për Qendrën Bullgare për të Drejtë Jofitimprurëse” (www.bcnl.org) në kuadër të projektit “Vështrim optimist i organizatave joqeveritare dhe resurseve të vendit” i financuar nga Trust for Civil Society in Central and Eastern Europe përmes Bulgarian Charities Aid Foundation, si dhe hulumtime tjera të realizuara nga ECNL.

Nga praktika evropiane, shkalla e nxitjeve tatimore varen edhe nga ajo se sa është e gjerë përfshirja e dhënësve dhe marrësve. Gjithashtu ato varen edhe nga ajo nëse përqindja e zvogëlimit tatimor për dhënësit është e lidhur me: (1) të ardhurat para tatimit (bruto të ardhura), (2) të ardhurat pas tatimit ose (3) shuma e donacionit. Në mënyrë plotësuese, disa vende parashohin obligim për donacion minimal, i cili duhet të jepet që të mund të jetë lëndë e lirimit nga tatimi, ose e caktojë kufirin e sipërm të donacionit që të kualifikohet si deduktiv⁵⁶.

Beneficionet tatimore realizohen në parim të: *deduktiv tatimor* (nga të ardhurat që i nënshtrohen tatimit gjegjësisht e zvogëlon bazën tatimore) ose *kredi tatimore* (zvogëlohet vetë borxhi taimor).

4.1. GJENDJA AKTUALE

Siç u përmend edhe në hyrje, dy të tretat e qytetarëve tanë mendojnë se beneficionet tatimore janë stimul i rëndësishëm për dhurim, që është qëndrim mjaft i shprehur te qytetarët me të ardhura më larta. Gjithashtu ndërmarrjet u japin rëndësi beneficioneve tatimore – 71% mendojnë se ato janë shumë të rëndësishme dhe 18% të tjerë mendojnë se janë të rëndësishme.⁵⁷ Qëndrimet e këtilla në mënyrë plotësuese mund të mbështeten edhe me të dhënat nga DHP, që flasin se nga vendosja e nxitjeve tatimore në këtë sferë në fillim të vitit 2007, donacionet dhe sponsorimet në veprimtaritë publike shënojnë rritje të vazhdueshme.

*Numri i organizatave donatorë dhe vëllimi i donacioneve*⁵⁸

⁵⁶ Ibid

⁵⁷ “Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike – implementimi dhe sfidat kryesore”, Nikica Kusenikova në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (ECNL), maj/qershor 2010.

⁵⁸ Dëshmi e drejtorit të Drejtorisë të Hyrave Publike, z. Goran Trajkovski, në diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

	Persona juridik-donorë	Ndryshimi në krahasim me 2007 (%)	Shuma e dhuruar (denarë)	Ndryshimi në krahasim me 2007 (%)
2007	115	0	20 000 651	0
2009	209	+ 82	144 823 958	+ 624
2010, katër mujori i parë ⁵⁹	94	+ 227	59 000 329	+ 1080

Gjatë kësaj sponsorimet janë më të shpeshta nga donacionet – më shumë se 53% nga të gjitha kërkesat e parashtruara për vërtetimin e interesimit publik janë lidhur me sponsorimet në krahasim me 46% lidhur me donacionet.⁶⁰ Gjendja e këtillë mund të vërtetohet edhe në sferën e kulturës – si një nga marrësit më të mëdhenj të donacioneve dhe sponsorimeve. Kështu, nga data 01.10.2009 deri më 30.04.2010 me ndihmën e nxitjeve tatimore nga ky Ligj filloi realizimi i 46 projekteve nga fusha e kulturës në shumë prej 25.867.710 denarë, prej të cilave 84% janë donacione, ndërsa 16% janë sponsorime.

“Edhe pse Ligji lejon që edhe personat fizik dhe juridik të jenë donatorë, numri i personave fizik që e kanë shfrytëzuar ligjin është i vogël. Sektori afarist është donatori më i madh nga vendi dhe atë më shpesh janë ndërmarrjet publike, shoqatat tregtare dhe bankat. Lidhur me atë se kush është marrësi më i shpeshtë i donacioneve/sponsorimeve me përjashtim të fushës së sportit ku më së shumti si marrës paraqiten shoqatat nga fusha e sportit, në fushat tjera të dhurimit gjegjësisht sponsorizimit, në përqindje numri i marrësve janë institucionet publike nga fusha e arsimit, shëndetësisë, kulturës”.⁶¹

Ligji, në kapitullin III, parasheh nxitje të të gjitha donacionet, përveç të akcizat. Neni 13 i përcakton *nxitjet tatimore të tatimi personal i të ardhurave (TPA)*. Ajo që është specifike të TPA është se ky është rasti

59 Të dhëna për ndryshimet në përqindje kanë të bëjnë lidhur me një të katërtën nga numri i donatorëve, dhe shuma e donacioneve në vitin 2007.

60 Dokument me shkrim i parashtruar nga Ministria e Drejtësisë për diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

61 Dokument me shkrim i parashtruar nga Ministria e Drejtësisë për diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

i vetëm kur nxitjet tatimore për donatorët jepen në formë të *kredisë tatimore*, që i mundëson donatorit të marrë pjesë nga shuma e dhuruar nga tatimi që duhet ta paguajë. Zvogëlimi i këtillë i borxhit tatimor është kufizuar vetëm te personat të cilët parashtrojnë fletëparaqitje tatimore vjetore, d.m.th. vetëm te ata që kanë të ardhura edhe në bazë ndryshe nga rroga. Shuma e zvogëlimit të borxhit tatimor është kufizuar në më së paku 20% nga borxhi tatimor vjetor – por jo më shumë se 24.000 denarë.

Neni 14 i përcakton nxitjet tatimore te *tatimi i fitimit* përmes deduktimit tatimor d.m.th. në formë të zvogëlimit të bazës tatimore në shumë prej 5% nga të ardhurat e përgjithshme te donacionet dhe 3% te sponsorimet.

Neni 15 i përcakton nxitjet tatimore te *tatimi i vlerës së shtuar (TVSH)*. Këtu janë paraparë tre forma të nxitjeve: 1) lirimi nga TVSH gjatë dhurimit të mirave, shërbimeve dhe punëve për realizimin e aktiviteteve të marrësit të donacionit ose për furnizimin e të njëjtave me pagesë në kohë të TVSH nga ana e organizatës-dhënës i të mirave/shërbimeve/punëve dhe mbulimi i tyre me mjete nga buxheti shtetëror; 2) lirimi nga TVSH për buleta për hyrje për ngjarje sportive, kulturore dhe të tjera publike nëse të gjitha të ardhurat shfrytëzohen për interes publik, gjatë së cilës nuk humbet e drejta e deduktimit të tatimit të hyrë; 3) lirimi nga TVSH për kompensimin për shërbim komunikimi gjatë dhurimit – SMS ose tele-donacione – gjatë së cilës nuk humbet e drejta e deduktimit të tatimit të hyrë. Gjatë kësaj duhet të potencohet se dispozitat e ligjit në këtë nen parashohin nxitje tatimore të TVSH-së vetëm te donacionet (përveç në rast të kompensimit të buletave për hyrje për të cilin nuk është cekur në mënyrë eksplicite). Për lirimin e TVSH-së është miratuar Rregullore për zbatimin e nxitjeve tatimore te tatimi i vlerës së shtuar për donacionet në veprimtaritë publike⁶².

Në vitin 2008 është realizuar kthimi i TVSH-së në bazë të këtij ligji prej 32 milionë denarë, në vitin 2009 7.5 milionë denarë, ndërsa në katër muajt e parë nga viti 2010 – 5 milionë denarë. Megjithatë, kjo është dukshëm më pak nga kthimi i TVSH-së i realizuar te donacionet e huaja.⁶³ Nxitjet

⁶² I miratuar nga ministri i Financave më 6 qershor 2007 (Gazeta zyrtare nr. 90/07) dhe i ndryshuar më 10 qershor 2008.

⁶³ Dëshmi e udhëheqësit të Sektorit për donacione në Ministrinë e Financave, z. Borçe Smilevski, në diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime më veprimtaritë publike”.

lidhur me tatimin në pronë, d.m.th. tatimi në trashëgimi dhe dhuratë shumë pak shfrytëzohet.⁶⁴

Neni 16 parasheh lirim nga *tatimi në trashëgimi dhe dhuratë* (lirimi nga i njëjti) dhe lirim nga *tatimi në pronë* në 5 vitet e para pas vitit në të cilin është dhënë donacioni. Në praktikë nuk janë vërejtur shembuj të shfrytëzimit të këtij lirimi tatimor, e kështu analiza nuk jep vështrim rreth aplikimit të tij në praktikë.

Neni 17 ka të bëjë me dhurimin nga ana ne personave fizik dhe juridik të huaj dhe parasheh mundësi, me kërkesë të dhënësit, DHP të lëshojë dokument për vërtetimin e donacionit ose sponsorizimit që dhënësi më tej do të mund ta shfrytëzojë për fitimin e nxitjes tatimore për tatimin e fitimit në vendin amë.

4.2. SFIDAT DHE NDIKIMET E NXITJEVE TATIMORE TË PARASHIKUARA

Nxitjet e ndryshme tatimore të parapara në Ligj aplikohen në vëllim të ndryshëm nga ana e shfrytëzuesve. Nga praktika e deritanishme janë vërejtur sfidat në aplikimin e tyre si nga natyra administrative, ashtu edhe në drejtim të asaj sa lehtësime ekzistuese me të vërtetë nxisin nivele të rritura të dhurimit/sponsorizimit.

► *Interesim i pamjaftueshëm për dobi nga nxitjet tatimore*

Një nga përfundimet e diskutimit mbikëqyrës është se “Ligji nuk i jep rezultatet e pritura në drejtim të nxitjes së rritur të personave fizik dhe juridik të dhurojnë/sponsorizojnë.”⁶⁵ Intervistat e realizuara në vitin 2011 nga Shoqata Konekt treguan se edhe te donatorët edhe te marrësit dominon qëndrimi se shpesh nxitjet tatimore janë shumë të vogla, ndërsa procedura është shumë e ndërlikuar dhe e pavarur, që të mund të kenë

64 Dëshmi e drejtorit të Drejtorisë të Hyrave Publike, z. Goran Trajkovski, në diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

65 Përfundimet nga diskutimi mbikëqyrës në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”, të miratuar në mbledhjen e mbajtur më 21.07.2010.

ndikim të fuqishëm mbi vëllimin e donacioneve dhe sponsorimeve në veprimtaritë publike. Pikëpamje të këtillë e ndajnë edhe kompetentët, sipas të cilëve “një pjesë nga kompanitë e mëdha nuk janë të interesuara që ta realizojnë të drejtën e nxitjes tatimore, që flet se zgjidhja ekzistuese ligjore nuk është nxitëse sa duhet”.⁶⁶ Gjithashtu, janë të shpeshta qëndrimet të dhënësit se kompani të caktuara me të cilat bashkëpunojnë në realizimin e të gjitha aktiviteteve nuk janë të njoftuara me mundësitë të cilat dalin nga Ligji.

► *Orientim jo i barabartë i shprehur i donacioneve dhe sponsorimeve*

Dhuruesit e donacioneve dhe sponsorimeve të cilët i shfrytëzojnë nxitjet tatimore shprehin interesim të vogël për shumicën e veprimtarive me interesim publik. Nga zbatimi i deritanishëm i Ligjit, veprimtari me interesim publik të cilat më shpesh janë lëndë e dhurimit gjegjësisht sponsorizimit janë sporti, kultura, shëndetësia, arsimi, veprimtaritë socio-humanitare dhe mbrojtja e fëmijëve, mësimi fetar dhe shoqëria informatike.⁶⁷ Megjithatë, bile edhe në sferën e kulturës, për veprimtarinë muzikore-skenike jepen 75% nga sponsorimet dhe 76% nga donacionet, për manifestimet kulturore-artistike 23%, ndërsa vetëm 1% për të gjitha veprimtaritë nga fusha e kulturës. Gjatë kësaj më pak dhurime ka në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.⁶⁸

Sipas ministrit të Arsimit dhe Shkencës,⁶⁹ në këtë sferë donacionet dhe sponsorimet më shpesh janë të dedikuara për botimin e teksteve shkollore, bursat për nxënës dhe studentë, dhe rikonstruimi i objekteve. Gjatë kësaj, donacionet për veprimtaritë shkencore-hulumtuese janë shumë të vogla dhe minore lidhur me nevojat.

66 Dëshmi e ministres së Kulturës, znj. Elizabeta Kançeska-Milevska, në diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

67 Dokument me shkrim i parashtruar nga Ministria e Drejtësisë për diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

68 Dëshmi e ministres së Kulturës, znj. Elizabeta Kançeska-Milevska, në diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

69 Dëshmi e ministrit Nikolla Todorov në diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

► *Moszbatimi i nxitjes tatimore nga tatimi personal i të ardhurave për personat fizik dhënës të donacioneve dhe sponsorimeve*

Formulari i fletëparaqitjes tatimore vjetore për TPA (TPA-FTV) nuk e respekton Ligjin, pasi që nxitja tatimore për personat fizik-dhënës të donacionit e transformon nga kredia tatimore në zvogëlim tatimor, që nuk është në pajtim me nenin 13 nga Ligji. Në të vërtetë, në reshtin 19 nga formulari i përmendur shuma e donacioneve të dhëna për veprimtaritë fizike janë të detyruar ta shkruajnë në kolonën e deduktimeve nga të ardhurat e përgjithshme (kolona 3).

Në mënyrë plotësuese, pasi që paguesit nga vendit të ardhurave janë të obliguar për pagesë paradhënie të TPA, ndërsa nxitja tatimore jepet ex poste pas dhurimit të donacionit dhe pas pagesës paradhënie të TPA, në praktikë personat fizik-donatorët të cilët realizojnë të ardhura plotësuese vetëm mund të fitojnë zvogëlim të tatimit për vitin e ardhshëm. Këtë mund ta shfrytëzojnë në kontabilitet vetëm nëse në atë vit të ardhshëm përsëri realizojnë edhe të ardhura plotësuese, e jo vetëm të ardhura në bazë të rrogës. Në praktikë, ky zvogëlim tatimor mund të jetë real, e jo vetëm në kontabilitet, vetëm nëse individit realizon të ardhura nga jashtë që nuk i nënshtrohet pagesës paradhënie, ose nëse realizon të ardhura nga burime të vendit, ku do të arrijë t'i shmanget pagesës paradhënie.

Sfidë në realizimin e kësaj nxitje tatimore del edhe nga terminologjia e shfrytëzuar në Nenin 13 nga Ligji. Në të vërtetë, kufizimi i lirimit përcaktohet si 20% nga borxhi vjetor tatimor. Pasi që BTA paguhet në mënyrë paradhënie, organet kompetente e llogarisin borxhin tatimor vjetor si dallim mes shumës së tatimit personal vjetor të ardhurave dhe shumën e paradhënie të paguara. Duke marrë parasysh atë se pasi filloi aplikimi i Ligjit në Maqedoni u vendos tatimi i barabartë, për momentin një numër i parëndësishëm i personave fizik mund ta shfrytëzojnë lirimin nga tatimi, ndërsa edhe shumat që do të mund të liroheshin janë shumë të ulëta.

Pasi që mekanizmi i realizimit të nxitjes tatimore për dhënësit e donacioneve të TPA është përmes fletëparaqitjeve tatimore vjetore, të njëjtën mund ta realizojnë vetëm ata të cilët parashtrojnë fletëparaqitje të këtillë, d.m.th. vetëm ata që kanë edhe formë tjetër të ardhurave

përveç rrogës. Shumë marrës të mëdhenj të donacioneve e kritikojnë këtë zgjidhje.⁷⁰ Në të vërtetë, personat të cilët kanë realizuar të ardhura vetëm në bazë të rrogës mund të parashtrojnë fletëparaqitje tatimore nëse dhurojnë dhe dëshirojnë ta shfrytëzojnë lirimin nga tatimi. Problem paraqet se mënyra e tanishme e llogaritjes së këtij lirimi nga tatimi dhe mënyra me të cilën realizohet e njëjta (ex poste pas parashtrimit të fletëparaqitjes tatimore), nuk ofron mundësi praktike për aplikimin e kësaj zgjidhjeje.

Sipas kësaj, në praktikë pothuaj nuk janë evidentuar raste të lirimit nga tatimi tatimor te tatimi personal i të ardhurave për personat fizik të cilët dhurojnë ose sponsorizojnë.

► *Kufizimet e nxitjes tatimore te TPA në 25.000 denarë në vjet*

Kufiri prej 24.000 denarë është i ulët nëse ligji dëshiron që ti nxisë dhurimet nga personat me të ardhura më të larta. Për momentin sipas të dhënave nga DHP, në Maqedoni ka persona që realizojnë të ardhura vjetore edhe mbi 1.5 milionë euro.

► *Shkalla deri te cila zgjidhjet ekzistuese te tatimi në fitim e stimulon filantropinë*

Për momentin zgjidhjet ligjore te tatimi në fitim realizohet përmes deduktimit tatimor d.m.th. njohja e donacionit ose sponsorizimit për shpenzime dhe zvogëlim adekuat i bazës tatimore. Zgjidhjet e këtilla bëjnë dallim të dukshëm në vendet me sistem progresiv tatimor, pasi që në atë rast me rritjen e nivelit të donacioneve dhe sponsorimeve dhënësi në mënyrë të dukshme mund ta zvogëlojë bazën tatimore dhe të bie në grupin me shkallë më të ulët tatimore, që ndikon në tatimin e tij të përgjithshëm⁷¹.

Ajo që për çdo vit shënohet interesim i madh për shfrytëzimin e këtij lehtësimi tatimor flet se i njëjti është relevant për dhënësit. Megjithatë, duke marrë parasysh atë se me rregulloren e tanishme subjektet afariste gëzojnë lehtësime tatimore nga tatimi i fitimit edhe në baza tjera (për shembull për ri-investim të fitimit), është e diskutueshme sa zgjidhja

70 Hulumtimi i zbatuar nga Shoqata Konekt, 2011.

71 Shih „The Legal Environment of Private Philanthropy, International Comparative Survey” nga Nilda Bullain (mund të gjendet më dokumentacionin e ECNL)

e këtillë tatimore do të kontribuojë për rritjen e nivelit të dhurimit dhe rritjen e numrit të dhënësve, gjegjësisht të rritjes së shkallës së filantropisë. Ajo që në mënyrë logjike mund të përfundohet është se kjo zgjidhje është e dobishme për ata dhënës të cilët edhe deri tani kanë dhuruar/sponsorizuar edhe në bazë të stimulimeve tatimore, eventualisht do ta rrisnin atë shumë për 10% sa është real tatimor.

Në mënyrë plotësuese, ligji parasheh tip të njëjtë të lirimit nga tatimi te donacionet dhe sponsorimet (me limit të sipërm të ndryshëm). Në praktikën evropiane zakonisht donacionet dhe sponsorimet trajtohen ndryshëm duke marrë parasysh se ndërmarrje merr shërbim gjatë çdo sponsorizimi individual. Sponsorizimet në pjesën më të madhe të vendeve (p.sh. Britania e Madhe, Australi) trajtohen si shpenzime. Në të kundërtën, donacionet trajtohen me lirime të ndryshme nga tatimi.

► *Tatimimi i donacioneve të fondacioneve me tatim në fitim*

Fondacionet dhe fondet në kuadër të disa shoqatave formohen me qëllim kryesor të distribuojnë donacione (grante) për mbështetje të bashkësive lokale ose zgjidhjen e problemeve të caktuara shoqërore. Në këtë drejtim, dhurimi i donacioneve është funksion primar operativ i fondacioneve dhe fondeve dhe duhet të trajtohet si shpenzim i pranuar që nuk është rast në praktikën e deritanishme në legjislacioni tonë, që këto donacione i barazon me ato nga shoqatat tregtare. Edhe pse kjo nuk është e lidhur drejtpërdrejtë me këtë Ligj, i prek beneficionet tatimore dhe mënyrën në të cilën realizohen donacionet nga ana e fondacioneve dhe fondeve jofitimprurëse.

► *Sistem joefikas për lirim nga TVSH-ja*

Disa përfaqësues të dhënësve dhe marrësve informojnë për vështirësi në realizimin në kohë të lirimit nga tatimi në bazë të TVSH-së. Sipas përfaqësuesit nga kompania që është donator i madh: “Shumë vjet në të kaluarën e shfrytëzuam ligjin dhe rregullisht bëjmë kthimin e TVSH-së, më parë në afat prej 3 ditëve ktheheshin të hollat, ndërsa tani presim me muaj. Procedura që mjetet të shkojnë në llogarinë e arkës e pastaj të kthehen nuk është praktike, është mirë të gjenden mënyra tjera që të

kryhet lirimi nga TVSH-ja.⁷² Megjithatë zgjidhja e këtillë në Ligj është e harmonizuar me procedurën sipas së cilës realizohen edhe lirimet nga tatimi nga TVSH-ja te donacionet e huaja.

► *Pagesa e TVSH-së te tele-dhurimi*

Akoma llogaritet TVSH-ja gjatë dhurimit me anë të SMS ose telefonit goftë për persona fizik ose juridik sipas nenit 15 nga Ligji, ku në mënyrë eksplicite është cekur se shërbimet komunikuese, kur janë pjesë e projektit me interes publik, janë të liruara nga pagesa e TVSH-së. Në pajtim me Ligjin, donacionet te personat fizik nuk janë lëndë e nxitjeve tatimore për dhënësin, e prej këtu nuk ekziston mundësia që të merren parasysh donacionet e këtilla të personave fizik në pjesën e nxitjeve tatimore te tatimi personal i të ardhurave ose të TVSH-së. Megjithatë, kjo dispozitë mund të aplikohet kur marrësit janë persona juridik (shoqata, institucione publike etj.).

Në mënyrë plotësuese, në praktikë nuk realizohet lirimi nga TVSH-ja te pri-pejd kartelat. Nga ana e organeve kompetente nuk ekzisto asnjë problem për realizimin e këtij lirimi tatimor, dhe të njëjtit këtë e drejtojnë te kompanitë tele-komunikuese të cilët teknikisht duhet ta mundësojnë këtë opsion gjatë pagesës së lajmërimeve dhe sms donacioneve.

► *Donacionet nuk pranohen me marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë*

Edhe pse neni 17 u jep mundësi dhënësve, personit fizik dhe juridik, që DHP tu jep vërtetim me qëllim që ata ta realizojnë lehtësimin tatimor në shtetin e tyre amë, në praktikë zgjidhja e këtillë nuk aplikohet. Në të vërtetë, donacionet nuk janë përfshirë me marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë, që i kontraktton shteti ynë me shtetet tjera, si pasojë dhënësi i huaj nuk është në mundësi ta shfrytëzojë lirimin nga tatimi sipas kësaj baze. Lirimi nga tatimi në këtë rast është mundësuar që të realizohet vetëm në rastet kur personi i huaj është regjistruar dhe paguan tatime në Maqedoni ose kur shteti amë në ligjet e veta për lirime nga tatimi të donacioneve mundëson beneficione tatimore gjatë dhurimit

⁷² Përfaqësues i ndërmarrjes së takimit me përfaqësues të institucioneve dhe kompanive lidhur me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike, 07.07.2011.

jashtë vendit. Joharmonizimi i trajtimit të tatimit të trashëgimisë me ligjin përkatës

Përfaqësuesit nga Ministria e Financave dhe DHP flasin për atë se trashëgimia rregullohet me ligj të veçantë dhe nuk mund të ketë trajtim si donacion. Nga ky aspekt, edhe pse nxitja tatimore akoma nuk shfrytëzohet në praktikë nga ana e shfrytëzuesve të Ligjit, gjatë revizionit të tij nevojitet harmonizim adekuat i kësaj dispozite.

4.3. REKOMANDIME

Rekomandimet lidhur me nxitjet konkrete tatimore janë grupuar lidhur me: 1) ndryshimet në ligj që të mundësohet aplikimi i tyre i serishëm dhe 2) zgjidhet e mundshme për ndryshime në vetë nxitjet tatimore për stimulimin më të madh të dhënësve.

1. Rekomandime për mundësimin e aplikimit të plotë të nxitjeve ekzistuese tatimore

Nga ky aspekt sfidë më e madhe ekziston te **lirimi nga TVSH-ja** kur dhënësit janë persona fizik dhe është e domosdoshme që të mundësohet efektuimi i kësaj nxitje tatimore për të gjithë personat fizik, të ardhurat e të cilëve i nënshtrohen tatimit me këtë tatim. Veçanërisht nga aspekti që thelbi i vërtetë i filantropisë qëndron në dhurimin nga ana e personave fizik dhe nevojitet që ato me të vërtetë të nxiten përmes lehtësimeve tatimore, që do të sjellë deri te ndryshimi afatgjatë i vetëdijes ndaj dhurimit në interesin publik.

Në këtë drejtim nevojitet të bëhen 3 revizione lidhur me TPA. Së pari, të revidohet neni 13 me atë që termi “borxhi tatimor vjetor” do të aplikohet në “tatim personal vjetor i të ardhurave” që përputhet me terminologjinë e ligjit adekuat dhe është në pajtim me parimin e kredisë tatimore. E dyta, të ndryshohet formulari i fletëparaqitjes tatimore vjetore për shumën e dhuruar në veprimtaritë publike ta trajtojë si kredi tatimore. E treta, është mirë të kontrollohet mënyra e realizimit të lirimit nga tatimi, gjegjësisht e njëjta të trajtohet si “parapagesë tatimore” dhe pas përpunimit të TPA-FTV ti kthehet dhënësit përmes pagesës në llogarinë e transaksionit. Në këtë

mënyrë pagesa paradhënie e TPA nuk do të paraqesë problem të madh. Në të njëjtën kohë, edhe personat që fitojnë të ardhura vetëm në bazë të ardhurave personale do të mund (nëse dëshirojnë ta gëzojnë nxitjen tatimore) të parashtrojnë TPA-FTV dhe me këtë ta realizojnë lirimin.

Lidhur me **Tatimin në fitim**, nevojitet të saktësohet se donacionet dhe grantet të cilat jepen nga ana e fondacioneve dhe fusha e veprimit të punës së tyre, nuk janë lëndë e tatimit me Tatimin në fitim.

Lidhur me **TVSH-në**, do të mund të shqyrtohej mundësia për përmirësimin e “efikasitetit” në pagesën e TVSH-së. Nga aspekti i tele-donacioneve, lirimi në rast kur shfrytëzues i fundit është personi fizik mund të rregullohet përmes kufizimit adekuat të fondacionit korporativ si marrës ose ndërmarrja nga fusha e telekomunikimit që ti realizojë me ndërmjetësim të organizatës partnere qytetare që do të jetë marrësi dhe e cila më tej do ti distribuojë këto donacione ndaj personave fizik. Gjatë kësaj, duhet të realizohet bashkëpunim me kompanitë tele-komunikuese që të gjenden zgjidhje softueri, që do të mundësojë lirimin nga TVSH-ja edhe te pri-pejd kartelat.

Krahas dispozitave të drejtpërdrejta në ligj, për përcjelljen adekuate të ndikimit të Ligjit nevojitet të revidohen formularët për evidencën shtetërore për subjektet (Formulari “DE”) që të përfshijnë informatë adekuate dhe më të hollësishme për nivelin e donacioneve dhe sponsorimeve të dhëna dhe të pranura.

2. Rekomandimet për zgjidhjet e mundshme për ndryshime në vetë nxitjet tatimore për stimulimin më të madh të dhënësve

Përvojat krahasuese nga vendet tjera flasin për atë se nuk ka zgjidhje të vetme për nxitjet tatimore. Në çdo vend ato varen nga shumë faktorë, si për shembull: politika tatimore, nevojat për dhurim/sponsorizim, shkalla e zhvillimit të filantropisë. Lidhur me tatimin në fitim, në numrin më të madh të vendeve aplikohet parimi i deduktimit tatimor. Gjatë kësaj, për shembull në Bullgari lehtësimi tatimor është 10% nga fitimi para tatimit. Në Estoni është prezent zgjidhja e njëjtë me atë që dhënësi ka mundësi të zgjedh edhe modalitet tjetër (3% nga shuma e pagesave të bëra të cilat i nënshtrohen tatimit të sigurimit social). Në Kroaci lehtësimi tatimor

është kufizuar në 2% nga të ardhurat e realizuara. Në Hungari, zvogëlimi tatimor është 20% nga donacioni i dhënë organizatës me interes publik, dhe 20% të tjera (do të thotë 40%) nga donacioni i dhënë organizatës me interes publik nëse është dhënë në bazë të marrëveshjes afatgjate për donacion. Edhe në të dy rastet zvogëlimi mund të jetë më së shumti deri në lartësinë e fitimit para tatimit.

Lidhur me tatimin personal të ardhurave, parimi i nxitjes tatimore gjithashtu dallohet nga shteti në shtet. Në Slloveni aplikohet parimi i kredisë tatimore dhe ai është 0,5% nga shuma vjetore e tatimit personal pa kufizime plotësuese. Në Bullgari shfrytëzohet deduktimi tatimor (zvogëlohet baza tatimore) deri 5% nga të ardhurat vjetore të dhënësit. Në Kroaci përqindja është 2%, ndërsa në Poloni 6% nga të ardhurat që i nënshtrohen tatimit.

Nëse shteti dëshiron të nxisë nivele më të mëdha të donacioneve dhe sponsorimeve në veprimtari të caktuara (për shembull në shkencë dhe hulumtim) mund të mendohet për mbështetje të diferencuar me lirime më të mëdha tatimore. Megjithatë, kjo duhet të jetë e argumentuar në mënyrë adekuate dhe e kufizuar në fushat të cilat marrin mbështetje minimale, ndërsa llogariten si të rëndësishme për të mirën publike, si do të mundësohej trajtim i barabartë i dhënësve. Shembuj të vërtetimit të nxitjeve më të larta tatimore për dhurimin në veprimtari të caktuara hasen në vende tjera evropiane: në Bullgari kjo ka të bëjë me tip të caktuar të mbështetjes në kulturë, në Letoni Komitetit Olimpik, ndërsa në Hungari ekziston Fondi kulturor hungarez ose Fondi hungarez për përtëritje.⁷³

Lidhur me **tatimin personal në fitim** duhet të mendohet për mënyrat se si do të nxitet dhurimi i rritur nga ana e personave fizik me të ardhura të rritura. Në të vërtetë, kufizimet ekzistuese nga 24.000 denarë janë nxitje adekuate te personat fizik të cilët kanë më pak ose rreth 1.080.000 denarë neto të ardhura vjetore (ose 90.000 denarë neto të ardhura mujore), pasi që te ata kufizimi prej 20% të borxhi tatimor vjetor do të ishte më i vogël ose i barabartë me 24.000 denarë. Struktura e të ardhurave vetëm në bazë të rrogës në shtetin tonë është e tillë që vetëm 5.8% të punësuarve kanë neto

⁷³ Beneficionet tatimore për donatorët, Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (ECNL), 2010 dhe pasqyra e beneficioneve tatimore dhe procedura për donacione, ENCL 2001.

rrogë mujore më të lartë se 30.001⁷⁴. Si pasojë, për shumicën e qytetarëve të cilët realizojnë të ardhura vetëm në bazë të rrogës ky lehtësim tatimor është adekuat. Megjithatë, nëse e marrim parasysh se 10 qytetarët e parë me të ardhura më të larta kanë paraqitur bruto të ardhura vjetore prej mbi 58.000.000 denarë, e vetëm në bazë të rrogës 10 bruto rrogat vjetore më të larta janë mbi 12.000.000 denarë⁷⁵, kufizimi i këtillë prej 24.000 denarë nuk i stimulon personat fizik me të ardhura më të larta, të cilët janë ata të cilët mund të investojnë dukshëm në zhvillimin e shoqërisë.

Zgjidhjet e reviduara do të mund të parashihnin: a) rritja e kufizimit; b) pezullimi i kufizimit, ndërsa zvogëlim i shumës prej 20% që të shmanget intervenim më i madh nga Buxheti ose c) vendosja e kufizimeve të përqindjes nga donacionet që mund të zbritet nga tatimi (siç është rast në Francë, e cila gjithashtu i shfrytëzon kreditë tatimore si të ardhura). Për shembull, në Francë mund të shfrytëzohet lirimi nga tatimi për 66% nga vlera e donacionit deri në maksimum 20% nga shuma vjetore e tatimit personal.

Lidhur me nxitjen tatimore te **tatimi në fitim** palët e prekura kanë mendime të ndryshme. Në pjesën më të madhe të intervistave dhe sesioneve u përmend se duke marrë parasysh që ekzistojnë lirime të dukshme nga tatimi nga tatimi i fitimit dhe kur mjetet shfrytëzohen për biznes qëllime, dhe në të njëjtën kohë shkalle tatimit është e ulët kjo nxitje tatimore nuk është motiv i vërtetë për dhurim dhe nga ky aspekt nuk nxit në masë të mjaftueshme. U propozua si opsion i mundshëm vendosja e kredisë tatimore (siç është rasti në Francë dhe Letoni). Por nga ana tjetër, duke marrë parasysh se kompanitë maqedonase nuk paraqesin fitime të mëdha, në rastin e kredisë tatimore dukshëm do të ulej shuma e përgjithshme, që potencialisht do të mund të dhurohej me shfrytëzimin e nxitjes tatimore. Disa nga pjesëmarrësit në grupet punuese sektoriale treguan se lirimi nga TVSH-ja për shumën e dhuruar do të ishte stimul shumë më i madh se sa nga tatimi i fitimit. Megjithatë, në praktikën krahasuese nuk janë vërejtur zgjidhje të këtilla.

74 Të punësuar dhe neto rrogat 2010, Pasqyrë statistikore: popullata dhe statistikat sociale, Enti Shtetëror për Statistikë, korrik 2011

75 Analizë "Fletëparaqitja tatimore vjetore 2010", Drejtoria e të hyrave publike, nëntor 2011

Në mënyrë plotësuese, përfaqësuesit e shoqatave dhe fondacioneve propozuan të mendohet për mundësinë për shkalla të ndryshme të nxitjes tatimore varësisht nga marrësi, ku donacionet ndaj shoqatave dhe fondacioneve do të gëzonin lirim më të madh, me qëllim që të nxitet dhurimi ndaj tyre, që për momentin mbetet prapa dhurimit në institucionet publike.

Për t'u krahasuar, në shumicën e vendeve evropiane parimi i liritimit nga tatimi është deduktimi tatimor gjegjësisht ulja e bazës tatimore. Dallim ka në nivelin e kufizimit me atë që te shumë vende ai llogaritet në bazë të ardhurave që i nënshtrohen tatimimit (në vend të ardhurave të përgjithshme d.m.th. qarkullimit). Kështu në Holandë mundësohet deri 10% nga të ardhurat që i nënshtrohen tatimimit ose 0.4% nga qarkullimi i përgjithshëm dhe rrogat.

V. EVIDENTIMI,
LAJMËRIMI,
KONTROLI
DHE DISPOZITAT
E PENALE TË
DONACIONEVE DHE
SPONZORIMEVE
TË CILAT JANË
OBJEKT I NXITJEVE
TATIMORE

V. EVIDENTIMI, LAJMËRIMI, KONTROLLI DHE DISPOZITAT E PENALE TË DONACIONEVE DHE SPONZORIMEVE TË CILAT JANË OBJEKT I NXITJEVE TATIMORE

5.1. GJENDJA AKTUALE

Kapitulli katër i Ligjit i mbulon çështjet për evidentimin, llogaridhënien dhe kontrollin e donacioneve dhe sponsorimeve në veprimtaritë publike. Ky është aspekt i rëndësishëm i rregullores ligjore pasi që ka ndikim si mbi shkallën deri te e cila dhënësi i shfrytëzon nxitjet tatimore, ashti edhe mbi ndërtimin e besimit në konceptin e dhurimit privat.

Në pajtim me nenin 19 nga Ligji, edhe dhënësi edhe marrësi i donacionit dhe sponsorizimit janë të obligueshëm që deri te Drejtoria e të hyrave publike të parashtrojnë raport për donacionin dhe sponsorizimin e dhënë dhe të pranuar më së voni deri 30 ditë nga dita e përmbushjes së marrëveshjes për donacione ose sponsorime. Raporti, krahas të dhënave për dhënësin dhe marrësin kërkon edhe përshkrim të lëndës së donacionit dhe sponsorizimit si dhe përdorimi i fundit i donacionit dhe sponsorizimit dhe të dhëna tjera. DHP ka përgatitur formularë për raportim (“UJP-IDS/DV” dhe “UJP-IDS/PR”) në të cilat ceken dhënësi dhe marrësi, por gjithashtu kërkohen edhe të dhëna për “shfrytëzuesin

e fundit”. Në mënyrë plotësuese, me formularin DHP ka rregulluar se si shtojcë duhet të jepet Marrëveshja për donacion dhe vendimi i Ministrisë së Drejtësisë me të cilin vërtetohet interesi publik për donacionin ose sponsorizimin e paraparë ose – nëse nuk është marrë vendim – Kërkesa e parashtruar për vërtetimin e interesit publik. Krahas kësaj, në udhëzimin për Ligjin të përgatitur nga DHP përmendet se duhet të parashtrohet edhe Vërtetimi për donacionin/sponsorizimin e pranuar.

Kontrolli të dhurimit, pranimi dhe shfrytëzimit të donacionit dhe sponsorizimit, në pajtim me nenin 20 alineja 1 nga Ligji, kryen DHP dhe “organet tjera kompetente”. Për parregullsitë dhe keqpërdorimet e vërtetuara gjatë shfrytëzimit të donacionit dhe sponsorizimit të njëjtit mund të parashtrojnë fletëparaqitje për kundërvajtje ose fletëparaqitje penale.

Në pajtim me nenin 22, nëse donacioni dhe sponsorizimi nuk kanë karakter të donacionit me interes publik, DHP sjell vendim me të cilin ndërpritet e drejta e nxitjes tatimore dhe e dorëzon deri te dhënësi dhe/ose marrësi i donacionit dhe sponsorizimit. Ankesa ndaj vendimit të tillë mund të parashtrohet deri te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë në marrëdhënie pune në shkallën e dytë.

Kapitulli 5 nga ligji ka të bëjë me dispozitat penale sipas të cilave është caktuar gjopa në rastet që vijnë:

- » Për marrësin e donacionit (person juridik dhe personi i tij përgjegjës) nëse nuk lidhet marrëveshje në formë të shkruar;
- » Për marrësin e donacionit (personi juridik dhe personi i tij përgjegjës) nëse nuk parashtrohet raport për donacionin dhe sponsorizimin e dhënë dhe të pranuar;
- » Për marrësin e donacionit (personi juridik dhe personi i tij përgjegjës) nëse nuk e shfrytëzon donacionin ose sponsorizimin në pajtim me marrëveshjen. Në atë rast lënda e donacionit ose sponsorizimit i kthehet dhënësit të donacionit/sponsorizimit;
- » Për marrësin e donacionit (personi juridik dhe personi i tij përgjegjës) nëse marrëveshjen dhe dokumentacionin tjetër nuk e ruan më së paku pesë vjet;

- » Për personin fizik për mosrespektimin e dispozitave nga neni 4 (lëndë e donacionit dhe sponsorizimit), neni 7 alineja (3) (për marrësit e donacionit), neni 8 alineja (1) (për marrësit e sponsorizimit), neni 17 alineja (1) (për persona të huaj fizik dhe juridik si dhënës të donacionit/sponsorizimit) dhe neni 19 alineja (3) (për raportim për donacionet dhe sponsorimet).

5.2. SFIDAT

Nga aspekti i evidencës, llogaridhënies, kontrollit dhe dispozitat penale janë identifikuar sfida të shumta si nga ana e shfrytëzuesve, ashtu edhe nga ana e institucioneve. Një pjesë e këtyre sfidave janë lidhur me vetë dispozitat e ligjit, por një pjesë kanë të bëjnë edhe me vetë qëllimet e llogaridhënies dhe kontrollit dhe si ato ndikojnë në efikasitetin e sistemit të nxitjeve tatimore te donacionet dhe sponsorimet.

Në zbatimin e deritanishëm të ligjit janë identifikuar sfidat që vijojnë:

- *Mosekzistimi i evidencës së zgjidhjeve për donacione/ sponsorime me interes publik.*

Në Ligj nuk ka dispozita me të cilat rregullohet udhëheqja e regjistrit në Ministrinë e Drejtësisë për donacione dhe sponsorime, për shkak se nuk ka evidencë për numrin e saktë të kërkesave të parashtruara dhe të zgjidhura. Në bazë, Ministria e Drejtësisë nuk është e obliguar të udhëheqë bazën e të dhënave për kërkesat e parashtruara, me çka vështirësohet ndjekja e zbatimit të Ligjit.⁷⁶ E ngjashme është situata edhe me ministrinë kompetente të cilat shpeshherë nuk kanë të dhëna për donacionet dhe sponsorimet në veprimtaritë me interes publik, të cilat janë në fushën e tyre. Një pjesë e donacioneve, veçanërisht në arsim, aspak nuk evidentohen.⁷⁷

⁷⁶ Dokument me shkrim nga Ministria e Drejtësisë për diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

⁷⁷ Dëshmi e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, z. Nikolla Todorov, në diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

Në mënyrë plotësuese, në formatet për raportim financiar vjetor të personave juridik nuk janë ndarë kategoritë për donacionet nga ato për sponsorime të dhënësit, si dhe kategoritë të marrësit që të ceken dhe të ndahen donacionet nga personat juridik dhe fizik nga vendi dhe jashtë.” Në këtë mënyrë anashkalohej mundësia për evidentim adekuat dhe përcjellje të efekteve nga ligji mbi dhënësit dhe niveli i donacioneve dhe nivelet e donacioneve dhe sponsorimeve.

- *Ngarkimi ndaj dhënësve dhe marrësve për paraqitje të obligueshme të raporteve deri te DHP nuk përpunet me qëllimet e raportimit dhe thelbit të dhurimit/sponsorizimit.*

Dhuruesit dhe marrësit janë të obliguar që të parashtrojnë raport për çdo donacion deri te DHP, në vend të raportimit agregat në raportin vjetor. Edhe pse formularët e përgatitur nga DHP për raportim janë të thjeshta, kjo paraqet ngarkesë plotësuese administrative, veçanërisht për dhënësit. Gjatë kësaj, edhe pse ligji para vendosjes së ndryshimeve të fundit në vitin 2011 nuk impononte obligim, DHP ka përcaktuar se në shtojcë të Raportit duhet të parashtrohet edhe Marrëveshja për donacion dhe Vendimi i Ministrisë së Drejtësisë (ose Kërkesa e parashtruar për vërtetimin e interesit publik). “Ky është hap i panevojshëm. Ne paraprakisht jemi drejtuar deri te institucioni përkatës (Ministria e Drejtësisë), ata e kanë kontrolluar interesin publik. E ne pastaj duhet përsëri ta dërgojmë vendimin me raportin deri te DHP dhe për këtë nuk marrim përgjigje.”⁷⁸

Dispozita për raportim kërkon që raporti të dorëzohet më së voni 30 ditë nga dita e përmbushjes së marrëveshjes. Duke marrë parasysh që dispozitat e marrëveshjes zakonisht përmbajnë obligim për realizimin e aktivitetit të caktuar me interes publik nga ana e marrësit, raporti do të parashtrohej pasiqë të realizohet aktiviteti. Kjo nënkupton se dhënësi që të mund ta parashtrojë raportin e vet duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm me marrësin që shpesh nuk është rast as te ne, as në praktikën botërore të dhurimit. Gjithashtu, shumë shpesh, aktivitetet realizohen në afat kohor i cili përfshinë dy ose më shumë vite fiskale që e komplikon raportimin për realizimin e aktivitetit. Edhe pse dhënësit e kanë realizuar donacionin (e kanë transferuar te marrësi)

⁷⁸ Deklaratë e përfaqësuesit të biznes ektorit për nevojat e hulumtimit të zbatuar nga Shoqata Konekt, 2011.

dhe kanë të drejtë të fitojnë zvogëlim të tatimit në fitim, nuk do ta kenë dokumentacionin e plotë pasi që projekti nuk ka përfunduar. Në rastin e tillë u këshillohet nga ana e Drejtorisë për të hyra publike që të përgatisin dhe të parashtrojnë raport vetëm për pjesën e projektit të zbatuar në atë vit fiskal, derisa për pjesën tjetër do të përgatitet raport vitin e ardhshëm.

Sipas njohurive nga DHP raportet atyre u shërbejnë për evidencë adekuate të donacioneve dhe sponsorimeve për ndonjë dhënës të caktuar, si do të mund ta llogarisnin nivelin e lehtësimeve tatimore që në praktikë bëhet pas parashtrimit të llogarisë vjetore dhe fletëparaqitjeve tatimore vjetore (kur dhënësit janë persona fizik). Nga ky aspekt nuk duke e përmbajtur as dispozita praktike për raportim pas përmbushjes së marrëveshjes.

Ligji kërkon që raporti të përmbajë informata për përdorimin e fundit të lëndës së donacionit dhe sponsorizimit. Sipas kësaj, formulari i përcaktuar nga DHP kërkon informatë për “NVT/NVAQ të shfrytëzuesit të fundit të donacioneve/sponsorimeve.” Siç është sqaruar në Kapitullin II kërkesa e tillë nuk përputhet me praktikën ku si shfrytëzues të fundit mund të paraqiten më shumë persona fizik, persona juridik (shoqata të tjera, komuna etj.), por edhe grupe joformale të qytetarëve dhe bashkësia më e gjerë. Rishtas, këto terme nuk përmenden në asnjë vend tjetër në ligj.

Në praktikë, përfaqësues të DHP informojnë se jo të gjithë dhënësit dhe marrësit parashtrojnë raporte gjatë vitit.

► *Parashtrimi i dokumenteve me të cilat tashmë disponojnë organet kompetente*

Marrëveshja për donacion, kërkesa për vërtetimin e interesit publik dhe Vendimi me të cilin vërtetohet interesi publik për donacionin ose sponsorizimin e paraparë janë dokumente me të cilat tashmë disponon Ministria e Drejtësisë, e kështu paraqet ngarkesë të panevojshme administrative, DHP përsëri ti kërkojë të gjitha këto dokumente nga dhënësi ose marrësi si shtojcë e Raportit. Obligimi nga parashtrimi i dokumenteve të tilla nga marrësit dhe dhënësit është imponuar nga DHP dhe nuk del drejtpërdrejtë nga Ligji.

► *Paqartësi në përcaktimin e sistemit për kontroll të shfrytëzimit të donacionit dhe sponsorizimit*

Në pajtim me nenin 20, alineja 1 nga Ligji, krahas DHP ekzistojnë edhe organe tjera kompetente për kontroll të dhurimit, pranimi dhe shfrytëzimit të donacionit dhe sponsorizimit gjatë shfrytëzimit të nxitjeve tatimore. Nuk është saktësuar se cilat janë ato “organe tjera kompetente”⁷⁹ Nëse donacioni dhe sponsorizimi nuk kanë karakter të donacionit dhe sponsorizimit me interes publik, DHP sjell vendim me të cilin hiqet e drejta e nxitjeve tatimore. Rishtas, dispozitat penale parashohin gjobë nëse donacioni/sponsorizimi nuk shfrytëzohet në pajtim me marrëveshjen.

Në praktikë nuk është e qartë se kush e kryen kontrollin e shfrytëzimit të donacionit dhe sponsorizimit. Sipas DHP, qëllimi i raporteve të lartpërmendura është të shërbejnë për “çiftëzim” (krahasim) me të dhënat nga bilanci tatimor (të dhurimit dhe pranimi).⁸⁰ DHP nuk ndjek nëse marrësi i ka shfrytëzuar mjetet për atë për çka janë dedikuar (shfrytëzimi i donacionit/sponsorizimit). Nga praktika ata zakonisht e aplikojnë nenin 22, vetëm në raste kur dhënësi ka paraqitur lehtësim tatimor, e më vonë është vërtetuar se për këtë donacion/sponsorizim Ministria e Drejtësisë ka dhënë mendim negativ. Sqarimi nga DHP për nevojën nga involvimi i dhënësit në kontrollin është se dhënësi është shfrytëzues i nxitjeve tatimore, e prej këtu DHP duhet ta përcjellë dhe ta kontrollojë.⁸¹

Megjithatë, dispozitat ligjore ekstensive për kontroll dhe mbrojtje të interesit publik shpeshherë shkaktojnë kritika nga sektori civil. “Fitohet përshtypja se ligji ka qëllim themelor të shërbejë për mbrojtje nga keqpërdorimi, e jo ti nxisë donacionet dhe sponsorimet në veprimtaritë publike. Ai është restriktiv ndaj qytetarëve dhe organizatave qytetare, i demotivon donatorët dhe parimisht është në funksion të mbrojtjes së buxhetit.”⁸²

79 Dëshmi e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, z. Nikolla Todorov, në diskutimin mbikëqyrës parlamentar në temën “Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

80 Përfaqësues i DHP në takim me përfaqësues të institucioneve dhe kompanive lidhur me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike, 07.07.2011.

81 Përfaqësues i DHP në takim me përfaqësues të institucioneve dhe kompanive lidhur me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike, 07.07.2011.

82 Deklaratë e një përfaqësuesi të organizatës qytetare për nevojat e hulumtimit të zbatuar nga Shoqata Konekt, 2011.

Rishtas, fitohet përshtypja se dhënësit janë ata të cilët janë përgjegjës për shfrytëzimin e donacionit/sponsorizimit. Kjo është e kundërt me definicionet dhe frymën e dhurimit. Në të vërtetë, pasi që dhënësit ta kenë realizuar (dhënë) donacionin/sponsorizimin i njëjti kalon në pronësi të marrësit dhe ata nuk kanë kurrfarë obligime ndaj saj, e as nuk kanë kontroll mbi atë se si ai shfrytëzohet.

► *Një pjesë e dispozitave penale janë të paqarta*

Në pjesën më të madhe dispozitat penale kanë të bëjnë me marrësin që përputhet me parimin se marrësit janë përgjegjës për shfrytëzimin e donacionit/sponsorizimit në interes publik. Megjithatë ekzistojnë paqartësi lidhur me qëndrimin dhe formulimin e një pjese të dispozitave penale dhe atë:

- » Nuk është e qartë pse parashihet gjobë nëse nuk lidhet marrëveshje. Duke pasur parasysh se marrëveshja është dokument i obligueshëm për realizimin e beneficionit tatimor, më logjike është që në mungesë të përgjigjes vetëm të hiqet, gjegjësisht të mos realizohet lehtësimi tatimor;
- » Është paraparë gjobë për marrësin nëse nuk përgatit raport si për donacionin/sponsorizimin e pranuar ashtu edhe atë të dhuruar. Përgatitja e raportit për donacionin/sponsorizimin e dhuruar është obligim i dhënësit dhe nuk mund të obligohet me këtë marrësi; Duke marrë parasysh se për momentin nuk ekziston organ i cili e përcjell shfrytëzimin e donacionit/sponsorizimit, nuk është e qartë kush do ta lëshonte dispozitën penale nga neni 24;
- » Nuk është e qartë për çka obligohet personi fizik në nenin 26, duke pasur parasysh se nenet 7 dhe 8 kanë të bëjnë me marrësin, ndërsa personat fizik nuk mund të paraqiten si marrës të donacioneve dhe sponsorimeve në pajtim me këtë ligj.

5.3. REKOMANDIME

Sistemi i evidencës, përcjelljes dhe kontrollit duhet të revidohet si nga aspekti i qëllimeve, ashti edhe nga aspekti i organeve kompetente. Gjatë kësaj duhet të mbahet llogari për parimet që vijnë:

- » Dhuruesit dhurojnë me vullnet të mirë, për të mirën publike dhe nuk kanë kontroll, e as do të duhej të mbanin llogari për mënyrën se si përdoret;
- » Duke pasur parasysh se dhënësit i gëzojnë beneficionet tatimore, DHP është e obliguar të zbatojë përcjelljen adekuate të dhurimeve (donacion ose sponsorizim) në interesin publik;
- » Zvogëlimi i ngarkesës administrative për raportim në drejtim të efikasitetit të rritur;
- » Vendosja e raportimit adekuat nga ana e marrësit për shfrytëzimin e donacionit/sponsorizimit;
- » Shfrytëzimi i sistemit administrativ për përcjellje të efekteve nga ligji.

Lidhur me **evidencën**, rekomandohet krijimi i regjistrit i cili përmban informatë për: 1) marrësit e donacioneve/sponsorimeve me status të interesit publik dhe 2) projektet/aktivitetet për të cilat është dhënë vendim për interes publik. Në këtë mënyrë marrësit vazhdimisht do të mund të informohen për atë nëse donacioni/sponsorizimi do të ketë beneficion tatimor. Nga ana tjetër kjo do të mundësojë edhe kontroll më të mirë nga ana e DHP dhe zvogëlimin e vëllimit të dokumentacionit që dhënësit dhe marrësit do të duhet ta parashtrorjnë me raportin.

Në drejtim të rekomandimeve të përgjithshme, **sistemi për raportim** duhet të thjeshtohet dhe të lidhet me parashtrimin e bilanceve vjetore dhe fletëparaqitjeve tatimore vjetore. Çfarëdo raporti ose dokumentacioni lidhur me donacionin/sponsorizimin duhet të jenë pjesë shoqëruese e dokumentacionit të kontabilitetit dhe të parashtruar deri te DHP bashkë me llogarinë përfundimtare. Në drejtim të zvogëlimit plotësues të dokumenteve të prodhuara do të mund të mendohej për vendosjen e formularit për raportim integral për të gjitha donacionet dhe sponsorimet (të cilat gëzojnë lehtësime tatimore) te një dhënës ose marrës (në vend të atyre individuale për çdo donacion/sponsorizim). Gjatë kësaj, raportimi

nga ana e marrësve duhet të mundësojë grumbullimin e të dhënave për lartësinë e donacioneve të pranuara dhe lartësinë e sponsorimeve të pranuara, të cilat i nënshtrohen nxitjeve tatimore të ndara sipas llojit të marrësit (person fizik ose juridik dhe tipi i personit juridik) dhe sipas veprimtarisë publike. Kjo edhe DHP-së do t'i mundësojë kontroll integral të çdo dhënësi dhe marrësi (në vend që ata ta azhurnojnë çdo raport veçmas).

Nevojitet të saktësohet roli i DHP-së në ***kontrollin e shfrytëzimit të donacioneve/sponsorimeve*** të cilat gëzojnë benefecione tatimore. Krahas kësaj, nevojitet të saktësohet cilat janë “organet tjera kompetente” për kontroll, krahas DHP-së.

Gjatë kësaj duhet të mbahet llogari se kontrolli për shfrytëzimin e donacionit/sponsorizimit duhet të kryhet mbi marrësit. Llogaridhënia të marrësit të cilët kanë status me interes publik është më e thjeshtë, pasi që ata parashtrojnë raporte të obligueshme ose deri te ministritë kompetente ose në rastin e shoqatave dhe fondacioneve me interes publik deri te Komisioni për dhënien e statusit OIP dhe Qeveria. Për projektet tjera të cilat do të marrin vendim për interes publik të projektit/aktivitetit mund të kërkohet vendosje të obligueshme të raportit (narrativ dhe financiar) për aktivitetin e dhënë në ueb faqen e marrësve (ose mjet tjetër të informimit), të cilat do të ishin lehtë të kapshme për organet kompetente.

Rishtas, për kontroll më të mirë në shfrytëzimin e donacionit/sponsorizimit, marrësi mund të obligohet me llogarinë përfundimtare të parashtrorë deri te DHP-ja edhe evidencë të kontabilitetit për shpenzimet e bëra me realizimin e aktivitetit për të cilin janë dhënë mjetet.

Kjo përputhet edhe me rregulloren në vendet e BE-së të përfshira me analizën krahasuese. Marrëveshja për donacion dhe sponsorizim si dhe Vërtetimi për donacionin/sponsorizimin e pranuar janë dokumente standarde të cilat parashtrohen me llogarinë përfundimtare, si të dhënësit ashtu edhe të marrësit. Rishtas, të gjitha vendet të cilat u analizuan nga aspekti i raportimit (Bullgaria, Polonia dhe Estonia) parashohin obligime për raportim për aktivitetet e realizuara me donacionin/sponsorizimin si dhe raport financiar për të ardhurat dhe shpenzimet për donacionet dhe sponsorimet të cilat gëzojnë nxitje tatimore. Krahas parashtrimit deri te institucionet kompetente, këto informata duhet të jenë të kapshme edhe

deri te opinionit. Për shembull, në Poloni, obligimi për raportim të këtillë të hollësishëm është e lidhur me lartësinë e donacioneve dhe të ardhurave të marrësit. Raporti është i obligueshëm nëse donacioni individual e tejkalon shumën prej 15.000 zllotë polake (rreth 4.774\$) ose nëse shuma e përgjithshme e donacioneve nga ana e një dhënësi gjatë vitit i tejkalon 35.000 zllotë polake (rreth 11.138\$). Për organizatat marrëse të ardhurat vjetore të cilave nuk i tejkalojnë 20.000 zllotë polake (rreth 6.364\$) janë liruar nga obligimi për raportim plotësues.

Dispozitat kundërvajtës duhet në tërësi të revidohen që të përputhen me dispozitat tjera nga ligji. Në këtë drejtim, në rastin e mungesës së Marrëveshjes për donacion/sponsorizim nuk dot të realizohet vetëm lehtësimi tatimor dhe nuk nevojitet gjobë plotësuese. Në rastin kur marrësi nuk do të jep Vërtetim për donacionin/sponsorizimin e pranuar (që është dokument i obligueshëm për dhënësin që të mund ta shfrytëzojë lehtësimin) duhet të parashihet dispozitë kundërvajtës për marrësin. Dispozitat kundërvajtës mund të parashihen edhe në rastin kur marrësi nuk i shfrytëzon mjete të pajtime qëllimit (që me vendimin e ri do të jetë e kapshme si informatë deri te DHP përmes dokumentacionit shoqërues me raportet përfundimtare).



VI. REKOMANDIME PËR NDRYSHIME NË DISPOZITAT E LIGJIT

VI. REKOMANDIME PËR NDRYSHIME NË DISPOZITAT E LIGJIT

Nga analiza duket se Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike duhet të pësojë ndryshime të mëdha në të gjitha pjesët e tij. Në bazë të rekomandimeve të dhëna në kapitullin e mëparshëm, ndërsa duke e ruajtur qëllimin primar të ligjit dhe aspektet pozitive të cilat janë identifikuar, ky kapitull në mënyrë përmbledhëse i prezanton rekomandimet për ndryshime të ligjit, si dhe aspektet plotësuese të cilat duhet të shqyrtohen në kuadër të këtij diskutimi ose ndonjë tjetër lidhur me këtë temë. Rekomandimet janë strukturuar në pajtim me kapitujt e dokumentit dhe logjikisht e ndjekin procesin sipas të cilit realizohen nxitjet tatimore.

Rekomandim i përgjithshëm

Në dispozitat e përgjithshme të Ligjit është e rëndësishme të përmendet se ky Ligj i trajton vetëm ato donacione dhe sponsorime të cilat dëshirojnë ti gëzojnë nxitjet tatimore. Ai nuk i kufizon dhurimet spontane e as donacionet/sponsorimet ku dhënësi nuk dëshiron ti shfrytëzojë nxitjet tatimore. Në këtë mënyrë do të shmanget moskuptimi se ligji është kufizues dhe imponon administratë plotësuese për të gjithë dhënësit dhe shfrytëzuesit e donacioneve dhe sponsorimeve.

6.1. PËRKUFIZIME DHE KOMENTIME TE TERMINOLOGJISE KRYESORE

Në zgjidhjen e re ligjore nevojitet revidim i tërësishëm i definicioneve, gjatë kësaj duke mbajtur llogari për harmonizimin e tyre me ligjet tjera të cilat i trajtojnë. Në mënyrë plotësuese, definicionet duhet të jenë të qarta që të mundësojnë komentim adekuat nga ana e institucioneve, por edhe shfrytëzuesit e ligjit. Në këtë drejtim rekomandohen këto ndryshime:

► *Përcaktimi i “veprimtarisë publike dhe “interesit publik”*

Duke pasur parasysh kompleksen e legjislationit maqedonas lidhur me përcaktimin e veprimtarive publike dhe interesit publik, e lidhur me këtë që termi “veprimtari publike” krijon konfuzion dhe nuk gjen aplikim praktik në dispozitat e ligjit, të cilat i përcaktojnë nxitjet tatimore dhe mënyrën se si ato fitohen, termi “veprimtari publike” duhet të fshihet nga terminologjia kyçe. Në atë rast, në përdorim di të mbetet termi interes publik (që kryesisht shfrytëzohet edhe në tekstin e tanishëm të ligjit). Njëkohësisht, emri i ligjit do të pësonte ndryshim adekuat dhe do të riemërohej në *“Ligji për donacione dhe sponsorime me interes publik”*.

Më tej, definicioni për “interes publik” do të ishte gjithëpërfshirëse dhe do të harmonizohej me Ligjin për shoqata dhe fondacione. Fushat mund të merren në pajtim me nenin 74 nga LSHF me çka veprimtaria “sporti amator” do të zëvendësohet me “sport” që të ruhet nevoja nga mbështetja gjithëpërfshirëse e sportit përmes nxitjeve tatimore. Njëkohësisht, si edhe deri tani, lihet mundësia që ndonjë veprimtari të përcaktohet si interes publik me ligjet tjera.

Rishtas, në definicionin për “interes publik” mund të inkuadrohen edhe kriteret të përgjithshme si:

- » aktivitetet/veprimtaritë janë të drejtuara ndaj opinionit më të gjerë dhe ndaj interesave të bashkësisë (në nivel nacional dhe lokal);
- » aktivitetet/veprimtaritë të jenë me karakter jofitimprurës (që të nënkuptojnë shpërndarje të fitimit të mundshëm të realizuar mes themeluesve, anëtarëve, anëtarëve të organeve, drejtorëve, të punësuarve ose cilitdo person tjetër të lidhur me ata);

Përcaktimi i interesit publik përmes aplikimit të kritereve më të gjera do t'i shmanget sfidat e identifikuara pasi që do të mundësojnë aplikim të definicioneve për interes publik si në Ligjin për shoqata dhe fondacione, ashtu edhe në ligjet nga fusha e sportit, kulturës dhe arsimit. Kjo njëherit do të jetë edhe në pajtim me praktikën pozitive evropiane.

► *Përcaktimi i dhënësve dhe marrësve*

Përcaktimi i marrësve dhe dhënësve të donacioneve dhe sponsorimeve është një nga çështjet kyçe që më tej do të ketë ndikim edhe mbi nivelin e nxitjeve tatimore, si dhe procedura sipas së cilës do të realizohen nxitjet tatimore. Duke u udhëhequr nga përvojat botërore dhe evropiane në këtë fushë, rekomandohet përcaktimi i tyre më i saktë, veçanërisht te marrësit.

Lidhur me *dhënësit* e donacioneve dhe sponsorimeve në pajtim me praktikën pozitive botërore duhet të ruhet përfshirja e gjerë e dhënësve të mundshëm dhe ata ti inkuadrojnë të gjithë personat fizik dhe juridik. Në mënyrë plotësuese, duhet të theksohet se ky ligj nuk i përfshinë donacionet të cilat vijnë përmes ndihmës zhvillimore të jashtme, dhënës të cilës nuk i nënshtrohen tatimimit.

Gjithashtu, nevojitet ose në këtë segment të ligjit ose te dispozitat të cilat kanë të bëjnë me Tatimin e fitimit, që të përmendet se donacionet dhe grantet të cilat jepen nga ana e fondacioneve dhe fondeve, nuk janë lëndë e tatimimit me Tatimin në fitim.

Lidhur me përcaktimin e *marrësve*, propozohet që në ligjin ato të ceken duke u përmendur. Gjatë kësaj duhet të mbahet llogari përmes përcaktimit të marrësve që të ruhet fryma për karakter jofitimprurës të vetë donacioneve dhe sponsorimeve. Në këtë drejtim, marrësit mund të jenë persona juridik me karakter jofitimprurës dhe atë:

- » Shoqata, fondacione, lidhje dhe forma organizative të organizatave të huaja në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione
- » Institucione publike
- » Organe të administratës shtetërore
- » Njësi të pushtetit lokal dhe Qyteti i Shkupit
- » Kisha, bashkësi fetare, grupe religjioze dhe shoqata të tyre

- » Klube sportive të regjistruara si shoqata sportive në pajtim me Ligjin për sport
- » Kryqi i Kuq i Maqedonisë
- » Akademia e Maqedonase e Shkencave dhe Arteve

Rishtas, në ligjin duhet të ceket definicioni adekuat për *personat juridik të huaj me status të organizatave me interes publik si marrës* të donacioneve dhe sponsorimeve në drejtim të harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian lidhur me donacionet tej kufitare.

Gjithashtu, për shkak të vendosjes së termi i jofitimprurës, nevojitet që në definicionet të inkuadrohet edhe termi “*parim jofitimprurës*”, i cili do të ndërmerret nga definicioni adekuat në Ligjin për shoqata dhe fondacione. Gjithashtu në definicionet duhet të shtohet edhe termi Organizatë me interes publik në pajtime LSHF.

► *Përcaktimi i promovimit dhe reklama*

Në ligj nevojitet saktësisht të caktohen dallimet në theksimin e emrit të donatorit me promovimin e emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse në rast të sponsorizimit. Sponsorizimi si raport i kontraktuar pikërisht qëndron në sigurimin e dobisë së drejtpërdrejtë të mirave dhe shërbimeve më shpesh përmes reklamës adekuate, gjegjësisht promovimit.

Në këtë drejtim, Ligji do të mund të përfshinte dallim më të saktë me atë që do të ceket se promovimi në kontekst të sponsorizimit do të llogaritej në rastin kur përfshinë:

- » shpallje të madhe dhe të theksuar të logos së dhënësit në cilindo material/publikim/publikim/resurs të shpallur të marrësit;
- » shpallje e madhe dhe e theksuar e ngjyrave korporative të dhënësit;
- » përshkrimi i të mirave dhe shërbimeve të dhënësit;
- » shfrytëzimi i logos së marrësit nga ana e dhënësit;
- » e drejta ekskluzive për shitjen e të mirave dhe shërbimeve gjatë ngjarjeve të organizuara nga ana e marrësit etj.

Nga ana tjetër do të theksohej se cekja e njehershme dhe e patheksuar e emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse të dhënësit të donacionit në raportet periodike dhe vjetore, publikime dhe ueb faqen e marrësit nuk llogaritet për promovim në kuptim të dobisë së drejtpërdrejtë për dhënësin.

Më tej, duhet të shqyrtohen mundësitë dhe të rekomandohet ndryshim adekuat edhe në Ligjin për veprimtari radiodifuzive, të cilët do ti pasqyrojnë në mënyrë adekuate dispozitat nga Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike lidhur me promovimin.

6.2. PROCEDURA ADMINISTRATIVE PËR VËRTETIMIN E INTERESIT PUBLIK DHE REALIZIMI I NXITJEVE TATIMORE

Ligji duhet të pësojë ndryshime thelbësore në procedurën administrative për vërtetimin e interesit publik dhe realizimin e nxitjeve tatimore. Gjatë kësaj duhet të mbahet llogari për parimet që vijnë:

- » Të sigurohet ex-ante informatë për interesin publik para lidhjes së marrëveshjes për donacion/sponsorizim (d.m.th. para se dhënësi ta sjell vendimin për realizimin e donacionit/sponsorizimit të dhënë);
- » Interesi publik të vërtetohet në mënyrë eksplicite për organet shtetërore (Drejtoria e të hyrave publike) që në mënyrë adekuate të mund të realizohet lirimi tatimor;
- » Shkurtimi i kohëzgjatjes së procedurës duke pasur parasysh dinamikën e dhënies së donacionit/sponsorizimit në praktikë;
- » Zvogëlimi i dokumentacionit të vëllimshëm dhe ngarkesës administrative veçanërisht për dhënësit;
- » Zvogëlimi i ngarkesës administrative për institucionet shtetërore.

Procedura duhet të revidohet në pajtim me praktikat pozitive evropiane, ku të njëjtat tregojnë se janë shumë të thjeshtëzuara dhe në pjesën më të madhe sillen deri në evidencë të kontabilitetit për donacionet dhe sponsorimet e dhëna.

Në këtë drejtim janë të mundshme tre zgjidhje për procedurën:

► *Opsioni 1*

Pranuesit të kufizohen vetëm në ata të cilët kanë status të përhershëm të vërtetuar të interesit publik d.m.th. në institucionet publike dhe OIP. Në këtë rast interesi publik do të lidhet me statusin e marrësit, e jo me aktivitetin për të cilin dhuron/sponsorizon. Të gjitha dhurimet ndaj këtyre subjekteve do të trajtohen si interes publik me çka në mënyrë të dukshme do të thjeshtohet procedura. Ky opsion gjithashtu ka edhe vëllim më të vogël të ngarkesës për administrim. Megjithatë, ky opsion ka edhe mungesa. Duke pasur parasysh se mekanizmi për dhënien e OIP akoma nuk funksionon në praktikë, ndërsa kriteri për lartësinë minimale të buxhetit vjetor prej 1.500 euro, nuk e plotësojnë shumica e organizatave, Ligji do të përjashtonte numër të madh të shoqatave dhe fondacioneve. Rishtas paraqitet problemi i trajtimit të klubeve sportive dhe subjekteve të cilat nuk ekzistojnë definicione për organizatat me status me interes publik. Në këtë mënyrë Ligji nuk ka kryer ndikim afatgjatë mbi filantropinë në nivel lokal. Në rast të këtij opsioni sigurisht do të nevojitet të bëhen ndryshime në kriteret për OIP në kuadër të LSHF.

► *Opsioni 2*

Pranuesit ti përfshijnë të gjitha subjektet me karakter jofitimprurës. Në këtë rast interesi publik do të vërtetohet me procedurë të dyfishtë. Për ata marrës të cilët kanë status të përhershëm të vërtetuar të interesit publik, trajtimi do të ishte i njëjtë si te Opsioni 1. Për marrësit të cilët kanë status të këtillë, procedurën do ta zbatonte marrësi, gjegjësisht marrësi do të kërkonte mendim për interesin publik për projektin/aktivitetin konkret (e jo për donacionin). Vendimin do ta jepte Ministria e Drejtësisë (nëse është e nevojshme në bazë të kritereve të përgatitura nga ministritë resor). Në mënyrë plotësuese do të vërtetohet dokumentacioni i nevojshëm shoqërues për projektin që marrësi do të duhej ta parashtrojë deri te organet kompetente. Ministritë resor do të mund të angazhohen për përgatitjen e kritereve adekuate për vërtetimin e interesit publik në fushën individuale, të cilat do të pasonin nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, nëse kjo është e nevojshme.

Me këtë opshion arrihet thjeshtëzimi i procedurës lidhur me zgjidhjen ekzistuese ligjore pasi që do të zvogëlohet vëllimi i kërkesave dhe vëllimi i përfshirjes së administratës. Gjithashtu, në këtë mënyrë mundësohet përfshirje më e gjerë e marrësve që është e rëndësishme për nxitjen e filantropisë dhe demokracisë në nivel lokal. Mungesa e këtij opsioni është se me atë në mënyrë të dukshme do të shkarkohet marrësi, i cili do të duhet ta parashtrojë dokumentacionin adekuat. Kjo do të mund të paraqiste sfidë për organizatat më të vogla.

► *Opsioni 3*

Ky opshion është i ngjashëm në përfshirjen si Opsioni 2. Dallimi qëndron në institucionet kompetente, të cilat do ta caktonin interesin publik të projektit/aktivitetit të parashtruar. Ky opshion do të përfshinte si edhe deri më tani dhënien e mendimit nga ana e të gjitha ministrive resor. Është i mundur opsioni edhe për formimin e trupit punues ndër sektorial që do ta jepte mendimin.

Me këtë opshion do të arrihet procedurë e lehtësuar nga aspekti i numrit të kërkesave. Ajo gjithashtu mundëson përfshirje më të gjerë të marrësve. Por, nga ana tjetër sjell deri te ngarkesa e rritur e administratës dhe prolongimi i procedurës, e cila edhe deri më tani nuk përputhej me nevojat praktike për dhurim. Gjithashtu, qasja e këtillë shkakton trajtim të ndryshëm ndaj marrësve të ndryshëm në kuadër të ligjit të njëjtë varësisht nga ministria resor, ku bie veprimtaria e tyre.

Duke pasur parasysh rrethanat momentale, Opsioni 2 duket si më i marrëshëm në drejtim të përmbushjes së parimeve të kërkuara. Në të tre opsionet, edhe marrësi edhe DHP do të kenë ex-ante vërtetim të dokumentuar për interes publik.

Lidhur me dokumentacionin e obligueshëm që kërkohet nga kërkuesit dhe marrësit për realizimin e nxitjeve tatimore rekomandohet për donacione të vogla me vlerë deri 200 euro, të përjashtohet lidhja e obligueshme e marrëveshjes në rast kur dhënësi është person fizik. Në raste të këtilla mjafton që dhënësi të fitojë Vërtetim për donacion të pranuar. Pasi që në pjesën më të madhe personat fizik janë dhënës

të donacioneve të vogla⁸³ kjo në mënyrë të dukshme do ta thjeshtonte procedurën për ata, me çka do t'u mundësojë të kenë dobi nga lehtësimet tatimore.

6.3. NIVELI I NXITJEVE TATIMORE DHE ZBATIMI I TYRE NË PRAKTIKË

Rekomandimet lidhur me nxitjet konkrete tatimore janë grupuar lidhur me: 1) ndryshimet në ligj që të mundësohet aplikimi i tyre i plotë dhe 2) zgjidhje të mundshme për ndryshime në vetë nxitjet tatimore për stimulimin më të madh të dhënësve.

1. *Rekomandime për mundësimin e aplikimit të plotë të nxitjeve ekzistuese tatimore*

Nga ky aspekt sfida më e madhe ekziston te *lirimi nga TAP* kur dhënësit janë persona fizik dhe është e domosdoshme të mundësohet efektimi i kësaj nxitjeje tatimore për të gjitha personat fizik, të ardhurat e të cilëve i nënshtrohen tatimit me këtë tatim. Kjo veçanërisht nga aspekti që thelbi i vërtetë i filantropisë qëndron në dhurimin nga ana e personave fizik dhe nevojitet atë të nxiten me të vërtetë përmes lehtësimeve tatimore, që sjell deri te ndryshimi afatgjatë i vetëdijes ndaj dhurimit në interesin publik.

Në këtë drejtim nevojitet të revidohet neni 13 me çka termi “borxhi tatimor vjetor” do të rrimërohet në “tatimi personal i të ardhurave vjetor” që përputhet me terminologjinë e ligjit adekuat dhe është në pajtim me parimin e kredisë tatimore. Gjithashtu, nevojitet të ndryshohet formulari i fletëparaqitjes tatimore vjetore për shumën e dhuruar në veprimtaritë publike që ta trajtojë si kredi tatimore. Rishtas, është mirë të shqyrtohet mënyra e realizimit të lirimit tatimor, gjegjësisht e njëjta të trajtohet si “parapagesë tatimore” dhe pas përpunimit të TPA-FTV t'i kthehet dhënësit përmes pagesës në llogarinë e transaksionit. Në këtë mënyrë pagesa paradhënie e TPA nuk paraqet problem të madh. Njëkohësisht, edhe personat të cilët kanë të ardhura vetëm në bazë të ardhurave personale do të mund (nëse dëshirojnë ta gëzojnë nxitjen tatimore) të parashtrojnë TPA-FTV dhe me këtë ta realizojnë lirimin.

83 Në hulumtimin e Konekt nga viti 2009, vetëm 0.7% të anketuarve kanë deklaruar se dhurojnë më shumë se 10.000 denarë në vjet.

Te Tatimi në fitim, duhet të shtohet alineja në të cilën do të potencohet se donacionet të cilat i japin fondacionet dhe shoqatat si pjesë e funksioneve të tyre primare programore nuk i nënshtrohen tatimit në fitim.

Lidhur me TVSH-në, nga aspekti i tele-donacioneve duke pasur parasysh se nuk bëhet fjalë për pengesë ligjore, nevojitet të realizohet bashkëpunimi me kompanitë tele-komunikuese që të gjendet zgjidhje softueri, të cilat do të mundësojnë lirimin nga TVSH-ja dhe te pri-pejd kartelat.

Te tatimi i pronës nevojitet që të saktësohet mundësia Ligji ti përfshijë trashëgiminë (duke pasur parasysh se ato nuk kanë trajtim të donacionit), ndërsa neni duhet të revidohet që të harmonizohet me ligjin resor, i cili e trajton këtë çështje.

Krahas dispozitave të drejtpërdrejta në ligj, për përcjelljen adekuate të ndikimit të Ligjit nevojitet të revidohen formularët për evidencën shtetërore për subjektet (Formulari “DE”) që inkuadrojnë informatë adekuate dhe të hollësishme për nivelin e donacioneve dhe sponsorimeve të dhuruara dhe të pranuara.

2. Rekomandime për zgjidhjet e mundshme për ndryshime në vetë nxitjet tatimore për stimulimin më të madh të dhënësve

Përvojat krahasuese nga vendet tjera tregojnë se nuk ka zgjidhje të vetme për nxitjet tatimore. Në çdo vend varen nga politika tatimore, nga nevojat për dhurim/sponsorizim, si dhe nga shkalla e zhvillimit të filantropisë.

Në këtë drejtim, lidhur me **tatimin personal në fitim** duhet të mendohet për mënyrat në të cilat do të nxitje dhurimi më i madh nga ana e personave fizik me të ardhura të rritura. Në të vërtetë, kufizimet ekzistuese prej 24.000 denarë është nxitja adekuate te personat fizik të cilët kanë më pak se ose rreth 1.080.000 denarë neto të ardhura në vjet (ose 90.000 denarë neto të ardhura në muaj). Megjithatë, kufizimi i këtillë prej 24.000 denarë nuk i stimulon personat fizik me të ardhura më të larta, të cilët janë ata të cilët dukshëm do t[ë investojnë në zhvillimin e shoqërisë.

Zgjidhjet e reviduara do të mund të parashohin: a) rritjen e kufizimeve; 2) heqjen e kufizimeve, ndërsa zvogëlimi i shumës prej 20% që të shmanget intervenim më i madh nga Buxheti ose c) vendosja e kufizimeve të përqindjes nga donacioni, i cili mund të zbritet nga tatimi (siç është rasti në Francë ku gjithashtu ekziston kredia tatimore si të ardhura).

Lidhur me nxitjen tatimore të **tatimi në fitim** palët e prekura kanë mendime të ndryshme. Mbisundon mendimi se duke marrë parasysh se ekzistojnë lirime të mëdha tatimore nga tatimi në fitim dhe kur mjetet shfrytëzohen për biznes qëllime, në të njëjtën kohë shkalla tatimore është e ulët, se kjo nxitje tatimore nuk është motivi kryesor që të shqyrtohen opsionet dhe kombinimi i ndryshëm i nxitjeve (në pajtim me shembujt e përmendur në Kapitullin IV), të cilët do të mundësojnë stimulimin më të madh të donacioneve dhe sponsorimeve nga sektori afarist.

6.4. EVIDENTIMI, RAPORTIMI DHE KONTROLLI

Sistemi i evidencës, përcjelljes dhe kontrollit duhet të revidohet si nga aspekti i qëllimeve, ashtu edhe nga aspekti i organeve kompetente. Gjatë kësaj duhet të mbahet llogari për parimet që vijnë:

- » Dhuruesit dhurojnë me vullnet të mirë, për të mirën publike dhe nuk kanë kontroll, e as duhej të llogariten si llogaridhënës për mënyrën se si shfrytëzohet;
- » Duke pasur parasysh se dhënësit i gëzojnë beneficionet tatimore, DHP është e obliguar të zbatojë përcjellje adekuate të dhurimeve (donacion ose sponsorizim) në interesin publik;
- » Zvogëlimi i ngarkesës administrative për raportimin në drejtim të efikasitetit të rritur;
- » Vendosja e raportimit adekuat nga ana e marrësit për shfrytëzimin e donacionit/sponsorizimit;
- » Shfrytëzimi i sistemit administrativ për përcjellje të efekteve nga ligji.

Lidhur me *evidencën*, rekomandohet krijimi i një regjistri, i cili do të përmbajë informata për: 1) marrësit e donacioneve/sponsorimeve me status të interesit publik dhe 2) projekteve/aktiviteteve për të cilat është

dhënë vendim për interes publik. Në këtë mënyrë dhënësit rrjedhimisht do të mund të informohen për atë nëse donacioni/sponsorizimi do ta gëzojë beneficinin tatimor. Nga ana tjetër kjo do të mundësojë edhe pasqyrë më të mirë nga ana e DHP dhe zvogëlimin e vëllimit të dokumentacionit që dhënësit dhe marrësit duhet ta parashtrojnë me raportin.

Në drejtim të rekomandimeve të përgjithshme, *sistemi për raportim* duhet të thjeshtohet dhe të lidhet me parashtrimin e bilanceve vjetore dhe fletëparaqitjeve tatimore vjetor. Cilido raport ose dokumentacion lidhur me donacionin/sponsorizimin duhet të jenë pjesë shoqëruese e dokumentacionit të kontabilitetit dhe të parashtruar deri te DHP bashkë me llogarinë përfundimtare. Në drejtim të zvogëlimit plotësues të dokumenteve të prodhuara do të mund të mendohej për vendosjen e formularit për raportim integral për të gjitha donacionet dhe sponsorimet te një dhënës ose marrës. Gjatë kësaj, raportimi nga ana e marrësve duhet të mundësojë grumbullimin e të dhënave për lartësinë e donacioneve të fituara dhe lartësinë e sponsorimeve të fituara të cilat i nënshtrohen nxitjeve tatimore të ndara sipas tipit të dhënësit (personi fizik ose juridik dhe tipi i personit juridik) dhe sipas veprimtarisë publike. Kjo edhe DHP-së do t'i mundësojë pasqyrë integrale të çdo dhënës dhe marrës (në vend ata ta azhurnojnë çdo raport veçmas).

Marrëveshja për donacion/sponsorizim dhe Vërtetimi për donacionin/sponsorizimin e pranuar do të mbeten dokumente primare, të cilat do të parashtrohen me llogarinë përfundimtare. Pranuesit do të kenë përgjegjësi më të madhe për raportim për shfrytëzimin e donacioneve dhe sponsorimeve përmes raporteve publikisht të kapshme për aktivitetet dhe shpenzimet e realizuara. Ndaj llogarisë përfundimtare marrësit do të parashtrojnë edhe dokumentacionin e kontabilitetit për shpenzimet e bëra nga shfrytëzimi i donacionit ose sponsorizimit.

Nevojitet që të saktësohet roli i DHP në *kontrollin e shfrytëzimit të donacioneve/sponsorimeve* të cilat gëzojnë beneficione tatimore. Krahas kësaj, nevojitet të saktësohet cilat janë “organet tjera kompetente” për kontroll, krahas DHP.

Dispozitat kundërvajtës duhet të revidohen tërësisht që të përputhen me dispozitat tjera nga ligji. Ato duhet ta ruajnë parimin e ngarkimit të

marrësit për parregullsitë e mundshme të vërtetuara në shfrytëzimin e donacionit ose sponsorizimit.

Me aplikimin e frymës së rekomandimeve të dhëna në këtë dokument do të mundësohet aplikimi më i thjeshtë i Ligjit, dhe në të njëjtën kohë edhe do ta nxisin kulturën e dhurimit në vendin tonë. Gjithashtu do ta afrojnë Ligjin deri te praktikat më të mira rregulluese evropiane në këtë tip të beneficioneve.



ANEKSI 1 – LIGJI PËR DONACIONE DHE SPONSORIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE

LIGJI PËR DONACIONE DHE PËR SPONSORIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE

Gazeta zyrtare nr. 47 nga 12.04.2006

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet dhënia dhe marrja e donacioneve dhe sponsorimeve me të cilat dhënësi dhe marrësi mund të kërkojnë nxitje tatimore, qëllimi i dhënies dhe marrjes, dhënësit dhe marrësit, lënda, shfrytëzimi, nxitjet tatimore dhe evidentimi e kontrolli i donacioneve dhe sponsorimeve në veprimtaritë publike.

Neni 2

Me donacionin dhe sponsorimin në veprimtaritë publike me të cilat realizohet interesi publik, kontribuohet për përmirësimin e jetës personale dhe të përbashkët të qytetarëve, shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve, personave fizikë e juridikë në Republikën e Maqedonisë, si dhe për mirëqenien e tyre ekonomike dhe të drejtën sociale.

Fjalori i termeve

Neni 3

Nocionet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin si vijon:

- 1. Donacion** është ndihma vullnetare dhe pa kusht me para, të mira dhe shërbime, i cili nuk krijon dobi të drejtpërdrejtë për dhënësin, as obligim kthimi nga marrësi i donacionit, dhe i cili mund të jepet për qëllime me interes publik ose për përkrahjen e aktiviteteve të marrësit. Me donacion sipas këtij ligji nënkuptohen edhe dhëniet rrjedhëse, tele-dhëniet dhe ngjarjet e organizuara për grumbullimin e mjeteve;

2. **Sponsorim** është pagesa vullnetare financiare, dhënia e të mirave ose shërbimeve për projekt dhe/ose aktivitet konkret, që i mundësojnë dobi të drejtpërdrejtë dhënësit, siç janë promovimi i emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse të dhënësit të sponsorimit;
3. **Veprimtari publike** është veprimtaria në sferën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe qytetarit, arsimit, shkencës, zhvillimit të shoqërisë informatike dhe bartjes së të dhënave elektronike, kulturës, sportit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, mbrojtjes së personave me invaliditet, dhënësve vullnetarë të gjakut, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe veprimtarive të tjera të përcaktuara me ligj si veprimtari publike;
4. **Interes publik** është përkrahja ose promovimi i veprimtarive në sferën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, promovimit të kulturës, etikës, arsimit, shkencës, zhvillimit të shoqërisë informatike dhe bartjes së të dhënave elektronike, sportit, mbrojtjes së mjedisit jetësor, veprimtarive socio-humanitare, zhvillimit të shoqërisë qytetare, promovimit të dhënies vullnetare të gjakut, promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe veprimtarive të tjera të përcaktuara me ligj;
5. **Person fizik i vendit** është qytetari i Republikës së Maqedonisë, detyrues tatimor;
6. **Person fizik i huaj** është personi shtetas i huaj, refugjat ose apatrid që qëndron në Republikën e Maqedonisë ose që jeton në shtet tjetër;
7. **Person juridik i vendit** konsiderohen institucioni publik, njësia e pushtetit lokal, shoqata e qytetarëve dhe fondacionet me interes publik, shoqëritë tregtare, organi i administratës shtetërore dhe subjekt tjetër, i cili me regjistrim në organin kompetent ka fituar cilësinë e personit juridik;
8. **Person juridik i huaj** është secili person juridik që ka firmë të regjistruar në regjistrin tregtar në vend të huaj, ose nëse është i regjistruar në regjistrin tregtar të vendit të tij, dhe organizatat ndërkombëtare joqeveritare të huaja, fondacionet, lidhjet dhe degët e tyre që janë jofitimprurëse; dhe
9. **Promovim** është paraqitja afirmative e emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse të dhënësit të donacionit dhe sponsorimit, gjatë dhënies së donacionit dhe sponsorimit për kryerjen e veprimtarisë publike.

Neni 4

- (1) Dhënësi dhe marrësi i donacionit dhe sponsorimit lidhin marrëveshje me shkrim sipas Ligjit për marrëdhëniet obligative.
- (2) Lëndë e marrëveshjes nga paragrafi (1) i këtij neni, doemos duhet të jetë realizimi i interesit publik të përcaktuar me nenin 3, pika 4 e këtij ligji.
- (3) Për donacionet nga neni 3, pika 1, paragrafi 2 i këtij ligji, më kërkesën e dhënësit, marrësi i lëshon vërtetim me shkrim.
- (4) Formën dhe mënyrën e lëshimit të vërtetimit me shkrim nga paragrafi (3) i këtij neni, i rregullon ministri i Drejtësisë me rregullore me të cilën rregullohet kjo materie.

Neni 5

Ligjet e tjera mund të rregullojnë çështje për donacionin dhe sponsorimin, por zbatohen dispozitat e këtij ligji për të gjitha çështjet që nuk rregullohen me ato ligje.

II. ELEMENTE TË DONACIONIT DHE SPONSORIMIT

1. Dhënësi i donacionit dhe sponsorimit

Neni 6

- (1) Dhënësi i donacionit dhe sponsorimit mund të jetë personi fizik e juridik i vendit dhe i huaj.
- (2) Dhënësi i donacionit dhe sponsorimit nuk mund të jetë personi fizik e juridik, veprimi i të cilit nuk është në pajtim me Kushtetutën, ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat Republika e Maqedonisë i ka lidhur ose të cilave u është bashkëngjitur.

2. Marrësi i donacionit

Neni 7

- (1) Marrësi i donacionit mund të jetë personi juridik i vendit.
- (2) Si marrësi i donacionit mund të jetë edhe personi juridik i huaj që ka karakter jofitimprurës për realizimin e interesit publik në shtetin tjetër në rastet e fatkeqësive elementare, katastrofave natyrore e humanitare.
- (3) Marrësi i donacionit bëhet pronar i donacionit dhe e shfrytëzon ekskluzivisht për dedikimin e përcaktuar në marrëveshjen për donacion, nga neni 4 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

(4) Shpallja e emrit të dhënësit të donacionit në raportet periodike e vjetore, si dhe në raportet për shfrytëzimin e donacionit dhe në promovimin publik të donatorit, nuk e ndryshon trajtimin tatimor të donacionit.

3. Marrësi i sponsorimit

Neni 8

(1) Marrës i sponsorimit mund të jetë personi juridik i vendit, i cili në bazë të sponsorimit të marrë i kryen obligimet që dalin nga marrëveshja e sponsorimit.

(2) Të drejtat dhe obligimet e marrëveshjes për sponsorim, doemos duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Republika e Maqedonisë i ka lidhur ose të cilave u është bashkëngjitur.

Neni 9

Shpallja e emrit, firmës dhe shenjës mbrojtëse të dhënësit të donacionit dhe sponsorimit në mediat publike, të shtypit dhe elektronike nuk konsiderohet si reklamë.

4. Lënda e donacionit dhe sponsorimit

Neni 10

(1) Lëndë të donacionit dhe sponsorimit janë:

- mjetet financiare;
- çdo lloj i të mirave dhe shërbimeve, duke përfshirë edhe të mirat materiale të prodhuara vet ose të blera; dhe
- testamentet dhe të drejta të tjera që barten.

(2) Lënda e donacionit dhe sponsorimit doemos duhet të jetë në pajtim me veprimtarinë e marrësit të donacionit dhe sponsorim

(3) Lëndë e donacionit dhe sponsorimit nuk mund të jenë të mirat dhe shërbimet qarkullimi i të cilave ndalohe me ligj.

5. Qëllimet e donacionit dhe sponsorimit

Neni 11

(1) Qëllim i donacionit dhe sponsorimit është realizimi, përparimi, promovimi dhe përkrahja e veprimtarive me interes publik.

(2) Donacioni i jepet marrësit të donacionit me qëllim që të plotësohen qëllimet e nevojat e tij të deklaruara, të përcaktuara publikisht dhe/ose të zgjidhen situatat e problemet e caktuara.

(3) Sponsorimi i jepet marrësit të sponsorimit për implementimin e interesit publik nga një veprimtari e caktuar publike, të definuar në marrëveshjen për sponsorim.

III. NXITJET TATIMORE TË DONACIONEVE DHE SPONSORIMEVE

1. Shfrytëzuesit e nxitjeve tatimore

Neni 12

Dhënësi dhe pranuesi i donacionit dhe sponsorimit kanë të drejtë në nxitje tatimore të parapara me këtë ligj.

2. Nxitjet tatimore në tatimin personal mbi të ardhurat

Neni 13

(1) Personi fizik i cili i dhuron mjete financiare personit juridik sipas dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë në zvogëlimin e tatimit personal mbi të ardhurat të përcaktuara në bazë të fletëparaqitjes së tij tatimore vjetore (formulari “PDD-GDP”) në lartësi prej 20% nga borxhi tatimor vjetor i dhënësit të donacionit, por jo më shumë se 24.000 denarë.

(2) Tatimi personal mbi të ardhurat nuk paguhet për të ardhurat në bazë të donacioneve të pranuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

3. Nxitjet tatimore të tatimi mbi fitimin

Neni 14

(1) Obliguesit tatimorë të tatimit mbi fitimin, shuma e donacionit të dhënë gjatë vitit në vijim, sipas dispozitave të këtij ligji i pranohet si shpenzime në bilancin tatimor në shumën e përgjithshme prej 5% nga të ardhurat e përgjithshme.

(2) Obliguesit tatimor të tatimit mbi fitimin, shuma e donacionit të dhënë gjatë vitit në vijim, sipas dispozitave të këtij ligji i pranohen si shpenzime mbi bilancin tatimor në shumën e përgjithshme prej 3% nga të ardhurat e përgjithshme.

4. Nxitjet tatimore të tatimi mbi vlerën e shtuar

Neni 15

(1) Qarkullimi i kryer për realizimin e donacionit, sipas këtij ligji, konsiderohet si qarkullim në pajtim me nenin 3 paragrafi (3) pikat 1 dhe 2 dhe neni 6 paragrafi (3) pikat 1 dhe 2 nga Ligji për tatimin mbi vlerën e

shtuar. Sigurimi i mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë bëhet në të njëjtën mënyrë si te qarkullimi i bërë për realizimin e donacioneve të huaja për financimin e projekteve për të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka lidhur marrëveshje.

(2) Te kompensimet për bileta hyrëse për ngjarjet kulturore, sportive ose ngjarje tjetër publike nuk llogaritet tatim mbi vlerën e shtuar, pa përjashtimin e të drejtës së tatimit paraprak, nëse të ardhurat e përgjithshme janë dedikuar dhe përdoren për financimin e aktiviteteve me interes publik në veprimtaritë nga neni 3, pika 4 nga ky ligj.

(3) Kompensimi për shërbimin e komunikacionit në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike kur shfrytëzuesi me shfrytëzimin e saj dhuron mjete financiare për financimin e aktivitetit me interes publik në veprimtaritë e këtij ligji, nuk llogaritet tatim mbi vlerën e shtuar, pa përjashtimin e të drejtës së tatimit paraprak.

(4) Për zbatimin e këtij neni ministri i Financave miraton rregullore në afat prej 60 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij ligji..

5. Nxitjet tatimore te tatimi mbi pronën

Neni 16

(1) Donacioni në lëndë dhe të mira materiale lirohet nga tatimi i trashëgimisë dhe dhuratës kur dhënësi ia bart të drejtën për gëzimin dhe shfrytëzimin pranuesit.

(2) Donacioni në lëndë dhe të mira materiale lirohet nga tatim i pronës gjatë 5 vjetëve të ardhshme, pas vitit që është dhënë donacioni.

Neni 17

(1) Personit të huaj juridik dhe fizik, me kërkesë të tij, Drejtoria për të hyra publike (në tekstin e mëtejme: DHP) i jep dokument me të cilin vërtetohet se ka dhuruar ose sponsoruar në veprimtari me interes publik në Republikën e Maqedonisë.

(2) Dokumenti nga paragrafi (1) i këtij neni lëshohet me qëllim që dhënësi i donacionit dhe sponsorimit të marrë nxitje tatimore për tatimin mbi vlerën e shtuar në vendin e tij.

6. Përjashtimi nga nxitjet tatimore

Neni 18

Nxitjet tatimore nuk mund të realizohen kur donacioni dhe sponsorimi përdoren për:

- 1) aktivitete të pranuesit drejtuar përkrahjes së partive politike dhe fushatave partiake; dhe
- 2) dhënien nga një sipërmarrje një sipërmarrjes tjetër.

IV. EVIDENTIMI, LLOGARIDHËNIA DHE KONTROLLI

1. Informimi për shfrytëzimin e donacionit dhe sponsorimit

Neni 19

- (1) Dhënësi dhe pranuesi i donacionit dhe sponsorimit janë të detyruar të përgatisin raport për donacionin dhe sponsorimin e dhënë dhe atë të pranuar i cili duhet të përmbajë të dhënat vijuese:
 - 1) emrin dhe emërtimin e dhënësit dhe të pranuesit;
 - 2) emrin dhe emërtimin e shfrytëzuesit të fundit;
 - 3) përshkrimin e lëndës së donacionit dhe sponsorimit që mundëson identifikimin e tyre me emërtimin e sasisë, vlerës dhe veçorive tjera të saja;
 - 4) përdorimin e fundit të lëndës së donacionit dhe sponsorimit; dhe
 - 5) të dhëna tjera.
- (2) Marrëveshja për donacion dhe sponsorim nga neni 4 i këtij ligji dhe raporti nga paragrafi (1) i këtij neni në mënyrë të detyrueshme paraqitet në DHP nëse me këtë ligj për ato janë paraparë nxitje tatimore, më së voni 30 ditë nga dita e plotësimit të marrëveshjes.
- (3) Marrëveshja për donacion dhe sponsorim, si dhe çdo dokumentacion tjetër që është e lidhur me donacionin dhe sponsorimin, detyrimisht duhet të ruhet së paku 5 vjet nga mbarimi i vitit kalendarik në të cilin është plotësuar obligimi i përgjegjësisë.

2. Kontrolli i shfrytëzimit të donacionit dhe sponsorimit

Neni 20

- (1) DHP dhe organet tjera kompetente e kontrollojnë dhënien, pranimin dhe shfrytëzimin e donacionit dhe sponsorimit në rast të zbatimit të nxitjeve tatimore në pajtim me këtë ligj.
- (2) NHP dhe organet tjera kompetente, nëse gjatë kontrollit konstatojnë parregullsi dhe keqpërdorime gjatë shfrytëzimit të donacionit dhe sponsorimit, paraqesin fletëdenoncim kundërvajtës dhe penal.

3. Mbrojtja e interesit publik

Neni 21

(1) Me kërkesë të dhënësit të donacionit dhe sponsorimit, Ministria e Drejtësisë në pajtim me ministrinë përkatëse në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, merr aktvendim me të cilin e përcakton interesin publik për donacionin dhe sponsorimin e paraparë.

(2) Ministria e Drejtësisë në afatin e paraparë në paragrafin (1) të këtij neni, kërkon mendim për çdo kërkesë veç e veç në bazë të kompetencave nga organet përkatëse, si bazë për vendosje sipas kërkesës.

(3) Nëse në afatin e paraparë në paragrafin (1) të këtij neni Ministria e Drejtësisë nuk merr aktvendim, do të konsiderohet se kërkesa është zgjidhur pozitivisht.

Neni 22

(1) Nëse donacioni dhe sponsorimi nuk kanë karakter të donacionit dhe sponsorimit me interes publik, DAP merr aktvendim me të cilin anulohet e drejta e nxitjeve tatimore dhe ia dërgon kundërvajtësit (dhënësit dhe/ose pranuesit të donacionit dhe sponsorimit).

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni kundërvajtësi ka të drejtë ankese në Komisionin kompetent të shkallës së dytë pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

V. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 23

(1) Me dënim me para prej 50. 000 deri 300. 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik - pranuesi i donacionit dhe sponsorimit, nëse nuk lidh marrëveshje në formë të shkruar (neni 4).

(2) Me dënim në para prej 50. 000 deri 300. 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik - pranuesi i donacionit dhe sponsorimit, nëse nuk ka përgatitur raport

për donacionin e dhënë dhe për donacionin e marrë (neni 17 paragrafi (1)).

(3) Për kundërvajtjen nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni me dënim me para prej 10. 000 deri 50. 000 denarë do të dënohet personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 24

(1) Me dënim me para prej 50 000 deri 300 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik - pranuesi i donacionit dhe sponsorimit, nëse nuk i shfrytëzon në pajtim me marrëveshjen, ndërsa lënda e donacionit dhe sponsorimit I kthehet dhënësit të donacionit dhe sponsorimit (neni 7 paragrafi (3) dhe neni 8 paragrafi (1).

(2) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni me dënim me para prej 10. 000 deri 50. 000 denarë do të dënohet personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 25

(1) Me dënim me para prej 50. 000 deri 300. 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik - pranuesi i donacionit dhe sponsorimit, nëse marrëveshja dhe dokumentacioni tjetër nuk ruhen së paku 5 vjet. (neni 19 paragrafi 3).

(2) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni me dënim me para prej 10. 000 deri 50. 000 denarë do të dënohet personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 26

Me dënim me para prej 10. 000 deri 50. 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi fizik për mosrespektimin e dispozitave nga neni 4, neni 7 paragrafi (3), neni 8 paragrafi (1), neni 17 paragrafi (1) dhe neni 19 paragrafi (3) të këtij ligji.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 27

Për zbatimin e këtij ligji kompetente është Ministria e Drejtësisë..

Neni 28

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të zbatohet prej 1 janari 2007.

LIGJ PËR NDRYSHIME TË LIGJIT PËR DONACIONE DHE SPONSORIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE

Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë nr. 86/08
nga data 14.07.2008

Neni 1

Në Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 47/2006) emri i kapitullit V. “DISPOZITAT NDËSHKUESE” ndryshohet në: V. “DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE”.

Neni 2

Në nenin 23 alineja 1 fjalët: “Me dënim me të holla prej 50.000 deri 300.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje”, zëvendësohet me fjalët “Gjobë në vlerë prej 1.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje do të shqiptohet”.

Në alinenë 2 fjalët: “Me dënim me të holla prej 50.000 deri 300.000 denarë do të dënohet edhe” zëvendësohen me fjalët “Gjobë në vlerë prej 1.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do të shqiptohet”.

Në alinenë 3 fjalët: “dënim me të holla prej 10.000 deri 50.000 denarë do të dënohet” zëvendësohen me fjalët: “Gjobë në vlerë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë do të shqiptohet”.

Neni 3

Në nenin 24 alineja 1 fjalët: “Me dënim me të holla prej 50.000 deri 300.000 denarë do të dënohet” zëvendësohet me fjalët: “Gjobë në vlerë prej 1.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet”.

Në alinenë 2 fjalët “me dënim me të holla prej 10.000 deri 50.000 denarë do të dënohet” zëvendësohen me fjalët: “Gjobë në vlerë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet”.

Neni 4

Në nenin 25 alineja 1 fjalët: “Me dënim me të holla prej 50.000 deri 300.000 denarë do të dënohet” zëvendësohen me fjalët: “Gjobë në vlerë prej 1.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet”.

Në alinenë 2 fjalët “me dënim me të holla prej 10.000 deri 50.000 denarë do të dënohet” zëvendësohen me fjalët: “Gjobë në vlerë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet”.

Neni 5

Në nenin 26 fjalët: “Me dënim me të holla prej 50.000 deri 300.000 denarë do të dënohet” zëvendësohen me fjalët: “Gjobë në vlerë prej 1.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

LIGJI PËR NDRYSHIME TË LIGJIT PËR DONACIONE DHE SPONSORIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE

Gazeta zyrtar e R. Maqedonisë, nr. 51 nga data 13.04.2011

Neni 1

Në Ligjin për donacione dhe për sponsorime në veprimtaritë publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 47/2006 dhe 86/2008), neni 21 ndryshon dhe thotë: “

(1) Me kërkesë për vërtetimin e interesit publik të parashtruar nga dhënësi i donacionit, gjegjësisht sponsorimi në pajtim me alinenë (8) nga ky nen, Ministria e Drejtësisë sjell vendim me të cilin vërtetohet interesi publik i donacionit ose sponsorimit të dhënë.

(2) Nda kërkesës nga alineja (1) i këtij neni parashtrohet Marrëveshja për donacion, gjegjësisht sponsorim.

(3) Kërkesa nga alineja (1) i këtij neni parashtrohet në dy formularë identik me ankese të dëshmisë.

(4) Ministria e Drejtësisë është e obliguar më afat prej pesë ditëve nga pranimi i kërkesës nga alineja (1) e këtij neni të kërkojë mendim për çdo kërkesë individuale në bazë të kompetencave nga organet kompetente, i cili mendim është bazë për vendosjen rreth kërkesës nga alineja (1) i këtij neni.

(5) Organet kompetente nga alineja (4) i këtij neni janë të obliguara ta dorëzojnë mendimin deri te Ministria e Drejtësisë në afat prej dhjetë ditëve nga pranimi i kërkesës.

(6) Ministria e Drejtësisë në afat prej 15 ditëve nga pranimi i mendimit nga alineja (5) i këtij neni jep vendim, me të cilin vërtetohet ose nuk vërtetohet interesi publik për donacionin ose sponsorimin e dhënë.

(7) Nëse Ministria e Drejtësisë nuk sjell vendim me të cilin e vërteton ose nuk e vërteton interesin publik në afatin nga alineja (6) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në afat prej tri ditë pune të parashtrojë kërkesë deri te arkivi i ministrit të Drejtësisë dhe ministri i Drejtësisë të sjell vendim. Nëse ministri i Drejtësisë nuk ka arkiv, kërkesa parashtrohet deri në arkivin e selisë së Ministrisë së Drejtësisë.

(8) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga alinetë (1) dhe (7) të këtij neni i cakton ministri i Drejtësisë.

(9) Ndaj kërkesës nga alineja (7) të këtij neni parashtruesi i kërkesës parashtron edhe kopje nga kërkesa nga alineja (1) të këtij neni.

(10) Ministri i Drejtësisë është i obliguar në afat prej pesë ditë pune nga dita e parashtrimit të kërkesës nga alineja (7) të këtij neni deri te arkivi i ministrit të Drejtësisë, të sjell vendim me të cilin kërkesa nga alineja (7) e këtij neni është miratuar ose refuzuar. Nëse ministri i Drejtësisë nuk ka arkiv, kërkesa parashtrohet deri te arkivi i selisë së Ministrisë së Drejtësisë.

(11) Nëse ministri i Drejtësisë nuk sjell vendim në afatin nga alineja (10) e këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta lajmërojë Inspektoratin administrues shtetëror në afat prej pesë ditëve pune.

(12) Inspektorati administrues shtetëror është i obliguar në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit nga alineja (1) të këtij neni të kryejë mbikëqyrje në Ministrinë e Drejtësisë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tre ditëve pune nga mbikëqyrja e kryer ta lajmërojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Inspektori nga Inspektorati administrues shtetëror pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin sjell vendim me të cilin e obligon ministrin e Drejtësisë që në afat prej dhjetë ditëve të vendos rreth kërkesës së parashtruar, gjegjësisht ta miratojë ose ta refuzojë kërkesën dhe ta lajmërojë inspektorin për aktin e sjellë. Me lajmërimin parashtrohet edhe kopje nga akti me të cilin është vendosur rreth kërkesës së parashtruar.

(14) Nëse ministri i Drejtësisë nuk vendos në afatin nga alineja (13) e këtij neni, inspektori do të parashtrojë kërkesë për nisjen e procedurës kundërvajtës për kundërvajtje të caktuar në Ligjin për inspektim administrues dhe do të caktohet afat plotësues prej pesë ditëve pune, ku ministri i Drejtësisë do të vendos rreth kërkesës së parashtruar, për çka në afatin e njëjtë do ta lajmërojë inspektorin për aktin e sjellë. Me lajmërimin parashtrohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur rreth kërkesës së parashtruar. Inspektori në afat prej tre ditëve pune do ta lajmërojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse ministri i Drejtësisë nuk vendos edhe në afatin plotësues nga alineja (14) e këtij neni, inspektori në afat prej tre ditëve pune do të parashtrojë kallëzim deri te prokurori kompetent publik dhe në atë afat do ta lajmërojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(16) Nëse inspektorati nuk vepron pas lajmërimit nga alineja (12) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve pune ka të drejtë të parashtrojë ankesë deri te arkivi i drejtorisë së Inspektoratit administrues shtetëror. Nëse drejtori nuk ka arkiv, kërkesa parashtrohet në arkivin e selisë së Inspektoratit administrues shtetëror.

(17) Drejtori i Inspektoratit administrues shtetëror është i obliguar në afat prej tre ditëve pune ta shqyrtojë ankesën nga alineja (16) i këtij neni, dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar pas lajmërimit nga parashtruesi i kërkesës në pajtim me alinetë (12) dhe (13) dhe/ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me alinetë (14) dhe (15) nga ky nen, drejtori i Inspektoratit administrues shtetëror do të parashtrojë kërkesë për nisjen e procedurës kundërvajtës të vërtetuar në Ligjin për inspektim administrues për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve ku inspektori do të bëjë mbikëqyrje në organin kompetent nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tre ditëve pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer do ta lajmërojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(18) Nëse inspektori nuk ka vepruar dhe në afatin plotësues nga alineja (17) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit administrues shtetëror do të parashtrojë kallëzim deri te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tre ditëve pune do ta lajmërojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(19) Në rastin nga alineja (18) e këtij neni, drejtori i Inspektoratit administrues shtetëror menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta zbatojë mbikëqyrjen menjëherë.

(20) Në rastin e alinesë (19) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit administrues shtetëror në afat prej tre ditëve pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(21) Nëse drejtori i Inspektoratit administrues shtetëror nuk vepron në pajtim me alinenë (17) nga ky nen, parashtruesi i kërkesës mund të parashtrojë kallëzim deri te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve pune.

(22) Nëse ministri i Drejtësisë nuk vendos në afatin nga alineja (15) e këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të nisë kontest administrues para organit kompetent.

(23) Procedura para Gjykatës administrative është urgjente.“

Neni 2

Në nenin 22 alineja (2) fjalët: “Komisioni kompetent i shkallës së dytë pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Komisioni shtetëror për vendosje në procedurën drejtuese dhe procedura nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë”.

Neni 3

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pas shpalljes së aktit nënligjor nga alineja 1 e këtij neni në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” i njëjti menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orëve shpallet në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të fillojë të aplikohet në afat prej tre muajve nga dita e hyrjes së tij në fuqi, përveç dispozitës nga neni 2 të këtij ligji, që do të nisë të aplikohet me fillimin e aplikimit të Ligjit për themelimin e Komisionit shtetëror për vendosje në procedurën administruese dhe procedurën nga marrëdhënia e punës në shkallën e dytë.

ANEKSI 2 – PËRFUNDIME NGA DEBATI MBIKËQYRËS I KOMISIONIT TË KULTURËS NË PARLAMENTIN E MK-SË

Komisioni për kulturë në vazhdimin e tretë të mbledhjes së njëmbëdhjetë nga Diskutimi mbikëqyrës në temën: Zbatimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike” të mbajtur më 21 korrik 2010, në pajtim me nenin 23 alineja 2 nga Ligji për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa në bazë të diskutimit mbikëqyrës njëzëri e miratoi këtë

PËRFUDIM

Komisioni për kulturë:

1. E përshëndet politikën e nxitjeve tatimore për personat fizik dhe subjektet juridike të cilët dhurojnë dhe sponsorojnë në fushat me interes publik. Në këtë mënyrë ata nxiten që në mënyrë aktive të kontribuojnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve, shoqatave dhe fondacioneve, si dhe subjekteve tjera juridike, mirëqenien e tyre dhe drejtësinë sociale;
2. E nxitë periudhën e deritanishme liberale në përfshirjen e ligjit në kuptim të: definicionit të gjerë të lëndëve të donacionit/ sponsorimit, nxitjeve tatimore te më shumë lloje donacione, qasja liberale ndaj dhënësve dhe marrësve, si dhe barazimi i donatorëve të vendit me ato të jashtëm;
3. Konstaton se dispozitat në Ligjin ekzistues për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike si dhe komentimi i tij shpjigë deri te problemet në zbatimin e tij të deritanishëm. Për këtë shkak, Ligji nuk i jep rezultatet e pritura në drejtim të nxitjes së rritur të personave fizik dhe juridik të dhurojnë/sponsorojnë;
4. E theksojnë nevojën nga miratimi i Ligjit të ri për donacione dhe sponsorime, i cili do ti mënjanojë pengesat në kuptim të

definicioneve, procedurave dhe kompetencave, por edhe do ti revidojë beneficinet e parapara tatimore;

5. Rekomandon deri te Ministria kompetente, Ministria e Drejtësisë, në procesin e përgatitjes së ligjit në mënyrë aktive ti përfshijë edhe institucionet tjera relevante, ekspertë dhe përfaqësues të palëve të prekura (përmes diskutimit publik, formimin e grupit punues multi sektorial ose mekanizmave tjerë të cilët qëndrojnë në dispozicion). Në këtë drejtim veçanërisht nxitet inkuadrimi i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në procesin e përgatitje së Ligjit;
6. Rekomandon, lidhur me përcaktimin e nocioneve dhe termeve kryesore, harmonizimin me Ligjin për shoqata dhe fondacione (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 52/2010) si dhe me rregulloret tjera ligjore të cilat e përcaktojnë interesin publik dhe organizatat/institucionet me interes publik;
7. Rekomandon saktësimin e kompetencave të institucioneve në drejtim të zvogëlimit maksimal të ngarkesës dhe shpenzimeve për administratën, si dhe zvogëlimin e pasigurisë juridike për shfrytëzuesit në zbatimin e ligjit;
8. Rekomandon thjeshtimin e procedurës sipas së cilës realizohen nxitjet tatimore në pajtim me praktikën pozitive botërore. Procedura duhet të thjeshtohet në drejtim të zvogëlimit të ngarkesës së dhënësve, përmes: 1) lidhjen e interesit publik (dhe/ose vërtetimin e interesit publik) me marrësin, 2) realizimi i procedurës vetëm përmes evidencës së kontabilitetit dhe 3) zvogëlimi i vëllimit të dokumentacionit të obligueshëm;
9. Rekomandon të bëhet analizë: nëse marrësit do të kufizohen vetëm në organizata me interes publik (OIP) ose do të përfshihen të gjitha shoqatat dhe fondacionet. Në fushën e sportit do të bëhet analizë për organizatat e sportit të regjistruara në pajtim me Ligjin për sport ose më gjerë për të gjithë ata që promovojnë sport si dhe njohje e mundshme mes sportit superior dhe masiv.
10. Rekomandon të bëhet analizë për modalitetet e ndryshme të tatimitit me kufizimin e karakterit jofitimprurës nga karakteri komercial i kulturës;
11. Rekomandon nevojë nga analiza e mundësisë për rritjen e nxitjeve tatimore për donacione te tatimi në fitim ose nga analiza

e mundësisë për ndryshim të mekanizmit të llogaritjes së nxitjeve tatimore. Veçanërisht rekomandon se ekziston nevojë nga analiza e mundësisë që të parashihen nxitje më të mëdha tatimore nga ato të tanishmet veçanërisht në fushat të cilat tradicionalisht mbështeten me donacione dhe sponsorime (sporti, kultura, etj.) dhe për fushat me interes të veçantë shoqëror (arsimi, kultura, etj.);

12. Rekomandon nevojën nga analiza e mundësisë për rritjen e kufirit nga 24.000 denarë te tatimi personal nga të ardhurat (ose të mbetet vetëm tani kushti i parë i definuar deri 20% nga borxhi i përgjithshëm tatimor në bazë të tatimit personal nga të ardhurat) që të stimulohen individët të dhurojnë mjete në fushat e interesit publik;
13. Rekomandon nevojë nga ndryshimi i rregullores ligjore në ligje të tjera që t'u mundësohet të gjithë personave fizik të cilët për të ardhurat e tyre paguajnë tatim personal nga të ardhurat (mbi 500.000 persona) të kenë mundësi të realizojnë nxitje tatimore gjatë donacioneve në fushat me interes publik, e jo vetëm ata që kanë të ardhura plotësuese dhe të cilët parashtrojnë fletëparaqitje tatimore (rreth 150.000 persona në vitin 2009);
14. Vlerëson se duhet të gjendet mënyrë që të mos llogaritet tatimi i vlerës së shtuar gjatë SMS/dhurimeve me telefon (dhe për pri-pejd dhe për post-pejd shfrytëzuesit), që të mos ngarkohen shfrytëzuesit e telefonisë celulare (dhe për momentin e përcaktuar me Ligjin për sponsorim dhe donacione në veprimtaritë publike, por nuk zbatohet);
15. Rekomandon se në pajtim me nenin e përcaktuar 9 nga Ligji për sponsorime dhe donacione në veprimtaritë publike, “Shpallja e emrit, firmës dhe logos së dhënësit të donacionit dhe të sponsorimit në mediat publike, të shtypura dhe elektronike nuk llogaritet për reklamë”, të propozohet zgjidhje me të cilën mediat nuk do të mund të refuzojnë që ta prezantojnë logon e dhënësit (në praktikë rast më i shpeshtë kur dhënësi është kompani). Në mënyrë plotësuese, me theksimin e emrit, logos së donatorit ose sponsorëve stimulohet përgjegjësia shoqërore dhe vetëdija për domosdoshmërinë nga dhurimi në projekte me interes publik, qoftë nga personat juridik ose fizik;

16. Rekomandon udhëheqjen e regjistrit për donacione dhe sponsorime si dhe mundësia e parashtrimit të dokumenteve deri te institucionet përgjegjëse lidhur me procedurat për donacione dhe sponsorime nga ana e dhënësve dhe marrësve në formë elektronike;
17. Ky përfundim të parashtrohet deri te Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, deri te deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave;
18. Përfundimi të botohet në ueb faqen e Kuvendit të republikës së Maqedonisë.

ANEKSI 3 – PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME NGA FORUMET NDËRSEKTORIALE

RAPORT

FORUMI NDËR SEKTORIAL PËR LIGJIN PËR DONACIONE DHE SPONSORIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE

Shkup, dhjetor 2011

HYRJE

Forumi ndër sektorial për Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike u organizua me qëllim të inkuadrimin të opinionit të gjerë në procesin e përgatitjes së ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit, qëllimi primar i të cilit është ta nxisin kontributin (përmes donacioneve dhe sponsorimeve) të ndërmarrjeve dhe qytetarëve në fushat me interes publik (arsimi, kultura, socialja, mjedisi jetësor, shëndetësia, sporti etj.) Forumi u organizua nga ana e Shoqatës Konekt, në kuadër të projektit Korniza ligjore për qëndrueshmërinë financiare të OQ, që është ko-financuar nga fondet e Bashkimit Evropian në kuadër të IPA/2011/261-811.

Donacionet dhe sponsorimet prekin në jetën e pothuaj çdo qytetari në shtetin tonë. Sipas hulumtave, mbi 70% të qytetarëve tanë dhurojnë gjatë vitit, si dhe më shumë e gjysma e ndërmarrjeve. Pjesë e madhe e qytetarëve, personalisht ose përmes organizatave ku anëtarësojnë qoftë marrës së donacionit ose sponsorimit.

Në shtetin tonë, në vitin 2006 u miratua Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike (dhe i ndryshuar në vitin 2008 dhe 2011). Ai për herë të parë, në mënyrë sistematike mundësoi që personat fizik dhe juridik të fitojnë lehtësime tatimore për donacionet dhe sponsorimet për qëllime me interes publik. Duke marrë parasysh se hulumtimet tregojnë se qytetarët dhe ndërmarrjet mendojnë se lehtësimet tatimore

janë stimul i rëndësishëm për dhurim, ligji është relevant dhe e arsyeton qëllimin për të cilin është sjellë. Për ata që dhurojnë, ligji mundëson nxitje tatimore në fushën e tatimit personal nga të ardhurat, tatimi në fitim, tatimi i vlerës së shtuar dhe tatimi në pronë.

Qasja e miratuar në Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike ka aspekte pozitive në kuptim të qasjes liberale në përfshirjen e marrësve dhe dhënësve, lënda e donacionit, nxitjeve tatimore në fushën e më shumë llojeve të donacioneve etj. Megjithatë, edhe krahas asaj që në fuqi është ligji i cili formalisht funksion, praktika tregon se ekzistojnë sfida të mëdha në zbatimin e tij. Shumë nga ndërmarrjet (veçanërisht të vogla dhe të mesme) vendosin që mos ta shfrytëzojnë ligjin edhe pse do të dëshironin, qytetarët pothuaj edhe nuk e shfrytëzojnë. Në këtë mënyrë, ligji nuk u shërben atyre për të cilët është sjellë.

Në pajtim me rendin e ditës të paraparë, forumi u realizua në dy pjesë. Në pjesën e parë vështrim ndaj procedurës për ndryshime dhe plotësime të Ligjit dha znj. Julijana Georgievska nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa analiza e Ligjit, e punuar për nevojat e grupit punues të formuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, e prezantoi drejtorja ekzekutive e Konekt, Nikica Kusinikova. Në pjesën e dytë u la mundësia për diskutim të gjerë mes llojeve të ndryshme të opinionit të prekur (marrës dhe dhënës të donacioneve, si dhe institucione shtetërore të përfshirë në procesin) pas çka u prezantuan përfundimet që dolën nga diskutimi.

Ky raport përmban rezyme të shkurtër nga diskutimet e pjesëmarrësve, si dhe rekomandime dhe përfundime që dolën si rezultat i diskutimit në grupe. I njëjti do të dorëzohet deri te të gjitha palët e interesuara, si dhe nga grupi punues me qëllim të përgatitjes së tekstit të Ligjit që të merren parasysh mendimet dhe qëndrimet e aktorëve në proces.

PJESËMARRËS NË FORUM

Në forumin ndër sektorial për Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike ishin prezent më shumë se 100 pjesëmarrës. Krahas përfaqësuesve të organizatave qytetare, pjesëmarrje në forum patën edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore të inkuadruar në proces, përfaqësues të njësive të pushtetit lokal, deputetë nga Kuvendi dhe të

punësuar në administratën e Kuvendit, përfaqësues të institucioneve publike, biznes bashkësisë dhe persona tjerë të interesuar.

REZYME TË DISKUTIMEVE

Në emër të Ministrisë së Drejtësisë diskutim pati **znj. Julijana Georgievska**. Duke folur rreth Ligjit, ajo theksoi se procesi për ndryshime dhe plotësime të Ligjit ka filluar nga mesi i vitit 2010, ndërsa ligji është vënë në programin për punë të ministrisë në vitin 2011 dhe do të mbetet lartën agjendën edhe në vitin 2012, për kur pritet finalizimi i tij. Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, është formuar grup punues, i cili ka për qëllim të përgatisë ndryshime dhe plotësime të tekstit të Ligjit dhe ti inkuadrojë mendimet dhe qëndrimet e të gjitha palëve të prekura në të njëjtin.

Aktivitetet për ndryshime dhe plotësime të Ligjit nga ana e ministrisë janë ndërmarrë sepse janë shqyrtuar të gjitha sfidat gjatë zbatimit të tij, siç është afati i gjatë kohor dhe procedura e vëllimshme administrative që duhet të kalohet që të finalizohet donacioni/sponsorimi i caktuar. Në atë drejtim, nevojitet të gjendet zgjidhje e cila do të nxisë më shumë donacione në aktivitetet me interes publik dhe gjatë kësaj saktë do ti locojë përgjegjësitë dhe obligimet si të dhënësve dhe marrësve, ashtu edhe të institucioneve të inkuadruar në proces.

Ministria e vlerëson shumë kontributin e të gjithë organizatave qytetare dhe marrësve të tjerë të involvuar dhe dhënësve të donacioneve/sponsorimeve dhe nëse gjatë procesit tregohet si e domosdoshme, është e gatshme të propozojë edhe tekst fare të ri të Ligjit.

Veçanërisht u theksua kontributi që Konekt e ka dhënë me përgatitjen e analizës dhe organizimin e diskutimeve lidhur me Ligjin, si mënyrë e inkuadrimit të palëve të prekura në procesin e krijimit të politikave, që mundëson zbatim efikas dhe efektiv të zgjidhjeve ligjore.

Analiza e Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike u prezantua nga ana e drejtores ekzekutive të Konekt, **Nikica Kusinikova**. Në prezantimin e saj ajo theksoi se analiza ka për qëllim të jep vështrim ndaj sfidave të cilat dolën nga aplikimi i deritanishëm i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike në Maqedoni dhe

i njëjti e përfshinë aspektin e efektit të dispozitave ekzistuese ligjore mbi nxitjen e dhurimit/sponsorimit në aktivitetet me interes publik.

Përfundimet nga analiza flasin se sfidat kryesore të zgjidhjeve ekzistuese ligjore mund të grupohen në tre aspekte:

- 1) definomi dhe komentimi i terminologjisë kyçe dhe harmonizimi me ligjet tjera;**
- 2) procedura administrative për realizimin e lehtësimeve tatimore;**
- 3) niveli i lehtësimeve tatimore dhe zbatimi i tyre;**
- 4) sistemi jo i qartë për kontroll, i cili sjell deri te pasiguria juridike të dhënësit; dhe**
- 5) kompetenca e locuar te më shumë institucione të cilat sjellin deri te shpenzime të mëdha për administrim.**

Rekomandimet të cilat dalin nga analiza janë se Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike duhet të pësojë ndryshime në kuptim të mënjanimin të pengesave, por gjithashtu edhe me revidimin e adekuates së beneficioneve të parapara tatimore. Rekomandimet kryesore për ndryshime janë:

- » revidimi i termeve lidhur me interesin publik, përcaktimi i dhënësve dhe marrësve dhe saktësimi i promovimit në rast të donacionit dhe sponsorimit;
- » saktësimi i kompetencave të institucioneve, veçanërisht të Drejtorisë për të hyra publike në caktimin e interesit publik dhe zvogëlimi i vëllimit të inkuadrimit të institucioneve kompetente në vërtetimin e interesit publik;
- » zvogëlimi i ngarkesës së dhënësve përmes: 1) lidhjes së interesit publik me marrësin dhe vendosjen e procedurës së dyfishtë që do ta udhëheqë marrësi, 2) realizimi i procedurës vetëm përmes evidencës së kontabilitetit dhe 3) zvogëlimi i vëllimit të dokumentacionit të obligueshëm;
- » revidimi i dispozitave për nxitjet tatimore në drejtim të: 1) mundësimi i zbatimit të plotë të nxitjeve ekzistuese veçanërisht kur dhënësit janë persona fizik dhe 2) diskutim mes palëve të

prekura dhe revidimi i mundshëm i nivelit të nxitjeve tatimore në drejtim të arritjes së niveleve më të larta të donacioneve dhe sponsorimeve;

- » zvogëlimi i ngarkesës administrative për raportim dhe revidimi i sistemit të kontrollit me zvogëlimin e llogaridhënies mbi dhënësin për shfrytëzimin e donacionit/sponsorimit dhe saktësimi i rolit të institucioneve të ndryshme.

Në fund u theksua se gjatë ndryshimeve të ligjit procesi i miratimit të tyre është i rëndësishëm, i cili duhet të jetë participativ në gjerësi me inkuadrimin jo vetëm të institucioneve kompetente, por edhe të shfrytëzuesve të ligjit. Vetëm në këtë mënyrë do të fitohet zgjidhje ligjore që me të vërtetë do ti nxisë qytetarët dhe ndërmarrjet të jenë aktivë dhe të dhurojnë/sponsorojnë në fushat me interes publik.

REKOMANDIME DHE PËRFUNDIME TË CILAT DOLËN NGA DISKUTIMI

Rekomandimet dhe përfundimet kyçe të nxjerra si rezultat i diskutimit në kuadër të tre grupeve (dhënës të donacioneve dhe institucione; dhe dy grupe të marrësve të donacioneve) kanë të bëjnë me disa aspekte:

1. Përcaktimi dhe komentimi i terminologjisë kyçe

Një nga konstatimet kryesore të pjesëmarrësve ishte se definicionet të cilat e përcaktojnë *interesin publik dhe veprimtarinë publike*, në ligje të ndryshme, nuk janë konsistence, që sjell deri te moskuptimet, komentet subjektive dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit.

Prej këtui, doli rekomandimi të shqyrtohet mundësia për shmangien e termit “*veprimtari publike*” në emrin e ligjit dhe në vend të tij gjithkund të përdoret termi “*interes publik*”. Në këtë drejtim do të nevojitet të harmonizohet përdorimi i “*interes publik*” si term edhe në ligjet tjera, siç është për shembull Ligji për shoqata dhe fondacione.

Rekomandim nga njëri nga grupet e marrësve ishte edhe të ekzistojë dispozitë e qartë në ligj, ku do të tregojë se ky ligj nuk e përjashton dhurimin/sponsorimin edhe në aktivitete të cilat nuk janë me interes publik, por gjatë kësaj nuk do të mund të kenë dobi nga

lehtësimet tatimore. Praktika ka treguar se shumë shpesh donatorët e komentojnë ligjin si kufizues dhe mendojnë se nuk guxojnë të dhurojnë për aktivitete tjera (si për shembull për person të caktuar fizik ose aktivitet i cili nuk është me interes publik).

2. Procedura administrative për realizimin e lehtësimeve tatimore dhe evidentimi i donacioneve/sponsorimeve

Të gjithë pjesëmarrësit në diskutim u pajtuan se ngarkesën më të madhe në proces e bëjnë procedurat administrative, numri i madh i dokumenteve të cilat janë të nevojshme që të sigurohen që të finalizohet procedura, si dhe inkuadrimi i numri të madh të institucioneve kompetente dhe subjekteve në proces. Në drejtim të tejkalimit të kësaj sfide u propozuan disa rekomandime.

Obligimi për udhëheqjen e procedurës që të transferohet te marrësi i donacioneve, në vend te dhënësi, me çka marrësi do të përgjigje për shfrytëzimin me qëllim të mjeteve dhe raportimi për aktivitetet, ndërsa obligimi i donatorëve do të kishte përfunduar me nënshkrimin e marrëveshjes për donacion.

Të ekzistojë mundësi për sigurimin e ex-ante informatës për interesin publik, gjegjësisht të lidhet statusi publik me marrësin e donacionit. Në atë rast e gjithë procedura do të mund të vihej në evidencë të kontabilitetit, me çka do të shmangej inkuadrimi i të gjitha organeve kompetente shtetërore për secilën nga donacionet/sponsorimet.

Rishtas, të lihet mundësia për procedurë të dyfishtë për ata marrës të cilët nuk kanë status të interesit publik, por megjithatë realizojnë aktivitete me interes publik. Në atë rast procedura do të mund të ishte si procedura e paraparë me zgjidhjen ekzistuese ligjore.

Të shqyrtohet mundësia për donacione të vogla (për shembull me vlerë deri 200 euro) të mos lidhen marrëveshje të obligueshme me shkrim, veçanërisht për donatorët individual, si dhe të lirohen marrësit nga obligimi për raport të detyrueshëm për çdo donacion të këtillë individual.

Lidhur me kontrollin, është dhënë që propozim dënimit të jenë procen-tuale në bazë të shumës së donacionit.

3. Nxitjet tatimore dhe aplikimi i tyre

Lidhur me lartësinë e nxitjeve tatimore pjesëmarrësit ishin njëzëri në përfundimin se **nevojitet të revidohet sistemi i nxitjes tatimore të tatimit personal nga të ardhurat**, që të mundësohet dobia nga ai nga ana e personave fizik të cilët realizojnë të ardhura vetëm në bazë të ardhurave personale.

Edhe pse mbisundon frika se shuma e nxitjeve tatimore për personat fizik është i mjaftueshëm, u theksua mundësia **që të mendohet për caktimin shkallor procentuale të lartësisë së nxitjes tatimore**. Kjo do të thoshte se personat me të ardhura më të mëdha do të mund të dhurojnë shuma më të mëdha të mjeteve dhe gjatë kësaj nxitja tatimore për ata do të ishte përqindje më e madhe nga të ardhurat e përgjithshme, pa shumë kufizuese (që sipas vendimit ligjor është 24.000).

Gjithashtu u rekomandua që **të shqyrtohet mundësia për realizimin e lirimit nga TVSH-ja te dhurimet tele-komunikuese**.

REZYME E SHKURTËR

FORUMI NDËR SEKTORIAL PËR LIGJIN PËR DONACIONE DHE SPONSORIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE

Prilep, shkurt 2012

HYRJJE

Në drejtim të përfshirjes së opinionit më të gjerë në procesin e përgatitjes së ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike (LDSIP), në Prilep u organizua forumi i dytë ndër sektorial. Forumet u organizuan si pjesë e projektit Korniza ligjore për qëndrueshmërinë financiare të OQ, që e realizoi shoqata Konekt në bashkëpunim me Institutin për Demokraci Parlamentare (IPD), ndërsa i ko-financuar nga fondet e Bashkimit Evropian të IPA/2011/261-811.

Në pajtim me rendit e paraparë të ditës, forumi u realizua në dy pjesë. Në pjesën e parë vështrim ndaj procesit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit, si dhe analizë të Ligjit, dha drejtorja ekzekutive e Konekt, Nikica Kusinikova. Në pjesën e dytë u la mundësia për diskutim më të gjerë mes palëve të ndryshme të prekura (marrës dhe dhënës të donacioneve, si dhe institucionet e inkuadruar në proces) pas çka u prezantuan përfundimet të cilat dolën nga diskutimi.

Ky raport përmban rezyme të shkurtër nga diskutimet e pjesëmarrësve, si dhe rekomandime dhe përfundime që dolën si rezultat i diskutimeve në grupe. I njëjti do të dërgohet deri te palët e interesuara, si dhe deri te grupi punues me qëllim që gjatë përgatitjes së tekstit të Ligjit të merren parasysh mendimet dhe qëndrimet e aktorëve në proces.

PJESËMARRËS NË FORUM

Në forumin ndër sektorial për Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike, që u mbajt në Prilep, më 24 shkurt 2012, ishin prezent 35 pjesëmarrës. Krahas përfaqësuesve të organizatave qytetare, në forum morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve publike, përfaqësues të njëjësive të pushtetit lokal dhe persona tjerë të interesuar.

REZYMEN TË DISKUTIMEVE

Analiza e Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike u prezantua nga ana e drejtores ekzekutive të Konekt, **Nikica Kusinikova**. Në prezantimin e saj ajo theksoi se analiza ka për qëllim të jep vështrim mbi sfidat të cilat dalin nga zbatimi i deritanishëm i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike në Maqedoni dhe i njëjti e përfshinë aspektin e efektit të dispozitave ekzistuese ligjore mbi nxitjen e dhurimit/sponsorimit në aktivitetet me interes publik.

Përfundimet nga analiza flasin se sfidat kryesore të zgjidhjeve ekzistuese ligjore mund të grupohen në tre aspekte:

- 1) **përcaktimi dhe komentimi i terminologjisë kyçe dhe harmonizimi me ligjet tjera;**
- 2) **procedura administrative për realizimin e lehtësimeve tatimore;**
- 3) **niveli i lehtësimeve tatimore dhe aplikimi i tyre;**
- 4) **sistem i paqartë për kontroll, i cili sjell deri te pasiguria të dhënësit; dhe**
- 5) **kompetencë e locuar te më shumë institucione që sjell deri te shpenzime më të mëdha për administrim.**

Rekomandimet të cilat dolën nga analiza janë se Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike duhet të pësojë ndryshime në kuptim të mënjanimin të pengesave, por gjithashtu edhe revidim i adekuates së beneficioneve të parapara tatimore. Rekomandimet kryesore për ndryshime janë:

- » revidimi i termeve lidhur me interesin publik, përcaktimi i dhënësve dhe marrësve, dhe saktësimi i promovimit në rast të donacionit dhe sponsorimit;
- » saktësimi i kompetencave të institucioneve, veçanërisht të Drejtorisë për të hyra publike në caktimin e interesit publik dhe zvogëlimi i vëllimit të inkuadrimit të institucioneve kompetente në caktimin e interesit publik;
- » zvogëlimi i ngarkesës së dhënësve përmes: 1) lidhjes së interesit publik me marrësin dhe vendosjen e procedurës së dyfishtë

që do ta udhëheqë marrësi, 2) realizimi i procedurës vetëm përmes evidencës së kontabilitetit dhe 3) zvogëlimi i vëllimit të dokumentacionit të obligueshëm;

- » revidimi i dispozitave për nxitjet tatimore në drejtim të: 1) mundësimi i zbatimit të plotë të nxitjeve ekzistuese veçanërisht kur dhënësit janë persona fizik dhe 2) diskutim mes palëve të prekura dhe revidimi i mundshëm i nivelit të nxitjeve tatimore në drejtim të arritjes së niveleve më të larta të donacioneve dhe sponsorimeve;
- » zvogëlimi i ngarkesës administrative për raportim dhe revidimi i sistemit të kontrollit me zvogëlimin e llogaridhënies mbi dhënësin për shfrytëzimin e donacionit/sponsorimit dhe saktësimi i rolit të institucioneve.

Sipas znj. Kusinikova, mendimet momentale të institucioneve për Ligjin janë se i njëjti do të keqpërdoret, e kështu fokusi është vënë në gjetjen e mekanizmave mbrojtës, në vend që theksi të vihet në nxitjen e dhurimit dhe sponsorimit. Prandaj, bëhen përpjekje që të tejkalohet kjo filozofi dhe të mundësohet zgjidhje ligjore e cila do të nxisë dhurim, veçanërisht nga ana e personave fizik.

Sipas gjetjeve në analizë, përvojat botërore tregojnë se lehtësimet tatimore ndikojnë në ngritjen e vetëdijes të opinionit dhe nxitjen e dhurimit. Prej këtui, Ligji duhet ta mbajë qasjen e gjerë ndaj spektrit të lehtësimeve tatimore, bile të lihet edhe hapësirë dhe të mendohet për nxitje më të mëdha tatimore, veçanërisht për donatorët individual.

Në drejtim të mundësimit të platformës për më shumë donacione është edhe propozimi për zvogëlimin e procedurave administrative, të cilat duhet ti kalojnë marrësit dhe donatori i donacionit. Me zgjidhjen ekzistuese ligjore donatorët janë të ngarkuar me procedura administrative, të cilat në mënyrë plotësuese krijojnë edhe pasiguri juridike rreth asaj nëse në fund do të mund të efektuohet lehtësimi tatimor.

Pas prezantimit, u hap hapësirë për diskutim, ku u inkadruan të pranishmit. Sipas diskutuesve, ky ligj duhet të jetë lëvizës i organizatave qytetare, duke krijuar mundësi për grumbullimin e mjeteve dhe resurseve, të cilët nga ana tjetër janë themel për krijimin dhe realizimin e politikave. Ligji hap mundësi për organizimin që të drejtohen nga

resurset lokale në periudhën kur donatorët e huaj shumë shpejt tërhiqen nga vendi. Sipas tyre, nevojitet të punohet në ngritjen e vetëdijes për njohjen e rëndësisë së filantropisë.

Edhe të pranishmit u pajtuan se nuk duhet të lejohet që Ligji të jetë restriktiv ndaj donacioneve dhe sponsorimeve duke imponuar mekanizma mbrojtës nga keqpërdorimi i mundshëm. Argumentet e tyre janë se ekzistojnë ligje tjera në pajtim me të cilat mund të përcillet nëse mjetet janë shfrytëzuar drejt dhe të shqiptohen sanksione për kundërvajtësit.

Në fund u theksua se gjatë ndryshimeve të ligjit është kyç procesi i miratimit të tyre, që duhet të jetë participativ me inkuadrimin jo vetëm të institucioneve kompetente, por edhe të shfrytëzuesve të ligjit. Vetëm në këtë mënyrë do të fitohet zgjidhje ligjore që me të vërtetë do ti nxisë qytetarët dhe ndërmarrjet të jenë aktivë dhe të dhurojnë/sponsorojnë në fushat me interes publik.

REKOMANDIME DHE PËRFUNDIME TË CILAT DOLËN NGA DISKUTIMI

jatë diskutimit të pranishmit u pajtuan se organizatat qytetare duhet të jenë bartës të procesit për ngritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e dhurimit, gjatë kësaj mirë ta njohin Ligjin dhe të përgatiten për promovimin e të njëjtit dhe mundësive që i ofron, para donatorëve potencial.

Rekomandimet dhe përfundimet kryesore e nxjerra si rezultat i diskutimit në kuadër të dy grupeve të përziera (dhënës dhe marrës të donacioneve) ka të bëjë me disa aspekte:

4. Përcaktimi dhe komentimi i terminologjisë kyçe

Një nga konstatimet kryesore të pjesëmarrësve ishte se definicionet të cilat e definojnë *interesin publik* dhe *veprimtarinë publike*, në ligje të ndryshme, nuk janë konsistence, që sjell deri te moskuptimet, komentimet subjektive dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit.

Sa i përket marrësve të donacioneve dhe sponsorimeve, nga diskutimet doli propozimi që **neni 7 alineja 1 nga Ligji ekzistues të plotësohet**

me fjalët:”...që ka karakter jofitimprurës dhe realizon veprimtari me interes publik.”

Numërimi i subjekteve dhe llojeve të subjekteve që mund të paraqiten si marrës të donacioneve dhe sponsorimeve, sipas pjesëmarrësve në forum është zgjidhje e mirë. Në këtë drejtim u dha propozimi **që të shqyrtohet mundësia për grupimin e marrësve në dy grupe: njëri - ku do të numërohen subjektet të cilat nuk marrin mjete nga burime qeveritare për realizimin e aktiviteteve të tyre dhe tjetri – subjekte të cilat marrin mjete nga qeveria (institucione publike, institucione etj.).** Në pajtim me këtë propozohet secili nga grupet ti nënshtrohet lehtësimeve të ndryshme tatimore.

5. Procedura administrative për realizimin e lehtësimeve tatimore dhe evidentimi i donacioneve/sponsorimeve

Të gjithë pjesëmarrësit në diskutim u pajtuan se ngarkesë më të madhe procesit i bëjnë procedurat administrative, numri i madh i dokumenteve të cilat nevojiten që të sigurohet finalizimi i procedurës, si dhe inkuadrimi i një numri të madh të institucioneve kompetente dhe subjekteve në proces. Në të njëjtën ka mendimet se ministritë kompetente jo gjithnjë kanë kapacitet të mjaftueshëm fizik dhe në ekspertë që të mund ti vlerësojnë të gjitha projektet dhe aktivitetet individualisht dhe jo rrallë vlerësimet e këtilla udhëhiqen nga pikëpamjet subjektive të personit përgjegjës. Në drejtim të tejkalimit të kësaj sfide janë propozuar disa rekomandime.

Të përgatiten kritere të qarta sipas të cilave do të caktohej interesi publik në projekt ose aktivitet të caktuar dhe të formohet organ ndër sektorial nga përfaqësues nga të gjitha ministritë relevante dhe institucionet që vendosin rreth kësaj çështjeje.

Organizatave marrës të donacioneve të kenë mundësi të fitojnë status të organizatave me interes publik, por kjo të mos e përjashtojë mundësinë për organizatat tjera që t’u caktohet interesi publik sipas projekteve.

Obligimi për udhëheqjen e procedurës që të transferohet te marrësit të donacioneve, në vend te dhënësit, me çka marrësi do të ishte përgjegjës për shfrytëzimin e drejt të mjeteve dhe raportimi për aktivitetet, ndërsa obligimi i donatorit do të përfundonte me nënshkrimin e marrëveshjes për donacion. Marrësit, si shfrytëzues të donacionit/

sponsorimit do të duhej të jenë ata që e marrin barrën e sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm që dhënësit të mund ti gëzojnë lehtësimet tatimore.

Të ekzistojë mundësia për sigurimin e parakohshëm të informatës për interes publik, për çka u propozua organizatat të marrin vërtetim (në nivel vjetor), me çka do të vërtetohej interesi publik i organizatës, e jo kjo të bëhet për çdo aktivitet/projekt veçmas.

Rishtas, u propozua **që të lihet mundësia për procedurën e dyfishtë për ata marrës që nuk kanë status të interesit publik, e megjithatë realizojnë aktivitete me interes publik.** Në atë rast procedura do të mund ti ngjante procedurës së paraparë me zgjidhjen ekzistuese ligjore.

6. Nxitjet tatimore dhe aplikimi i tyre

Lidhur me lartësinë e nxitjeve tatimore pjesëmarrësit ishin njëzëri në përfundimin se **nevojitet të revidohet sistemi i nxitjes tatimore te tatimi personal nga të ardhurat,** që të mundësohet dobia nga ai nga ana e personave fizik, të cilët realizojnë të ardhura vetëm në bazë të ardhurave personale.

Mbisundonte qëndrimi se donatorëve individual duhet tu lihet mundësia që të vendosin ku do ta dhurojnë përqindjen e paraparë nga tatimi personal (ose një pjesë prej tij) **në momentin kur do të bëhet pagesa e tatimit.**

Të pranishmit gjithashtu propozuan **të hiqen dispozitat penale që kanë të bëjnë me dokumentacionin jo të plotë, sepse në atë rast dënimi do të ishte të mos shfrytëzohet vetë lehtësimi tatimor.**

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски",
Скопје

364-646:340.13(497.7)"2007/11"

KUSINIKOVA, Nikica

Analiza e zbatim të ligjit për donacione dhe sponzorime në
veprimtaritë : 2007-2011 / [autorë Nikica Kusinikova, Katerina
Naxhi-Miceva Evans, Aleksandar Nikollov] ; [përkthimi Jordana
Shemko-Georgievska]. - Shkup : Shoqata Konekt, 2012. - 152 стр. ; 20
см

Превод на делото: Анализа на спроведувањето на законот за
донации и спонзорства во јавните дејности : 2007-2011 / Никица
Кусиникова, Катерина Хаџи-Мицева Еванс, Александар Николов. -
Ќусноти кон текстот. - Содржи и: Aneksi 1-3

ISBN 978-608-65136-3-4

1. Naxhi-Miceva Evans, Katerina [автор] 2. Nikollov, Aleksandar
[автор]. - I. Кусиникова, Никица види Kusinikova, Nikica
а) Донации и спонзорства во јавни дејности - Законодавство -
Македонија - 2007-2011

COBISS.MK-ID 91346698